



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve për projektin “Infrastruktura Bashkiake V”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”

NË

AGJENCINË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE

PËR PROJEKTIN

“INFRASTRUKTURA BASHKIAKE V”

TIRANË, korrik 2025

NR.	Përmbajtja	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7
II	HYRJA	9
1	Objektivat dhe qëllimi	9
2	Identifikimi i çështjes	9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9
5	Kriteret e vlerësimit	9
6	Standardet e auditimit	10
7	Metodat e auditimit	10
8	Dokumentimi i auditimit	10
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	11
2.1	Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimit i tyre.	11
2.2	Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me Huadhënësit.	14
2.3	Mbi menaxhimin financiar të programit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave	17
2.4	Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të prokurimit të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacioni shqiptar	24
2.5	Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra dhe konsulencë.	43
IV	REKOMANDIME	61

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

a. Përshkrim i shkurtër i Projektit “Infrastruktura bashkiake V”, është projekt i cili financohet nga Qeveria Gjermane dhe grante, miratuar me aktet ligjore të mëposhtme:

- Me Ligjin nr. 24/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, **në shumën 80,000,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.28, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit të investimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, **në shumën 6,000,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.29, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit të Bashkimit Evropian, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për Bashkimin Evropian, për një mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, **në shumën 23,300,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.30, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për masat shoqëruese për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, **në shumën 3,000,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.31, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit SECO ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, **në shumën 13,300,000 euro**”.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij. AKUK është struktura përgjegjëse e caktuar për implementimin e projektit .

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim.

Raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave. Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës. Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime. Të tjera çështje të dala gjatë auditimit.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave: Auditim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve: Në përfundim të auditimit kanë rezultuar 7 gjetje dhe janë dhënë 10 rekomandime.

f. Gjetjet kryesore: Nga auditimi mbi përcaktimin dhe shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit, konstatohet se në këtë fazë të zhvillimit të projektit, nuk është e mundur të vlerësohet shkalla e realizimit të objektivit për rritjen e ndërgjegjësimit, pasi nuk ka një sistem të përcaktuar matjeje në dokumentet zyrtare. Kjo përbën një mangësi që duhet adresuar për të

siguruar një monitorim efektiv dhe për të mundësuar vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve të realizuara deri më tani, pasi në Planin e Fizibilitetit dhe Komunikimit nuk ka tregues të qartë të performancës, vlera fillestare dhe objektivat për vitin 2027, në mënyrë që të mundësohet matja e progresit dhe raportimi i saktë mbi realizimin e objektivit të ndërgjegjësimit.

Nga auditimi mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit për realizimin e procedurës së prokurimit “Shërbime Konsulenti Institucional”, u konstatua se:

Hapja e aplikimeve më 16.03.2021 është kryer nga dy anëtarë të komisionit të vlerësimit, duke mos respektuar përbërjen e përcaktuar prej 3 anëtarësh në Urdhrin nr. 545, datë 02.03.2021 i Drejtorit të AKUK.

Zyra e protokollit të AKUM nuk ka mbajtur procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit parakualifikues me anëtarët e komisionit të vlerësimit të procedurës.

Mungesa e evidentimit në administrimin e dokumentacionit parakualifikues, të dorëzuar nga shoqëritë konsulente, për shkak të mungesës së informacionit mbi procesin e protokollimit sipas kërkesave të KfW, ku zarfat duhej të dorëzoheshin jo më herët se 12.03.2021, ora 11:00, e vështirëson vlerësimin mbi përmbushjen e afatit të dorëzimit nga të gjitha subjektet pjesëmarrëse.

Në raportin përkatës të vlerësimit të fazës së dytë, anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk kanë evidentuar numrin e protokollit hyrës të AKUK për secilën nga ofertat e dorëzuara.

Vlerësimi teknik nga anëtarët e komisionit të vlerësimit është kryer me një vonesë kohore të konsiderueshme nga data e dorëzimit të ofertave deri në përfundimin e vlerësimit financiar kanë kaluar 8 muaj, një periudhë e gjatë kohore, e cila mund të ishte përfunduar brenda 2 muajsh. Megjithëse dokumentacioni i KfW-së nuk parashikon një afat specifik për këtë proces, kjo vonesë është e pajustificueshme, e cila ka ndikuar në shtyrjen e përzgjedhjes së konsulentit përtej afateve të parashikuara në shtojcën e marrëveshjes fillestare për këtë projekt.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së konsulentit institucional konstatohet se:

Për realizimin e këtij shërbimi, më 21.12.2022 është nënshkruar kontrata e konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 99, datë 19.01.2023) midis Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “S. G.”, “S. E. G.” & “M. E. & W. G.” dhe Drejtorit të Përgjithshëm të AKUK.

Sipas Marrëveshjes së Veçantë, datë 18.12.2020, lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtorëve të Ujësjetësive të qyteteve përfituese, financimi i kontratës mbështetet nga tre burime Grant i KfW, Grant i BE dhe Grant i SECO

Afati i kontratës bazuar në Nenin 1 të Kushteve të Veçanta të Kontratës, kontrata ka një kohëzgjatje prej 60 muajsh nga data e fillimit (19.01.2023), pra data e përfundimit të kontratës është 19.01.2028.

Nga analiza e të dhënave, rezulton se kontrata shfaq dy problematika kryesore:

- Mospërputhja e afateve financiare me kohëzgjatjen e kontratës pasi burimet e financimit të kontratës (huaja) përfundojnë në 30.11.2027, ndërkohë që kontrata zgjat deri më 19.01.2028, fakt ky që ka ekspozuar kontratën ndaj mbulimit me fonde financimi për 1,5 muajt e fundit.

- Shkelja e afateve të përcaktuara në Aneksin 2 “Grafik Kohor” të Marrëveshjes së Veçantë, datë 18.12.2020 ku përcaktohet se i gjithë projekti duhet të përfundojë më 31.12.2027, ndërsa kontrata e lidhur shkon përtej këtij afati.

Nga auditimi ofertave teknike dhe financiare të OE të kualifikuar pas fazës së parë dhe të dytë dhe vlerësimit të OE fitues mbi bazën e vlerësimit të kombinuar të pikëzimit konstatohet se:

a. Sipas raportit të vlerësimit teknik, në ekipin e ekspertëve shtesë janë propozuar 4 nga 6 ekspertë teknikë, përfshirë edhe ekspertin e IT-së, i cili ka përvojë në programim dhe SCADA.

b. Sipas ofertës financiare të shoqërisë konsulente fituese BOE S.-S.-M., në tabelën e detajuar të kostos, në pikën 2 “Local Staff Cost”, është përfshirë edhe pozicioni “National GIS Expert” për një periudhë 3-mujore, me një pagë mujore prej 4,935 euro, duke e rritur vlerën totale prej 14,805 euro (pa TVSH).

c. Në pikën 5.1 të ofertës financiare është parashikuar një automjet tip “D.D.” ose ekuivalent për nevoja transporti, me një kosto mujore prej 3,000 euro për një periudhë 60 muaj, duke arritur një vlerë totale prej 180,000 euro (pa TVSH).

d. Në seksionin 6, pika 6.1 dhe 6.2, janë përcaktuar shpenzimet për qiranë e zyrës për një periudhë 60-mujore, me një kosto mujore prej 2,200 euro, duke arritur një total prej 132,000 euro (pa TVSH). Po ashtu, për stafin mbështetës të zyrës është parashikuar një pagesë mujore prej 3,600 euro për 60 muaj, me një shumë totale prej 216,000 euro (pa TVSH).

Sipas Aneksit nr. 4, këto të dhëna detajojnë kostot e përfshira, duke përfshirë shpenzimet për ekspertët lokalë, mjetet e transportit dhe qiranë e zyrës.

e. Vlera e planifikuar në Shtesës së Kontratës nr. 1 për zërat e përfshirë në tabelën nr. 3, Aneksi nr. 1, në shumën **392,988 euro** (pa TVSH), nga totali i planifikuar prej **500,000 euro** (pa TVSH) në Shtesën e Kontratës nr. 1, përbën përsëritje të zërave të përcaktuar në kontratën bazë nr. 99 prot., datë 19.01.2023.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave janë dhënë disa rekomandime si vijon:

Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve me Njësinë e Koordinimit të Projektit, në bashkëpunim me konsulentin institucional për zbatimin e programit “Infrastruktura Bashkiake V”, të përditësojë Planin e Fizibilitetit dhe Komunikimit duke përcaktuar tregues specifikë të performancës, dhe objektivat e pritshme të matëshme pasi këto përmirësime do të sigurojnë një monitorim më efektiv të progresit dhe një vlerësim më të saktë të ndikimit të aktiviteteve të ndërgjegjësimit.

Zyra e Protokollit të Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve, të dokumentojë procesin e dorëzimit dhe administrimit të dokumentacionit si në fazën e parë dhe të dytë, duke mbajtur një procesverbal të detajuar të dorëzimit të dokumentacionit nga shoqëritë pjesëmarrëse. Kjo do të sigurojë transparencë dhe gjurmueshmëri të plotë të dokumentacionit dhe do të mundësojë verifikimin e saktë të afateve të dorëzimit, në përputhje me kërkesat e KfW.

Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve të sigurojë përputhjen e afateve të financimit me kohëzgjatjen e kontratës, duke ndërmarrë hapat e nevojshëm për të garantuar vijueshmërinë financiare deri në përfundimin e saj. Gjithashtu, të rishikojë dhe harmonizojë afatin e zbatimit të kontratës me afatet e përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, për të shmangur tejkalimin e afateve të miratuara për përfundimin e projektit si dhe mbulimin me financim të kontratës.

Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve të marrë masa duke zhvilluar procedurat e prokurimit rast pas rasti dhe mos përdorimin e shtesave të kontratave për shërbime shtesë të cilat nuk kanë qenë përfshirë në procedurën e tenderit.

Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve të marrë masa në aplikimin e penaliteteve dhe mbajtjen e sigurimit të kontratës në të gjitha rastet që konstatohet mos përmbushja e detyrimeve kontraktore, si dhe të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve të marrë masa për analizimin e plotë të shtesave të kontratave dhe zërave që kërkohen të financohen duke iu përmbajtur strukturës financuese të projektit dhe mos përfshirjen e zërave apo komponentëse të tjerë, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

I.1. Konkluzioni

Projekti “Infrastruktura bashkiake V” financohet nga Qeveria Gjermane dhe SECO (State Secretariat for Economic Affairs-Zvicër), implementimi i të cilit ka filluar në vitin 2018 dhe përfundon në 30.11.2027, është pjesë e programit infrastruktura bashkiake.

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të ujërave dhe forcimit të transparencës në sektorin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, është planifikuar rritja e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit mbi shërbimet, objektivat dhe politikat e BE-së për ujërat, si dhe promovimi i programit WOIP. Për këtë qëllim, është parashikuar hartimi dhe zbatimi i Planit të Fizibilitetit dhe Komunikimit, i cili do të shërbejë si bazë për matjen e performancës dhe arritjen e objektivave.

Megjithatë, nga vlerësimi i situatës rezulton se treguesit specifikë të performancës, vlera fillestare dhe objektivat për vitin 2027 nuk janë ende të përcaktuara në Planin e Fizibilitetit dhe Komunikimit. Ndërkohë që ky plan është hartuar dhe është në proces zbatimi, mungesa e treguesve të qartë dhe objektivave të matshme pengon vlerësimin efektiv të progresit dhe ndikimit të aktiviteteve të ndërgjegjësimit.

Në këtë fazë të zhvillimit të projektit, nuk është e mundur të vlerësohet shkalla e realizimit të objektivit për rritjen e ndërgjegjësimit, pasi nuk ka një sistem të përcaktuar matjeje në dokumentet zyrtare. Kjo përbën një mangësi për të siguruar një monitorim efektiv dhe për të mundësuar vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve të realizuara deri më tani, pasi në Planin e Fizibilitetit dhe Komunikimit nuk ka tregues të qartë të performancës, vlera fillestare dhe objektivat për vitin 2027, në mënyrë që të mundësohet matja e progresit dhe raportimi i saktë mbi realizimin e objektivit të ndërgjegjësimit.

Nga analiza e të dhënave, rezulton se kontrata shfaq dy problematika kryesore:

I. Mospërputhja e afateve financiare me kohëzgjatjen e kontratës:

Burimet e financimit të kontratës skadojnë më 30.11.2027, ndërkohë që kontrata zgjat deri më 19.01.2028. Kjo krijon rrezikun e mungesës së fondeve për muajt e fundit të kontratës.

Shkelja e afateve të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, datë 18.12.2020:

Aneksi 2 “Grafik Kohor” i kësaj marrëveshjeje përcakton se i gjithë projekti duhet të përfundojë më 31.12.2027, ndërsa kontrata e lidhur shkon përtej këtij afati.

Shtesat e kontratave janë lidhur jo në përputhje me Planin e Prokurimit në pikën 2.3 të Marrëveshjes së Veçantë, Aneksi 6 i Marrëveshjes së Veçantë, jo në përputhje me Parimet bazë të Guidelines for Procurement of Consulting Service, Works, Plant, Goods and Non - Consulting Service in Financial Cooperation with Partner Countries.

II.- Vlera e planifikuar në Shtesës së Kontratës nr. 1 për zërat e përfshirë në tabelën nr. 3, Aneksi nr. 1, në shumën **392,988 euro** (pa TVSH), nga totali i planifikuar prej **500,000 euro** (pa TVSH) në Shtesën e Kontratës nr. 1, përbën përsëritje të zërave të përcaktuar në kontratën bazë nr. 99 prot., datë 19.01.2023.

Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2024 është paguar 453,824 euro si tarifë angazhimi e cila është kosto e shtuar për buxhetin e shtetit për shkak të ecurisë shumë të ngadaltë të projektit dhe mos disbursimit në kohë sipas grafikut.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 95/1 prot., datë 21.01.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 23.01.2025 deri në datën 28.02.2025, në subjektin Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) për projektin “Infrastruktura Bashkiake V” për periudhën nga fillimi i projektit deri në datën 31/12/2024 u krye auditimi “Mbi Përputhshmërinë e Projektit “Infrastruktura Bashkiake V”” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. I.S., përgjegjës grupi
2. M.B., anëtare
3. A. L., anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit:

Dhënia e opinionit dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve si dhe nëse është kryer përdorimi i përshtatshëm i fondeve të projektit.

Raportimi mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit.

2. Identifikimi i çështjes:

Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i tyre. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve, kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave. Mbi auditimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas rastit në marrëveshjet me huadhënësit ose legjislacionin shqiptar, për realizimin e prokurimeve për ndërtime, mallra e shërbime deri në lidhjen e kontratës. Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra e shërbime. Të tjera çështje të dala gjatë auditimit.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat në Agjencia Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) janë përgjegjëse për implementimin e projektit, supervizimin e tij.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjekteve të audituara lidhur me çështjet nën auditim. Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

4. Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me implementimin e projektit shkallën e realizimit të objektivave etj.. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

5. Kriteret e vlerësimit:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligj nr. 24/2021, datë 22.02.2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për Programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro”;

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 8379, dt. 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse;

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; etj.

Vendimi nr. 116, datë 24.02.1997 “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr. 452, datë 01.07.1998 "Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huaj”;

Vendim nr. 28, datë 20.1.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit të investimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt AM Main (KfW), për Programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën 6 000 000 euro”;

Vendim nr. 29, datë 20.1.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit të Bashkimit Evropian, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt AM Main (KfW), për Bashkimin Evropian, për një mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, në shumën 23 300 000 euro”;

Vendim nr. 30, datë 20.1.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt AM MAIN (KfW), për masat shoqëruese për Programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën 3,000,000 euro”;

Vendim Nr. 31, datë 20.1.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit SECO ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt AM MAIN (KfW), për Programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën 13 300 000 euro”; etj.

6. Standardet e auditimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC, etj.

7. Metodatat e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm, me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

8. Dokumentimi i auditimit:

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara akt konstatimeve dhe akt verifikimeve, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të përgatitet Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Projekti “Infrastruktura bashkiake V”, është projekt i cili financohet nga Qeveria Gjermane dhe grante, miratuar me aktet ligjore të mëposhtme:

- Me Ligjin nr. 24/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e financave dhe ekonomisë (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën **80,000,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.28, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit të investimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën **6,000,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.29, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit të Bashkimit Evropian, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për Bashkimin Evropian, për një mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, në shumën **23,300,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.30, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për masat shoqëruese për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën **3,000,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.31, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit SECO ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën **13,300,000 euro**”.

KfW-ja do të rifinancojë huan e dhënë, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje me subvencione interesi nga fondet e buxhetit me interes të ulët të siguruara nga Republika Federale e Gjermanisë, për projekte që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për politika zhvillimi. Termat dhe kushtet e huas janë në përputhje me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohjen e Asistencës Zyrtare të Zhvillimit (ODA). Mbi këtë bazë dhe sipas kushtit që Republika Federale e Gjermanisë jep një garanci për hua, KfW-ja do të japë një hua, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje. Qëllimi i kredisë është që Huamarrësi do të përdorë Huan ekskluzivisht për financimin e Programit.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1 Për marrëveshjen e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimit i tyre.

Projekti “Infrastruktura bashkiake V”, është projekt i cili financohet nga Qeveria Gjermane dhe grante, miratuar me aktet ligjore të mëposhtme:

- Me Ligjin nr. 24/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e financave dhe ekonomisë (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën **80,000,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.28, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit të investimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën **6,000,000 euro**”.

- Me Vendimin e KM nr.29, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit të Bashkimit Evropian, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për Bashkimin Evropian, për një mjedis më të pastër – mbështetje për trajtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza, **në shumën 23,300,000 euro**”.
- Me Vendimin e KM nr.30, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për masat shoqëruese për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, **në shumën 3,000,000 euro**”.
- Me Vendimin e KM nr.31, datë 20.01.2021 “Për miratimin e marrëveshjes së grantit SECO ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (përfituesi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e Infrastrukturës Bashkiake V, në shumën **13,300,000 euro**”.

Tabela nr. 1: Burimet e Financimit

në euro

Burimi i financimit	Shuma
Hua	80,000,000
Grant i KfW	6,000,000
Grant i KfW	3,000,000
SECO	13,300,000
IPA	23,300,000
Totali	125,600,000

Burimi: PMU

KfW-ja do të rifinancojë huan e dhënë, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje me subvencione interesi nga fondet e buxhetit me interes të ulët të siguruara nga Republika Federale e Gjermanisë, për projekte që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për politika zhvillimi. Termat dhe kushtet e huas janë në përputhje me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohjen e Asistencës Zyrtare të Zhvillimit (ODA). Mbi këtë bazë dhe sipas kushtit që Republika Federale e Gjermanisë jep një garanci për hua, KfW-ja do të japë një hua, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje. Qëllimi i kredisë është që Huamarrësi do të përdorë Huan ekskluzivisht për financimin e Programit.

Në kuadrin e këtij Programi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjetësimit dhe të Kanalizimeve (“Njësia e koordinimit të programit” ose “NJKP”), do të veprojë si njësia e koordinimit të programit për drejtimin, koordinimin dhe zbatimin e përgjithshëm të Projektit, si dhe për kontraktimin dhe kryerjen e shërbimeve të konsulencës. Shoqëritë e shërbimeve të ujësjetësimit UK Berat-Kuçovë, UK Elbasan, UK Fier, UK Kamzë, UK Lezhë, UK Shkodër dhe UK Vlorë do të veprojnë si Agjenci të Zbatimit të Projektit (secila si “AZP”, bashkërisht si “AZP-të”).

Huamarrësi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, në kuadrin e Programit, do të garantojë që AZP-të të përdorin pjesë të fondeve të Huas ekskluzivisht për financimin e investimeve për përmirësimin e sistemeve të ujësjetësimit dhe të kanalizimeve në qytetin përkatës (secili “Projekt”). Huamarrësi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, përdor pjesën e mbetur të fondeve të Huas për financimin e shërbimeve të konsulencës, në lidhje me zbatimin e Programit.

Tabela nr. 2: Burimet e Financimit

në mln euro

Projekti	Shuma
Berat – Kuçova	12.8
Elbasan	13.8

Fier	13.5
Kamza	13.2
Lezha	16.1
Shkodra	19.5
Vlora	18.0
Shuma	125.6

Burimi: PMU

MIE/NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e Programit dhe furnizimet, mallrat, punimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja, si dhe shpërndarjen e fondeve të Huas ndërmjet AZP-ve dhe Huamarrësit, duke nënshkruar një marrëveshje të veçantë, e cila do të siglohet si e pranuar edhe nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrëveshja e veçantë).

Taksat dhe tarifatat e tjera publike që duhet të paguhet nga Huamarrësi ose ndonjë prej AZP-ve, si dhe detyrimet doganore, nuk do të financohen nga Huaja.

Huamarrësi kanalizon fondet e Huas të kërkuara për financimin e masave të investimit të përcaktuara në nenin 1.2 (Fondet e investimit) tek AZP-të. 90% e fondeve të investimit kanalizohen si grante të pashlyeshme me anë të marrëveshjeve të nëngrantit ndërmjet Huamarrësit dhe AZP-së përkatëse (Marrëveshjet e nëngrantit). 10% e fondeve të investimit kanalizohen në formën e huave me anë të Marrëveshjeve të nënhuas (Marrëveshjet e nënhuas), me një afat prej 40 vjetësh, duke përfshirë një periudhë 10-vjeçare pa penalitet (pa pagesë interesi, principali dhe tarifash gjatë kësaj periudhe pa penalitet). Marrëveshja e nënhuas do të jetë në euro dhe interesi do të jetë deri në 1% në vit.

Programi financohet nga Qeveria Gjermane nëpërmjet KfW, Qeveria Zvicerane nëpërmjet SECO, Bashkimi Evropian nëpërmjet WBIF dhe IPA 2018.

Nëpërmjet këtij programi, është parashikuar të rehabilitohen sistemet e ujësjellës kanalizimeve për qytetet Shkodër, Lezhë, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë. Gjithashtu synohet të ndërtohen Impiantet e Trajtit të Ujërave të Përdorura ITUP për qytetet Berat, Shkodër, si dhe do të përmirësohet niveli i trajtimit për impiantin ITUP e Lezhës. Qëllimi është përmirësimi i situatës së furnizimit me ujë, sanitetit si dhe rritjen e performancës së shoqërive të Ujësjetës Kanalizimeve që operojnë këto sisteme, nëpërmjet komponentit të mbështetjes institucionale të programit.

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023 konsulenti institucional në bashkëpunim me shoqëritë rajonale ujësjellës-kanalizime përgatiti planet e biznesit dhe planet e ndryshimit të tarifave, si kushte paraprake të vendosura për fillimin e punimeve.

Gjithashtu, u krye auditimi i performancës të shoqërive UK me qëllim certifikimin e arritjes së qëllimeve të vendosura dhe dhënies së aprovimit për fillimin e punimeve.

Gjatë vitit 2022-2023 përfundoi përgatitja e projekteve të detajuara teknike dhe u hapën procedurat e prokurimit për qytetet Elbasan, Vlorë, Fier. Në fillim të vitit 2024 kanë nisur zbatimet e punimeve për këto qytete me kohëzgjatje deri në fund të vitit 2025.

Gjatë vitit 2024 kanë përfunduar procedurat e tenderimit për kontratat e punimeve në Lezhë dhe Shkodër (komponenti ujësjellës). Në qytetin e Lezhës punimet kanë filluar në muajin Tetor 2024, ndërsa në qytetin e Shkodrës për komponentin ujësjellës është lidhur kontrata dhe pritet fillimi i punimeve. Punimet për këto dy qytete parashikohet të përfundojnë deri në fund të vitit 2026.

Për qytetin e Beratit janë dukë përfunduar procedurat e prokurimit dhe brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025 pritet të kontraktohen dhe të fillojnë punimet me kohëzgjatje deri në fillim të vitit 2027.

Për komponentin e kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Shkodër, në varësi të alokimit të fondeve IPA 2022, ku aktualisht është në proces negociimi marrëveshja e delegimit të fondeve nga Bashkimi Evropian tek KFW, parashikohet që në fillim të vitit 2025 të hapet procesi i tenderimit dhe brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025 parashikohet të kontraktohen punimet. Zbatimi i punimeve parashikohet të përfundojë brenda vitit 2027.

Me përfundimin e punimeve dhe vënien në punë të tyre do të kemi një ndikim pozitiv social dhe ekonomik.

Ndërmarrjet do të marrin mbështetje të mëtejshme institucionale për të pasur një operim të qëndrueshëm investimi, për të përmirësuar efikasitetin dhe për të lehtësuar zbatimin e planit të biznesit, planeve të funksionimit të mirëmbajtjes dhe planit të ndryshimit të tarifave.

Nuk k patur ndryshime të marrëveshjes.

2.2 Mbi shkallën e relizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshjet me Huadhënësit.

Në Marrëveshjen e Veçantë të datës 18.12.2020 dhe Amendamentin nr.2 të datës 01.11.2023 janë përcaktuar objektiva dhe treguesit e përcaktuar në Kornizën Logjike (logframe) të programit dhe përfshin të dhëna nga monitorimi i AKUM dhe raportet e auditimit të kryera në vitin 2022 dhe 2024.

II. Rezultati 1: Qëndrueshmëri e përmirësuar e shërbimeve bashkiake

Treguesi a: Mbulimi i kostove të drejtpërdrejta operative

- **Baza (2017):** 78%
- **Target (2027):** 100%

Të dhëna nga auditimi i vitit 2022:

- UK Elbasan – 80%
- UK Fier – 86%
- UK Lezhë – 140%
- UK Shkodër – 70%
- UK Vlorë – 70%
- **Mesatarja:** 89.2%

Të dhëna nga monitorimi i AKUM për vitin 2024:

- UK Rajoni Elbasan – 88.1%
- UK Rajoni Fier – 91.5%
- UK Rajoni Lezhë – 110.4%
- UK Rajoni Shkodër – 78%
- UK Rajoni Vlorë – 93.5%
- UK Rajoni Berat – 140.5%
- **Mesatarja:** 100.3%

Konkluzion:

Objektivi për vitin 2027 është arritur mesatarisht në vitin 2024, me një mbulim të kostove operative mbi targetin e vendosur.

Treguesi c: Numri i popullsisë që përfiton nga shmangia e përmbytjeve

- **Baza (2017):** 0
- **Target (2027):** 30,000

Ky objektivi lidhet me investimet në qytetin e Lezhës për ndarjen e rrjeteve të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të ndotura. Punimet kanë filluar në fund të vitit 2024 dhe sipas afatit të kontratës, përfundimi pritet brenda vitit 2026.

III. Rezultati 2: Përmirësimi i aksesit dhe përballueshmërisë së shërbimeve të ujit

Treguesi a: Orët mesatare të furnizimit me ujë në ditë

- **Baza (2017):** 13 orë
- **Target (2027):** 16 orë

Të dhëna nga auditimi i vitit 2022:

- UK Elbasan – 13.6 orë
- UK Fier – 22 orë
- UK Lezhë – 22.4 orë
- UK Shkodër – 23 orë
- UK Vlorë – 12.2 orë
- **Mesatarja:** 18.64 orë

Konkluzion:

Objektivi i përcaktuar për vitin 2027 është tejkaluar në disa rajone, ndërsa disa të tjera kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Treguesi b: Popullsia e lidhur me një sistem qendror të kanalizimeve të ujërave të ndotura

- **Baza (2017):** 0
- **Target (2027):** 44,000

Investimet e parashikuara për ndërtimin e Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) në Berat dhe Shkodër pritet të rrisin numrin e përfituesve në mbi 125,000 banorë deri në vitin 2027.

Treguesi c: Popullsia e lidhur me sistemin qendror të kanalizimeve

- **Baza (2017):** 0
- **Target (2027):** 3,000

Investimet në Lezhë, Fier, Elbasan, Berat dhe Shkodër kanë filluar në vitet 2023 dhe 2024 dhe pritet të përfundojnë deri në vitin 2026. Popullsia e përfituar është shumë më e madhe se targeti i parashikuar.

IV. Produkti 1: Forcimi i menaxhimit të infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve

Treguesi: Sisteme tarifore të përballueshme

- **Baza (2017):** 0%
- **Target (2027):** 100%

Të gjitha shoqëritë e përfshira në program kanë përgatitur planet 5-vjeçare të biznesit dhe kanë aplikuar për ndryshime tarifash pranë ERRU.

Treguesi: Miratimi i projekteve teknike

- **Baza (2017):** 0 projekte
- **Target (2027):** Të paktën 6 projekte

Janë miratuar 7 projekte në qytetet e përfshira në program, duke tejkaluar objektivin.

V. Produkti 2: Infrastruktura e përmirësuar e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve

Treguesi: Popullsia e furnizuar me ujë të pijshëm përmes sistemeve DMA

- **Baza (2017):** 0
- **Target (2027):** 110,000

Investimet në qytetet Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe Lezhë pritet të tejkalojnë objektivin deri në vitin 2027.

Treguesi: Rrjeti i kanalizimeve të përmirësuar

- **Baza (2017):** 0 km
- **Target (2027):** 15 km

Rehabilitimi i rrjeteve të kanalizimeve në Fier, Elbasan, Shkodër dhe Lezhë pritet të tejkalojë objektivin deri në vitin 2027.

Treguesi: Kapaciteti i trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN)

- **Baza (2017):** 0
- **Target (2027):** 45,000

ITUN Berat me kapacitet 45,000 banorë pritet të vihet në operim në vitin 2027.

VI. Produkti 3: Rritja e Ndërgjegjësisimit mbi Çështjet e Ujit dhe Ujërave të Zeza

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të ujërave dhe forcimit të transparencës në sektorin e ujit dhe ujërave të zeza, është planifikuar ndërgjegjësimi i grupeve të interesit për shërbimet dhe objektivat e sektorit, si dhe për politikën dhe prioritetet e Bashkimit Evropian në këtë fushë. Një aspekt i rëndësishëm i këtij procesi është promovimi i programit WOIP dhe rëndësia e tij në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit.

Për matjen e ndikimit të këtij produkti janë parashikuar tregues specifikë, të cilët do të përcaktohen në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit. Deri më tani:

- **Treguesi i performancës:** Për t'u përcaktuar në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit.
- **Vlera fillestare (2017):** Për t'u përcaktuar në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit.
- **Objekti për vitin 2027:** Për t'u përcaktuar në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit.

Në kuadër të shërbimeve të konsulentit institucional, është parashikuar komponenti i vizibilitetit, i cili është hartuar dhe aktualisht është në proces zbatimi. Kjo tregon progres drejt përmbushjes së objektivave të përcaktuara, ndërsa pritet që matja e rezultateve të formalizohet me finalizimin dhe zbatimin e plotë të Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit.

Nga auditimit konstatohet se:

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të ujërave dhe forcimit të transparencës në sektorin e ujit dhe ujërave të zeza, është planifikuar rritja e ndërgjegjësisimit të grupeve të interesit mbi shërbimet, objektivat dhe politikën e BE-së për ujërat, si dhe promovimi i programit WOIP. Për këtë qëllim, është parashikuar hartimi dhe zbatimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit, i cili do të shërbejë si bazë për matjen e performancës dhe arritjen e objektivave.

Megjithatë, nga vlerësimi i situatës rezulton se treguesit specifikë të performancës, vlera fillestare dhe objektivat për vitin 2027 nuk janë ende të përcaktuara në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit. Ndërkohë që ky plan është hartuar dhe është në proces zbatimi, mungesa e treguesve të qartë dhe objektivave të matshme pengon vlerësimin efektiv të progresit dhe ndikimit të aktiviteteve të ndërgjegjësisimit.

Në këtë fazë të zhvillimit të projektit, nuk është e mundur të vlerësohet shkalla e realizimit të objektivit për rritjen e ndërgjegjësisimit, pasi nuk ka një sistem të përcaktuar matjeje në dokumentet zyrtare. Kjo përbën një mangësi që duhet adresuar për të siguruar një monitorim efektiv dhe për të mundësuar vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve të realizuara deri më tani, pasi në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit duhet të shtohen tregues të qartë të performancës, vlera fillestare dhe objektivat për vitin 2027, në mënyrë që të mundësohet matja e progresit dhe raportimi i saktë mbi realizimin e objektivit të ndërgjegjësisimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 687/2 prot., datë 28.04.2025 (protokolluar në KLSH me nr.95/4 prot., datë 02.05.2025) ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit.

Në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së, subjekti i audituar, në mënyrë të përmbledhur, paraqet kundërshtimet si më poshtë:

Referuar konstatimeve sqarojmë se në kuadër të kontratës së konsulentit institucional, referencë aneksi 7 “time schedule”, përfshihet task/detyra 5 “Communication and visibility/komunikimi dhe vizibiliteti”, ku parashikohet plani i detajuar i kësaj detyre. Në këtë kuader nga konsulenti është përgatitur dhe aprovuar ky plan dhe është në proces zbatimi deri në përfundim të kontratës së konsulentit institucional.

*Lidhur me njohuritë e publikut mbi programin, në periudhën 23.12.2024 deri në 14.01.2025 është bërë dhe “survey” në formë pyetësori me 800 intervista. Në vazhdimësi në **webpage e programit** <https://wpip-mipv.al>, do të përfshihen informacione mbi objektivat specifike të performancës dhe rezultatet e pritshme.*

Qendrimi i grupit të auditimit. Duke vlerësuar sqarimet e dhëna nga subjekti i audituar në lidhje me planin e detajuar të komunikimit dhe vizibilitetit, vërehet se në faqen e internetit të referuar janë të pasqyruara vetëm objektivat, por mungon programi i detajuar. Për këtë arsye, observacioni nuk merret në konsideratë.

2.3 Mbi menaxhimin financiar të programit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare të fondeve kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave

“Infrastruktura Bashkiake V“ për disa prej bashkive përfituese është vazhdimësi e fazave të mëparshme të investimeve të programit. Përfshirja e këtyre bashkive që kanë qene pjesë edhe e fazave të mëparshme është kompletimi i rehabilitimit të plotë sistemeve të ujësjellësit dhe përmirësimi në vazhdimësi i performancës financiare dhe teknike të shoqërive ujësjellës kanalizime që i menaxhojnë. Keto qytete janë Lezhe, Fier.

Ndërsa për disa qytete të tjera që futen si të reja në këtë program është vazhdimësi e investimeve të mëparshme të kryera nga projekte të tjera me financim nga buxheti i shtetit apo donatore, ku gjithashtu synohet kompletimi i rehabilitimit të plotë sistemeve të ujësjellësit. Gjithashtu në disa prej qyteteve fillon rehabilitimi rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura duke përfshirë edhe ndërtimin e Impianteve të Trajtimit të Ujrave të Ndotura në dy prej qyteteve. Keto qytete janë Shkoder, Elbasan, Vlore, Berat.

Disa prej qyteteve janë pjesë e vijës bregdetare dhe rehabilitimi i sistemeve të ujësjellës kanalizimeve kontribuon direkt në përmirësimin e kushteve gjatë sezonit turistik gjë që është në përputhje me prioritetet e Qeverisë për sektorin e ujësjellës kanalizimeve.

Fazat e mëparshme të programit “Infrastruktura Bashkiake I dhe II“ kanë përfunduar dhe vënë në funksion përgjatë vitit 2017 duke përmirësuar dukshëm situatën e furnizimit me ujë të pijshëm. Fazat e programit “Infrastruktura Bashkiake III dhe IV“ ku ecuria e punimeve ishte në përputhje me parashikimet pa vonesa që mund të shkaktonin shtyrje të përfundimit dhe ku punimet përfunduan përgjatë vitit 2021.

“Infrastruktura Bashkiake V“ synohet për të filluar menjëherë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2020 me përgatitjen e projekteve të detajuara teknike në mënyrë që të garantohej vazhdimësia e investimeve të programit pas përfundimit të punimeve gjatë fazave III dhe IV.

Programi “Infrastruktura Bashkiake V“ është i organizuar në dy faza: 1) faza përgatitore; 2) faza e zbatimit.

Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një përkthim të vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të secilës prej marrëveshjeve të nëngrantit dhe nënhas të specifikuar në nenin 2.1.

Mospërgjegjësia e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Kanalizimi i Huas nuk përbën ndonjë përgjegjësi të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

Bazuar në nenin 3, sapo të gjitha kushtet, para disbursimit, në zbatim të nenit 3.3 (Kushtet para disbursimit) të kësaj Marrëveshjeje të përmbushen, KfW-ja do të disbursojë Huan në përputhje me progresin e Programit dhe me kërkesën e Huamarrësit, nëpërmjet NJKP-së.

Tabela nr. 3: Disburimi sipas marrëveshjes

Periudha	Data efektive e fillimit të periudhës (përfshirë)	Data efektive e mbarimit të periudhës (me përjashtim të)	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative) në euro
1	1.1.2021	30.6.2021	3,000,000.00
2	1.7.2021	31.12.2021	12,500,000.00
3	1.1.2022	30.6.2022	22,500,000.00
4	1.7.2022	31.12.2022	32,500,000.00
5	1.1.2023	30.6.2023	42,500,000.00
6	1.7.2023	31.12.2023	52,500,000.00
7	1.1.2024	30.6.2024	62,500,000.00
8	1.7.2024	31.12.2024	72,500,000.00
9	1.1.2025	31.12.2027	80,000,000.00

Burimi: PMU

KfW-ja do të kryejë disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo periudhë disbursimi të specifikuar në shtojcën 1. Në masën që Huamarrësi kërkon disbursim me shumë më të ulët brenda ndonjë periudhe të tillë, shumat e padisburuara mund të kërkojnë në secilën prej periudhave vijuese. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime prej më pak se 200,000.00 eurosh.

Nga auditimi rezulton se:

Tabela nr. 4: Burimet e Financimit

Në euro

	Total	KfW loan	KfW grant	KfW ACM grant	EU IPA 18 grant	SECO grant
Shuma totale	125,600,000	80,000,000	6,000,000	3,000,000	23,300,000	13,300,000
2021	292,060	233,880	-	-	-	58,179
2022	500,873	400,059	-	-	-	100,815
2023	10,904,680	8,410,945	-	549,520	815,964	1,128,250
2024	10,688,359	8,842,994	-	378,960	580,997	885,408
Deri 24.02.2025	6,134,045	5,529,731	-	145,610	247,524	211,180
Shuma e disbursuar	28,520,020	23,417,610	-	1,074,091	1,644,486	2,383,833
%	22.7%	29.2%	0%	36.8%	7%	17.9%

Burimi: PMU

Nga auditimi rezulton se ka një ritëm shumë të ulët të disbursimit krahasuar me grafikun e miratuar në marrëveshje. Vlera e disbursuar sipas marrëveshjes deri në 31.12.2024 duhet të ishte 72,500,000 euro ose 90.6% e kredisë ndërkohë vlera e disbursuar realisht është 23,417,610 euro ose 29.27% e kredisë.

KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 dhjetor 2027.

Nga auditimi u konstatua se janë kryer rregullisht raportimet në lidhje me disbursimet e fondeve të projektit në Ministrinë e Financave, në përputhje me VKM nr. 116, datë 24.02.1997 “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive”, si dhe Udhëzimin nr. 8, datë 17.02.2003 të MF “Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Republikës së Shqipërisë”.

KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje vetëm nëse janë plotësuar kushtet pararendëse të mëposhtme në një mënyrë të pranueshme për KfW-në në formë.

KfW-ja zotëron një dokument origjinal të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Marrëveshjes së Veçantë, secila e nënshkruar me fuqi ligjërish detyruese; dhe KfW-ja ka të drejtë, përpara çdo disbursimi nga Huaja, që të kërkojë dokumente dhe prova të mëtejshme që i çmon të nevojshme, sipas diskrecionit të saj, për të konstatuar kushtet para disbursimit, të specifikuar në këtë seksion.

Nëse Huamarrësi anulon disbursimin e një shume Huaje, për të cilën është përcaktuar një përqindje interesi, sipas nenit 3.5 (E drejta për anulimin e disbursimeve) të kësaj Marrëveshjeje ose, nëse kjo shumë Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet deri në afatin e caktuar në nenin 3.2 (Afati për kërkimin e disbursimit) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesën e saj, shumën që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për humbjet, shpenzimet ose kostot e shkaktuara nga KfW-ja, si rezultat i mosdisbursimit të shumës së Huas (Tarifa e mosshfrytëzimit”), përveç kur ky mosdisbursim përbën shkelje të kësaj Marrëveshjeje Huaje nga KfW-ja. KfW-ja do të llogarisë shumën e tarifës së mosshfrytëzimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit. Tarifa e mosshfrytëzimit do të përcaktohet sikur asnjë subvencion interesi të mos ishte dhënë nga Republika Federale e Gjermanisë për Programin.

Bazuar në nenin 4, Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme (Tarifa e angazhimit) për shumat e padisbursuara të Huas.

Tarifa e angazhimit duhet të paguhet për pagesën e prapambetur çdo gjashtë muaj, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, për herë të parë më 15 maj 2021, por jo më herët se sa në datën përkatëse pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi dhe efekt sipas nenit 15.10 (Hyrja në fuqi dhe efekt) të kësaj Marrëveshjeje.

Tarifa e angazhimit do të ngarkohet nëse është e zbatueshme, me efekt prapaveprues, për periudhën që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe që zgjat deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit definitiv të disbursimeve nga Huaja.

Tarifa e angazhimit llogaritet si më poshtë:

i. për periudhën që fillon 12 muaj pas datës së nënshkrimit nga KfW-ja të kësaj Marrëveshjeje Huaje, nëse është e zbatueshme me efekt prapaveprues, deri 24 muaj pas nënshkrimit nga KfW-ja të kësaj Marrëveshjeje Huaje, tarifa e angazhimit do të arrijë shumën 0,125 % në vit (me fjalë: zero pikë njëqind e njëzet e pesë për qind në vit); dhe

ii. për periudhën vijuese që fillon 24 muaj pas nënshkrimit nga KfW-ja të kësaj Marrëveshjeje Huaje, tarifa e angazhimit do të arrijë shumën prej 0,25 % në vit (me fjalë: zero pikë njëzet e pesë për qind në vit).

Tabela nr. 5: Pagesa e tarifës së angazhimit
në euro

Data e pagesës	Vlera e paguar
16.05.2022	40,719.5
15.11.2022	49,653.34
15.05.2023	89,940.4
15.11.2023	98,672.78

15.05.2024	90,887.6
15.11.2024	83,951,15
Totali	453,824

Burimi: PMU

Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2024 është paguar 453,824 euro si tarifë angazhimi e cila është kosto e shtuar për buxhetin e shtetit për shkak të ecurisë shumë të ngadaltë të projektit dhe mos disbursimit në kohë sipas grafikut.

Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë menaxhimi të pakthyeshme në një shumë të vetme prej 0,5 % të shumës së Huas të përcaktuar në nenin 1.1 (Shuma) të kësaj Marrëveshjeje (Tarifa e menaxhimit).

Tarifa e menaxhimit paguhet në datën më të hershme të dy datave të mëposhtme: i. përpara disbursimit të parë; ose ii. pas kalimit të tre muajve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Huaje nga KfW-ja ose pas kalimit të një muaji nga hyrja në fuqi dhe efekt e kësaj Marrëveshjeje Huaje (cilado datë e mëvonshme e përcaktuar sipas pikës "ii"). Tarifa e menaxhimit duhet të paguhet sapo kjo Marrëveshje Huaje të jetë nënshkruar, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht apo vetëm pjesërisht ose nuk është disbursuar.

Tarifa e angazhimit është paguar më 23.04.2021 në vlerën 400,000 euro.

Huamarrësi do t'i paguajë interes KfW-së si më poshtë:

Norma fikse e interesit e caktuar pas disbursimit të Huas. Huamarrësi do të paguajë interes mbi Huan, sipas dispozitave të mëposhtme:

Huamarrësi do të paguajë interes për secilën shumë të Huas në një normë (Norma fikse e interesit) të përcaktuar nga KfW-ja brenda dy ditësh bankare (siç përcaktohet në nenin 15.1 (Ditë bankare) të kësaj Marrëveshjeje) para disbursimit të shumës përkatëse të Huas dhe që do të përbëhet nga:

Norma e shkëmbimit e përcaktuar në bazë të faqes R. "I." ose nëse kjo faqe nuk përmban detajet e nevojshme ose nëse nuk është e aksesueshme, në faqen B. "I" (ose në një faqe vijuese që zëvendëson faqet R. ose B. të përcaktuara më lart). Nëse të dyja faqet nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme ose janë të pazëvendësueshme, KfW-ja do të përcaktojë këtë normë mbi bazën e kostove të saj efektive të financimit në tregun e kapitalit në euro për maturimet që u korrespondojnë periudhave përkatëse të interesit fiks, sa më afër që të jetë e mundur,

ii. plus një marzh prej 0.55 % në vit që merr parasysh fondet e grantit të vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Nëse norma e interesit e llogaritur në përputhje me sa më lart bie nën 0% në vit, norma fikse e interesit do të jetë 0% në vit.

Norma fikse e interesit e përcaktuar në këtë mënyrë do të zbatohet derisa të jetë marrë kësti i fundit i shlyerjes në pajtim me skedulën e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

Nëse është kryer më shumë se një disbursim nga Huaja, KfW-ja do të konsolidojë normat e interesit të caktuara për secilën shumë Huaje në një normë interesi të vetme pas secilit disbursim. Kjo normë e konsoliduar interesi fiks do t'i korrespondojë mesatares së ponderuar të normave individuale të interesit të rrumbullakosura deri në 1/10,000 të një pikë për qind, nëse presja dhjetore e parë e hequr është më e ulët se 5 ose e rrumbullakosur deri në 1/10,000 të një pike për qind, nëse presja e parë dhjetore e hequr është e barabartë ose më e madhe se 5 dhe do të jetë baza për llogaritjen e mëtejshme të interesit nga data e secilit disbursim deri në disbursimin e ardhshëm. Pas disbursimit të plotë të Huas, norma mesatare e interesit e përcaktuar në këtë mënyrë do të zbatohet derisa kësti i fundit i shlyerjes të jetë marrë në përputhje me skedulën e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

KfW-ja do t'i njoftojë Huamarrësit Normën Fikse të Interesit të caktuar sipas nenit 5.1(a) (Norma e interesit) të kësaj Marrëveshjeje, pa vonesë, pasi të jetë caktuar. KfW-ja do t'i njoftojë Huamarrësit normën e interesit të konsoliduar sipas nenit 5.1(b) (Konsolidimi) të kësaj Marrëveshjeje në datën e ardhshme të pagesës (siç përcaktohet në nenin 5.3 (Datat e pagesës) të kësaj Marrëveshjeje.

Interesi për një shumë Huaje të disbursuar do të ngarkohet që nga data (ekskluzivisht) në të cilën shuma përkatëse e Huas disbursohet nga llogaria e Huas e mbajtur me KfW-në për Huamarrësin deri në datën (përfshirë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së, siç specifikohet në nenin 7.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) të kësaj Marrëveshjeje. Interesi do të llogaritet në përputhje me nenin 7.1 (Llogaritja) të kësaj Marrëveshjeje.

Interesi do të jetë i kërkueshëm në shuma të prapambetura për pagesë në datat e specifikuara më poshtë (secila një “Datë pagese”):

a) përpara datës së pagesës të kësaj Marrëveshjeje të parë të shlyerjes, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më herët sesa në datën e pagesës pas datës në të cilën kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi dhe efekt sipas nenit 15.11 (Hyrja në fuqi dhe efekt) të kësaj Marrëveshjeje;

b) në datën e pagesës së kësaj Marrëveshjeje të parë të shlyerjes sipas nenit 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje së bashku me një kësht të tillë;

c) më pas në datën e pagesës së kësaj Marrëveshjeje të shlyerjes sipas nenit 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

Sipas nenit 6 Huamarrësi do të shlyejë Huan, si më poshtë:

Tabela nr. 6: Burimet e Financimit

Në euro

	Data e pagesës	Kësti i shlyerjes
1	15 maj 2026	3,809,523.80
2	15 nëntor 2026	3,809,523.80
3	15 maj 2027	3,809,523.80
4	15 nëntor 2027	3,809,523.80
5	15 maj 2028	3,809,523.80
6	15 nëntor 2028	3,809,523.80
7	15 maj 2029	3,809,523.80
8	15 nëntor 2029	3,809,523.80
9	15 maj 2030	3,809,523.80
10	15 nëntor 2030	3,809,523.80
11	15 maj 2031	3,809,523.80
12	15 nëntor 2031	3,809,523.80
13	15 maj 2032	3,809,523.80
14	15 nëntor 2032	3,809,523.80
15	15 maj 2033	3,809,523.80
16	15 nëntor 2033	3,809,523.80
17	15 maj 2034	3,809,523.80
18	15 nëntor 2034	3,809,523.80
19	15 maj 2035	3,809,523.80
20	15 nëntor 2035	3,809,523.80
21	15 maj 2036	3,809,524.00

Burimi: Ligji i Marrëveshjes

Ky skedul i shlyerjes mund të rregullohet herë pas here, në përputhje me nenin 6.5 (Skeduli i rishikuar i pagesës).

Shumat e padisbursuara të Huasë: Shumat e padisbursuara të Huas do të kompensohen kundrejt këstit përkatës të shlyerjes së fundit që duhet të paguhet sipas skedulit të shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur KfW-ja, me diskrecionin e vet, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në raste individuale.

Shlyerjet në rastin e disbursimit jo të plotë: Nëse një këst shlyerjeje duhet të paguhet përpara se Huaja të disbursohet plotësisht, kjo nuk do të cenojë skedulin e shlyerjes, sipas nenit 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje, për sa kohë që kësti i shlyerjes për t'u paguar sipas skedulit të shlyerjes është më i ulët sesa shuma e Huas e disbursuar dhe që nuk është shlyer ende (Shuma e Huas për t'u paguar). Nëse kësti i shlyerjes që duhet të paguhet në përputhje me nenin 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje tejkalon shumën e Huas për t'u paguar, ky këst shlyerjeje do të reduktohet në nivelin e shumës së Huas për t'u paguar dhe diferenca do të alokohet në mënyrë të barabartë në këstet e shlyerjes që duhen paguar. Në llogaritjen e shumës së Huas për t'u paguar, KfW-ja rezervon të drejtën për të konsideruar disbursime nga Huaja, të cilat kryhen brenda një periudhe prej 45 ose më pak ditësh para një date pagese për të përcaktuar shumën e Huas për t'u paguar vetëm për datën vijuese të pagesës.

Pagesa e TVSH

Nga auditimi rezulton se TVSh e paguar për kontrata e punimeve:

MIP V - Kontratat e punimeve per qytetet Elbasan, Fier, Vlore, Shkoder (ujesjelles)

Kontrata dt. 24/07/2023 midis SHRUK Elbasan dhe subjektit S. AG "Rehabilitation works for the water supply system of Elbasan, Albania BMZ-Nr. 2013 66 467/SBF-Nr. 13078"

Elbasan	Financimi i huaj (Euro)	Vlera e TVSH-se (lek)	Nr. &Data e urdher-shpenzimit
Adv. Payment - Paradhënia	2,496,395.38	52,049,844.90	Nr. 356, 18.12.2023
IPC 1 - Situacioni 1	1,463,077.18	39,075,521.10	Nr. 197, 01.07.2024
IPC 2 - Situacioni 2	1,466,145.95	34,620,155.55	Nr. 294, 17.09.2024
IPC 3 - Situacioni 3	943,332.64	20,493,847.35	Nr. 419, 16.12.2024
IPC 4 - Situacioni 4	597,316.41	14,349,733.44	Per tu paguar me hapjen e buxhetit te vitit 2025

Kontrata dt. 19/10/2023 midis SHRUK Fier dhe subjektit A. shpk "Rehabilitation works for the Water Supply & Wastewater system of Fier, Albania BMZ-Nr. 2013 66 467/SBF-Nr. 13078"

Fier	Financimi i huaj (Euro)	Vlera e TVSH-se (lek)	Data e urdher-shpenzimit
Adv. Payment - Paradhënia	2,436,946.03	50,664,108.38	Nr. 358, 18.12.2023
IPC 1 - Situacioni 1	538,804.49	14,813,019.39	Nr. 195, 01.07.2024
IPC 2 - Situacioni 2	622,462.66	15,013,115.54	Nr. 341, 21.10.2024
IPC 3 - Situacioni 3	802,172.76	18,505,591.08	Nr. 431, 24.12.2024

Kontrata dt. 14/09/2023 midis SHRUK Vlorë dhe subjektit A. G. LLC "Rehabilitation works for the water supply system of Vlora, Albania BMZ-Nr. 2013 66 467/SBF-Nr. 13078"

Vlore	Financimi i huaj (Euro)	Vlera e TVSH-se (lek)	Data e urdher-shpenzimit
Adv. Payment - Paradhënia	3,358,834.06	69,326,334.79	Nr. 360, 19.12.2023
IPC 1 - Situacioni 1	2,192,705.17	62,463,754.61	Nr. 196, 01.07.2024
IPC 2 - Situacioni 2	1,092,033.71	23,123,204.97	Nr. 375, 13.11.2024

Kontrata dt. 14/09/2023 midis SHRUK Shkoder dhe subjektit A. G. LLC "Rehabilitation works for the water supply system of Shkodra, Albania BMZ-Nr. 2013 66 467/SBF-Nr. 13078"

Shkoder	Financimi i huaj (Euro)	Vlera e TVSH-se (lek)	Data e urdher-shpenzimit
Adv. Payment - Paradhënia	1,839,800.00	36,115,274.00	Per tu paguar me hapjen e buxhetit te vitit 2025
IPC 1 - Situacioni 1	1,330,419.04	30,108,523.18	Per tu paguar me hapjen e buxhetit te vitit 2025

Pagesat për rimbursimin e TVSh-së janë kryer pas kërkesës së paraqitur nga kontraktorët duke bashkëlidhur pagesën e keryer ata vet ndaj Drejtorisë së Tatimeve.

Ecuria e kontratave të punimeve:

Kontrata dt. 24/07/2023 midis SHRUK Elbasan dhe subjektit S. AG "Rehabilitation works for the water supply system of Elbasan, Albania BMZ-Nr. 2013 66 467/SBF-Nr. 13078"

Data e Kontratës	24.07.2023
Data e fillimit të punimeve	01.12.2023
Data e përfundimit të punimeve	02.06.2025
Kohëzgjatja (ditë)	550
Data aktuale	27.01.2025
Koha që ka kaluar (ditë) (% ToC)	424 (77.1 %)
Realizimi fizik i projektit	41.7
Vlera e kontratës	12,481,976.94 Euro

Kontrata dt. 19/10/2023 midis SHRUK Fier dhe subjektit A. shpk "Rehabilitation works for the Water Supply & Wastewater system of Fier, Albania BMZ-Nr. 2013 66 467/SBF-Nr. 13078"

Data e Kontratës	19.10.2023
Data e fillimit të punimeve	11.12.2023
Data e përfundimit të punimeve	01.09.2025
Kohëzgjatja (ditë)	630
Data aktuale	27.01.2025
Koha që ka kaluar (ditë) (% ToC)	413 (65.5 %)
Realizimi fizik i projektit	35%
Vlera e kontratës	12,184,730.18 Euro

Kontrata dt. 14/09/2023 midis SHRUK Vlorë dhe subjektit A. G. LLC "Rehabilitation works for the water supply system of Vlora, Albania BMZ-Nr. 2013 66 467/SBF-Nr. 13078"

Data e Kontratës	14.09.2023
Data e fillimit të punimeve	11.12.2023
Data e përfundimit të punimeve	01.09.2025
Kohëzgjatja (ditë)	630
Data aktuale	27.01.2025
Koha që ka kaluar (ditë) (% ToC)	413 (65.5 %)
Realizimi fizik i projektit	46.5%
Vlera e kontratës	16,794,170.30 Euro

Kontrata dt. 14/09/2023 midis SHRUK Shkoder dhe subjektit A. G. LLC "Rehabilitation works for the water supply system of Shkodra, Albania BMZ-Nr. 2013 66 467/SBF-Nr. 13078"

Data e Kontratës	30.09.2024
Data e fillimit të punimeve	30.12.2024
Data e përfundimit të punimeve	03.07.2026
Kohëzgjatja (ditë)	550 Days
Data aktuale	27.01.2025
Koha që ka kaluar (ditë) (% ToC)	29 (5.2%)
Realizimi fizik i projektit	0%
Vlera e kontratës	9,199,000 Euro

Referuar ecurisë së ulët të zbatimit të kontratave të punimeve, auditimi i tyre do të kryhet në përfundim të projektit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 687/2 prot., datë 28.04.2025 (protokolluar në KLSH me nr.95/4 prot., datë 02.05.2025) ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit.

Tarifa e angazhimit: Lidhur me këtë gjetje sqarojmë se tarifa e angazhimit është e parashikuar si kosto në nenin 4 të marrëveshjes së huasë dhe vlera prej 453,824 është vlera e paguar deri tani por jo e gjitha kjo vlerë është kosto e shtuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Të gjitha arsyet që ju keni parashtuar janë pikërisht veprimet dhe mosveprimet e Inistucioneve të përfshira të cilat kanë sjell vonesa të pajustificuara të cilat kanë sjell pikërisht mos disbursimin në kohë të fondeve dhe aplikimin e tarifës së disburimit nga ana e huadhënësit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë, pasi nuk ka argumentim dhe mbështetje ligjore.

2.4 Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të prokurimit të përcaktuarasipas rastit në marrëveshjet me huadhënësint ose legjislacioni shqiptar.

Procedura e prokurimit "Shërbime Konsulentit"

Njoftimi për fazën parakualifikuese për prokurimin "Shërbim Konsulence - Programi Infrastruktura Bashkiake V" është publikuar në faqen "gtai.de" më 10.02.2021, në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW (versioni i janarit 2019, pika 2.5.1, Publikimi i njoftimit për tender).

Po ashtu, njoftimi i parakualifikimit është publikuar edhe në faqen "Simap" në të njëjtën datë, në përputhje me kërkesat e bashkëfinancuesit të shërbimeve të konsulentit institucional, Sekretariatit Shtetëror për Punët Ekonomike (SECO) të Zvicrës.

Afati për dorëzimin e aplikimeve:

Afati për dorëzimin e aplikimeve ka qenë data 12.03.2021, ora 11:00.

Afati është vendosur në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), pika 2.4.10 "Afatet e dorëzimit", ku citohet se afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 30 ditë kalendarike.

Hartimi i dokumentacionit parakualifikues:

KfW ka aprovuar dokumentet e parakualifikimit me shkresën e datës 04.02.2021, me objekt: "Nuk ka kundërshtime lidhur me dokumentet e parakualifikimit".

Komisioni i vlerësimit të procedurës së prokurimit:

Titullari i Njesisë Koordinuese të Programit (PCU), Autoriteti Kontraktor për shërbimet e Konsulentit Institucional, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), me urdhër nr. 545, datë 02.03.2021, ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: "Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit për masat trajnuese institucionale në kuadër të programit Infrastruktura Bashkiake V".

Drejtori i Përgjithshëm i AKUM, z. A.B, me urdhrin e mësipërm ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit dhe përzgjedhjen e konsulentit për masat trajnuese institucionale në kuadër të programit Infrastruktura Bashkiake V, me përbërjen si më poshtë:

- J.GJ – Kryetar
- A.M. – Anëtar
- A.B. – Anëtar

Letra qarkulluese

Gjatë periudhës nga publikimi i njoftimit për parakualifikim deri në dorëzimin e aplikimeve nga operatorët ekonomikë të interesuar, janë paraqitur kërkesa për sqarime. Për këtë qëllim, është përgatitur dhe dërguar tek të gjithë të interesuarit Letra Qarkulluese nr. 1, e cila përmban një set prej pesë (5) pyetjesh dhe përgjigjesh.

Sipas dokumenteve të parakualifikimit, Seksioni II, Parashikime të Veçanta, pika 2.5.1, afati përfundimtar për dorëzimin e pyetjeve ka qenë deri në 14 ditë para afatit të dorëzimit të aplikimeve, pra deri më 27.02.2021. Letra Qarkulluese nr. 1, datë 26.02.2021, është dërguar tek të gjithë të interesuarit rreth 15 ditë para afatit të dorëzimit të aplikimeve.

Faza e parë

Vlerësimi paraprak

Referuar dokumentacionit të administruar (hard copy) nga grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se dokumentacioni, si në formatin hard copy ashtu edhe në formatin soft copy, është administruar nga Agjencia Koordinuese e Programit PCU/AKUM. Aplikimet e dorëzuara janë hapur më 16.03.2021, ora 10:00, nga dy anëtarë të komisionit të përcaktuar në urdhrin nr. 545, datë 02.03.2021, të titullarit të AKUM, konkretisht nga J.GJ dhe A.B..

Ky veprim është në mospërputhje me urdhrin e sipërcituar, duke ngarkuar me përgjegjësi z. J.GJ, z. A.B. dhe z. A.M., në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të procedurës

Referuar shkresës së mbajtur nga dy anëtarët e komisionit të vlerësimit të prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit institucional (pa datë dhe pa nr. protokollit), kanë shprehur interes 8 (tetë) shoqëri konsulente si më poshtë:

1. C.C.E.&C.H&S.E.S. (nr. 599 prot., datë 10.03.2021)
2. D. I. C. & A.G., I & B. W. P. C. (nr. 600 prot., datë 10.03.2021)
3. F. & H. & U – U. R. I. (nr. 606 prot., datë 10.03.2021)

4. G C. G. & S. W. G & I. und U. (nr. 589 prot., datë 08.03.2021)
5. G. I. & A. (nr. 607 prot., datë 10.03.2021)
6. H. I. & S. C. E. (nr. 632 prot., datë 12.03.2021)
7. S. & M. E. & W. & S. E. (nr. 590 prot., datë 08.03.2021)
8. H. I. & S B B A (nr. 617 prot., datë 11.03.2021)

Nga auditimi konstatohet se:

- Për shkak të mungesës së informacionit mbi procesin e protokollimit të dokumentacionit parakualifikues të dorëzuar nga shoqëritë konsulente, grupi i auditimit të KLSH kërkoi informacion pranë protokollit të AKUM. Informacioni i siguruar është pasqyruar më sipër nga grupi i auditimit për secilin subjekt pjesëmarrës.
- Zyra e protokollit pranë AKUM, nuk ka mbajtur procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit parakualifikues tek NJKP, duke mos respektuar kushtin që zarfat duhej të dorëzoheshin jo më herët se 12.03.2021, ora 11:00, në përputhje me parashikimet e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), versioni Janar 2019, Seksioni II, Parashikime të Veçanta, pika 3.2.1.

Vlerësimi i Komisionit për Fazën Parakualifikuese

Komisioni i ngritur për vlerësimin e procedurës së përzgjedhjes së konsulentit institucional ka pranuar të 8-të shoqëritë konsulente, të cilat kanë respektuar afatin kohor të dorëzimit të dokumentacionit paraprak pranë AKUM, për të vijuar me:

1. Vlerësimin e Përputhshmërisë Administrative
2. Vlerësimin e Kriteve për Kualifikim sipas Sistemit të Pikëzimit, ku përfshihet:
 - Eksperienca e aplikantëve
 - Eksperienca në projekte të ngjashme
 - Eksperienca në projekte në vende në zhvillim ose në fazë tranzicioni
 - Eksperienca në projekte në vendet e Evropës Juglindore
3. Kapacitetet e Aplikantëve, ku përfshihet:
 - Vlerësimi cilësor i kapaciteteve njerëzore të aplikantëve
 - Vlerësimi sasior i kapaciteteve njerëzore të aplikantëve
 - Përputhshmëria e aplikimit me projektin

Sipas raportit përfundimtar të komisionit, vetëm OE "H. I. & S B B A" nuk është kualifikuar, pasi nuk ka paraqitur referenca bindëse dhe nuk ka ofruar dëshmi për përvojën në zbatimin e projekteve të ngjashme. Gjithashtu, nuk ka treguar ndonjë përvojë në "menaxhimin e rrezikut të fatkeqësive" dhe informacioni i paraqitur për personelin nuk është në përputhje me pritshmërinë për këtë projekt.

Sipas raportit përfundimtar të komisionit të vlerësimit, janë kualifikuar për të vijuar me vlerësimin teknik dhe financiar 7-të shoqëri konsulentë, si më poshtë:

1. C.C.E.&C.H&S.E.S.
2. D. I. C. & A.G., I & B. W. P. C.
3. F. & H. & U – U. R. I.
4. G C. G. & S. W. G & I. und U.
5. G. I. & A.
6. H. I. & S. C. E.
7. S. & M. En. & W. & S. E.

Vlerësimi për Pikëzimin

Referuar dokumentit të parakualifikimit, Seksioni I – Parashikime të Përgjithshme, pika 3 (Dorëzimi i aplikimeve), nën-pika 4.2.4, punëdhënësi do të refuzojë një aplikim nëse:
Aplikanti është vlerësuar me më pak se 70 pikë.

Në bazë të këtij kushti, janë vlerësuar me mbi 70 pikë Operatoret Ekonomik të mëposhtëm:

1. G C. G. & S. W. G & I. und U. – **93.68 pikë**
2. C.C.E.&C.H&S.E.S. – **87.85 pikë**
3. D. I. C. & A.G., I & B. W. P. C. – **86.37 pikë**
4. G. I. & A. – **85.72 pikë**
5. S. & M. E. & W. & S. E.– **85.41 pikë**

KfW ka aprovuar vlerësimin e parakualifikimit me shkresën datë 09.09.2021, me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit të Parakualifikimit”.

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit, “*Tender Agjenti*”, me email datë 13.09.2021, ka njoftuar 5 OE e suksesshëm mbi rezultatet e vlerësimit.

Hartimi i dokumentave të tenderit

“Tender Agjenti”, në bashkëpunim me PCU dhe KfW, ka përgatitur dokumentet e tenderit, të cilat janë aprovuar nga KfW me shkresën e datës 10.12.2021, me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Dokumentet e Tenderit”.

Në vijim, “Tender Agjenti”, në bashkëpunim me PCU, me e-mail-in e datës 20.12.2021, u ka dërguar 5 (pesë) aplikantëve të parakualifikuar Ftesën për Ofertë, së bashku me setin e dokumenteve të tenderit. Në këtë dokumentacion është përcaktuar afati për dorëzimin e ofertave në datën 11.02.2022, i cili është në përputhje me afatin minimal prej 45 ditësh kalendarike, sipas Udhëzuesve të Prokurimit të KfW, pika 2.4.10 – Afatet e dorëzimit, (2) Dorëzimi i ofertave.

Gjatë periudhës midis dërgimit të Ftesës për Ofertë dhe dorëzimit të ofertave nga aplikantët e parakualifikuar, janë paraqitur kërkesa për sqarime.

Për këtë qëllim, janë përgatitur dhe dërguar tek të gjithë aplikantët Letra Qarkulluese nr.1, nr.2, nr.3 dhe nr.4, të cilat përmbajnë gjithsej 22 (njëzet e dy) pyetje dhe përgjigje.

Referuar dokumenteve të tenderit, Seksioni II – Të dhënat për ofertë, pika 13.1, afati përfundimtar për dorëzimin e pyetjeve ka qenë deri në 14 ditë para afatit për dorëzimin e ofertave, konkretisht deri më 25.02.2022.

Në vijim, janë dërguar tek të gjithë të interesuarit:

- Letra Qarkulluese nr.1, datë 19.01.2022
- Letra Qarkulluese nr.2, datë 26.01.2022
- Letra Qarkulluese nr.3, datë 07.02.2022
- Letra Qarkulluese nr.4, datë 12.02.2022

Këto dokumente janë dërguar brenda afateve të përcaktuara për dorëzimin e ofertave.

Bazuar në kërkesat e aplikantëve, afati fillestar për dorëzimin e ofertave është shtyrë në datën 25.02.2022, ora 14:00.

Faza e dytë e vlerësimit

Pas njoftimit të tenderit, “Tender Agjenti” ka ftuar 5 shoqëritë e parakualifikuara, të cilat ishin vlerësuar me më shumë se 70 pikë, për të dorëzuar ofertat e tyre teknike dhe financiare, të ndara nga njëra-tjetra.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, konstatohet se:

Në raportin përkatës të vlerësimit të fazës së dytë, anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk kanë evidentuar numrin e protokollit hyrës të AKUK për secilën nga ofertat e dorëzuara.

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka marrë informacion nga zyra e protokollit të AKUK dhe ka vendosur numrin përkatës të protokollit dhe datën e dorëzimit të ofertave, të cilat paraqiten si më poshtë:

- G. C. G. & S. W. G. & I. und U.; V. A. – 93.68 pikë (nr. 370 prot., datë 25.02.2022)
- C.C.E.&C.H&S.E.S. – 87.85 pikë (nr. 341 prot., datë 22.02.2022)
- D. I. C. & A.G., I & B. W. P. C. – 86.37 pikë (nr. 365 prot., datë 25.02.2022)
- G. I. & A. – 85.72 pikë (nr. 357 prot., datë 24.02.2022)
- S. & M. E. & W. & S. E.– 85.41 pikë (nr. 332 prot., datë 21.02.2022)

Nga auditimi konstatohet se:

Nuk është mbajtur një procesverbal ndërmjet zyrës së protokollit të AKUM dhe NJKP-së për marrjen në dorëzim të zarfave me ofertat teknike dhe financiare të këtyre shoqërive.

Vlerësimi i ofertave teknike:

Pas dorëzimit të ofertave teknike dhe financiare nga 5 shoqëritë e parakualifikuara, dhe bazuar në të dhënat e zyrës së protokollit, rezulton se shoqëritë kanë respektuar afatin e dorëzimit më 25.02.2022.

Komisioni i përbërë nga J.GJ, A.M. dhe A.B. ka kryer hapjen e ofertave teknike, e më pas të atyre financiare, duke përgatitur raportin përfundimtar të vlerësimit teknik më 07.10.2022 dhe raportin e vlerësimit financiar më 19.10.2022.

Koha e zgjatur e vlerësimit

Nga auditimi konstatohet se, vlerësimi teknik nga anëtarët e komisionit të vlerësimit është kryer me një vonesë kohore të konsiderueshme nga data e dorëzimit të ofertave deri në përfundimin e vlerësimit financiar kanë kaluar 8 muaj, një periudhë e gjatë kohore, e cila mund të ishte përfunduar brenda 2 muajsh.

Megjithëse dokumentacioni i KfW-së nuk parashikon një afat specifik për këtë proces, kjo vonesë është e pajustificueshme. Ajo ka ndikuar në shtyrjen e përzgjedhjes së konsulentit përtej afateve të parashikuara në shtojcën e marrëveshjes fillestare për këtë projekt.

Kriteret e Vlerësimit

Metoda e aplikuar e vlerësimit, e cila është bazuar në udhëzuesit e prokurimit të KfW-së, është "Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto" (QCBS).

Gjatë fazës së vlerësimit të propozimeve teknike, aplikantët duhej të merrnin të paktën 75 pikë për të vijuar më tej me hapjen e ofertave financiare.

Vlerësimi Teknik

Pas hapjes së zarfave nga Komisioni i Vlerësimit, rezultatet për secilën shoqëri pjesëmarrëse janë si më poshtë:

- C.C.E.&C.H&S.E.S.
 - Koncepti dhe Metodologjia: 29.15 pikë nga 45.00 pikë
 - Kualifikimet e Stafit të propozuar: 44.53 pikë nga 55.00 pikë
- D. I. C. & A.G., I & B. W. P. C.
 - Koncepti dhe Metodologjia: 29.15 pikë nga 45.00 pikë
 - Kualifikimet e Stafit të propozuar: 41.13 pikë nga 55.00 pikë
- G. C. G. & S. W. G. & I. und U.; V. A.
 - Koncepti dhe Metodologjia: 31.10 pikë nga 45.00 pikë
 - Kualifikimet e Stafit të propozuar: 44.08 pikë nga 55.00 pikë

- G. I. & A.
 - Koncepti dhe Metodologjia: 17.30 pikë nga 45.00 pikë
 - Kualifikimet e Stafit të propozuar: 37.47 pikë nga 55.00 pikë
- S. & M. En. & W. & S. E.
 - Koncepti dhe Metodologjia: 38.65 pikë nga 45.00 pikë
 - Kualifikimet e Stafit të propozuar: 44.82 pikë nga 55.00 pikë

Nga auditimi konstatohet se:

Sipas raportit të vlerësimit të komisionit për shoqërinë S. & M. En. & W. & S. E., thuhet se: *"Dy ekspertët e propozuar si Udhëheqës dhe Zëvendës Udhëheqës të Ekipit janë të pranueshëm nga kualifikimet, megjithatë, Udhëheqësi i propozuar ka një profil të dobët në raport me detyra specifike. Aplikanti ka paraqitur një ekip të fortë ekspertësh kryesorë, si ndërkombëtarë ashtu edhe kombëtarë, përjashtuar Ekspertin Ndërkombëtar nr. 1. Gjithashtu, në ekipin e ekspertëve shtesë janë propozuar 4 nga 6 ekspertë teknikë, duke përfshirë edhe ekspertin e IT-së, i cili ka përvojë në programim dhe SCADA."*

Rezultatet e vlerësimit teknik

Nga auditimi konstatohet se, Komisioni i Vlerësimit ka kryer vlerësimin teknik për operatorët ekonomikë të parakualifikuar si më poshtë:

1. S. & M. E. & W. & S. E. – 83.47 pikë
2. D. I. C. & A.G., I & B. W. P. C. – 80.13 pikë
3. G. C. G. & S. W. G. & I. und U.; V. A. – 75.18 pikë
4. C.C.E.&C.H&S.E.S. – 73.68 pikë
5. G. I. & A. – 54.77 pikë

KfW ka miratuar vlerësimin e ofertave teknike me shkresën e datës 14.10.2022, me objekt: "Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit Teknik".

Vlerësimi i Propozimeve Financiare

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit teknik, më datë 17.10.2022, ora 09:00, anëtarët e komisionit të vlerësimit kanë hapur ofertat financiare të operatorëve ekonomikë që kishin marrë mbi 75 pikë gjatë vlerësimit teknik, ku sipas raportit të komisionit ofertat financiare paraqitet si më poshtë:

- S. & M. E. & W. & S. E. – **4,755,985 euro**
- D. I. C. & A.G., I & B. W. P. C. – **5,240,759.50 euro**
- G. C. G. & S. W. G. & I. und U.; V. A. – **6,382,100 euro**

Vlerësimi i Kombinuar Teknik dhe Financiar

Formula për vlerësimin e kombinuar teknik dhe financiar, ku 80% i takon vlerësimit teknik dhe 20% vlerësimit financiar, është: $S=(T*0.8) + (F*0.2)$

Ku:

- S është rezultati përfundimtar i ofertuesit.
- T është rezultati i vlerësimit teknik (pikët e marra).
- F është rezultati i vlerësimit financiar (i konvertuar në pikë).

Vlerësimi financiar llogaritet sipas formulës:

$$F = \left(\frac{P_{min}}{P} \right) * 100$$

Ku:

- P_{min} është çmimi më i ulët i ofertuar.
- P është çmimi i ofertuesit që po vlerësohet.

Rezultatet e Vlerësimit të Kombinuar

Nga auditimi konstatohet se vlerësimi i kombinuar për operatorët ekonomikë është si më poshtë:

1. S. & M. E. & W. & S. E.– **86.77 pikë**
2. D. I. C. & A.G., I & B. W. P. C. – **82.26 pikë**
3. G. C. G. & S. W. G. & I. und U.; V. A. – **75.04 pikë**

Në bazë të këtij vlerësimi, Komisioni ka rekomanduar shpalljen fitues të operatorit ekonomik S. & M. E. & W. & S. E., me ofertën financiare prej **4,755,985 euro**. KfW ka miratuar vlerësimin e kombinuar të ofertave teknike dhe financiare me shkresën e datës 11.11.2022, me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin Final të Vlerësimit”.

Pas këtij miratimi, Titullari i Agjencisë Koordinuese të Programit (PCU), si Autoriteti Kontraktor për shërbimet e Konsulentit Institucional, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), me shkresën nr. 2598 prot., datë 16.12.2022, ka njoftuar S. & M. E. & W. & S. E. si fitues të kontratës së shërbimeve të konsulencës institucionale.

Hartimi i Kontratës së Konsulentit

Në vijim, Agjenti i Tenderit, në bashkëpunim me PCU dhe KfW, ka përgatitur dokumentin e kontratës për shërbimet e konsulencës, i cili është miratuar nga KfW me shkresën datë 13.12.2022, me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Dokumentin e Kontratës”.

Pas këtij miratimi, është lidhur kontrata për shërbimet e konsulencës institucionale me nr. 99 prot., datë 19.01.2023, ndërmjet Autoritetit Kontraktor (AKUK) dhe operatorit ekonomik S. & M. E. & W. & S. E..

Për sa më lart është trajtuar, në mënyrë të përmbledhur konstatohet se:

a. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të procedurës së përzgjedhjes së konsulentit institucional nuk kanë dokumentuar marrjen e zarfave të ofertave me anë të një procesverbali nga zyra e protokollit të AKUK, veprim që ka krijuar mungesë transparence në administrimin e dokumenteve të ofertuesve.

b. Aplikimet e dorëzuara për fazën e parakualifikimit janë hapur më 16.03.2021, ora 10:00, nga dy anëtarë dhe jo nga tre anëtarë, siç është përcaktuar në urdhrin nr. 545, datë 02.03.2021, të titullarit të AKUM.

c. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të procedurës për përzgjedhjen e konsulentit institucional kanë kryer vlerësimin teknik të ofertave 8 (tetë) muaj pas dorëzimit të tyre, periudhë kjo e tejzgjatur në vend të një periudhe të arsyeshme dy mujore. Kjo vonesë ka ndikuar në shtyrjen e përzgjedhjes së konsulentit përtej afateve të përcaktuara në marrëveshjen fillestare dhe, si pasojë, në shtyrjen e afateve kohore të zbatimit të projektit.

Me veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohen z. J.GJ, z. A.B. dhe z. A.M., në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 687/2 prot., datë 28.04.2025 (protokolluar në KLSH me nr.95/4 prot., datë 02.05.2025) ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit.

Në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së, subjekti i audituar, në mënyrë të përmbledhur, paraqet kundërshtimet si më poshtë:

- Në Marrëveshjen e Veçantë datë 18.12.2020, pika 2.3 Procurement and contractual provisions – Prokurimet dhe dispozitat kontraktuale, citohet se të gjitha proceset e tenderimeve do të kryhen sipas Udhëzuesit të Prokurimeve të KfW, aneksi 5.

Hapja e aplikimeve të dorëzuara është kryer vetëm nga dy anëtarët e komisionit, në përputhje me Udhëzuesit e Prokurimeve të KfW versioni Janar 2019, pika 2.5.4 Opening of Applications/Offers – hapja e aplikimeve/ofertave, ku citohet:

Hapja e Aplikimeve/Ofertave në çdo rast do të bëhet nga një komision i përbërë nga të paktën dy anëtarë të pavarur.

Gjithashtu mos-prezenca në hapjen e aplikimeve të anetarit të tretë, lidhet me angazhime të tjera në detyra paralele.

Rezulton se kushti i përcaktuar i Udhëzuesit të Prokurimeve të KfW, është plotësuar.

Sqarojme se zhvillimi i procedurës së prokurimit duhet të përputhet me Udhëzuesit e Prokurimeve të KfW dhe si e tillë nuk është në mos-respektim të urdherit nr. 545, datë 02.03.2021.

Sqarojmë se vonesa në vlerësimin e propozimeve teknike dhe financiare justifikohet me faktet se volumi i punës ka qënë i madh ku u vlerësuan 5 propozime komplekse, kompleksiteti i vlerësimit së bashku me dy tender agjentët, ngarkesa e vlerësuesëve në procese punë paralele etj.

Në thelb shërbimet e konsulentit institucional i shërbejnë shoqërive UK të përfshirë në program për arritjen e targeteve të performancës së programit dhe në këtë kuadër fillimet e shërbimeve të konsulentit institucional të spostuara në kohë nuk kanë ndikuar në fillimin e punimeve në terren pasi konsulenti institucional gjatë periudhës kohore janar-qershor 2023 së bashku me shoqëritë UK të përfshirë në program, ka përgatitur në kohë planet e biznesit dhe planet e ndryshimit të tarifave që shërbenin për arritjen e targetit të dytë të vendosur në program, pra para kontraktimit të punimeve shoqëritë UK duhet të përgatisnin planet e biznesit dhe planet e ndryshimit të tarifave ku provonin qëndrueshmërinë e indikatorëve të performancës.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Për sa është observuar dhe sqaruar nga subjekti i audituar në lidhje me:

Subjekti, në mënyrë indirekte, ka pranuar mungesën e një anëtari për arsye të mbingarkesës dhe mosdorëzimit të dokumentacionit pa procesverbal, duke sjellë si argument procedurën sesi i administron zarfat, pa paraqitur asnjë dokumentacion shtesë mbështetës. Në këto kushte, observacioni për këto pika nuk do të pranohet.

Në lidhje me kohën e gjatë të vlerësimit, subjekti nuk ka paraqitur kundërshtime me ndonjë arsye të qenësishme, por vetëm për shkak të mbingarkesës. Prandaj, observacioni për këtë pikë nuk merret në konsideratë.

-Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Shërbime Konsulenti Teknik për qytetet Fier, Sarandë, Vlore”.

Njoftimi i parakualifikimit për prokurimin “Shërbim Konsulente - Programi Infrastruktura Bashkiake V” është botuar në website “gtai.de” në datën 02.02.2018, në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW (pika 2.5.1 Publikimi i njoftimit për tender).

Afati për dorëzimin e aplikimeve:

Afati për dorëzimin e aplikimeve ka qënë data 16.03.2018.

Afati i vendosur është në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane Për Zhvillim KfW, pika 2.4.10 “Afatet e dorëzimit”, ku citohet se afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 30 ditë kalendarike.

Hartimi i dokumentacionit parakualifikues:

KfW ka aprovuar dokumentet e parakualifikimit me shkresën e datës 19.01.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me dokumentet e parakualifikimit”.

Komisioni i vlerësimit të procedurës së prokurimit:

Titullari i Agjencisë Koordinuese të Programit PCU, Autoritetit Kontraktor për shërbimet e Konsulentit Institucional, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve AKUK, me urdhrin nr.27, datë 02.03.2018 ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit për përgatitjen e studimit të fizibilitetit në kuadër të programit Infrastruktura Bashkiake V - qytetet Fier, Sarandë, Mallakastër/Vlorë”, me përbërje si më poshtë:

- J.GJ - Kryetar
- A.M. - Anëtar
- A.B. - Anëtar

Letra qarkulluese

Gjatë periudhës nga publikimi i njoftimit për parakualifikim dhe deri në dorëzim të aplikimeve nga operatorë ekonomikë të ndryshëm të interesuar janë dorëzuar kërkesa për sqarime për të cilat janë përgatitur dhe dërguar tek të gjithë të interesuarit Letrat Qarkulluese nr. 1 dhe nr. 2 që përmbajnë setin prej 14 (katërmëdhjetë) pyetje dhe përgjigje.

Referuar dokumenteve të parakualifikimit, Seksioni II, Parashikime të Veçanta, pika 2.5.1, afati përfundimtar për dorëzimin e pyetjeve ka qenë deri në 14 ditë para afatit për dorëzimin e aplikimeve, ose data 27.02.2021.

Letra Qarkulluese nr.1, datë 15.02.2018 është dërguar tek të gjithë të interesuarit rreth 29 ditë para afatit për dorëzimin e aplikimeve.

Letra Qarkulluese nr.2, datë 20.02.2018 është dërguar tek të gjithë të interesuarit rreth 24 ditë para afatit për dorëzimin e aplikimeve.

Faza e parë

Vlerësimi paraprak

Referuar dokumentacionit të administruar (hard copy) nga grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se dokumentacioni, si në formatin hard copy ashtu edhe në formatin soft copy, është administruar nga Agjencia Koordinuese e Programit PCU/AKUK. Aplikimet e dorëzuara janë hapur në datën 19.03.2018 nga tre anëtarë të komisionit të përcaktuar në urdhrin nr. 545, datë 02.03.2021, të titullarit të AKUK, konkretisht nga J.GJ, A.M. dhe A.B.. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit referues, nuk ka referencë për numrin e protokollit të dorëzimit pranë AKUK.

Referuar shkresës së mbajtur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit institucional (pa nr. protokollit), kanë shprehur interes 24 (njëzet e katër) shoqëri konsulente si më poshtë:

1. A. (nr. 785 prot., datë 15.03.2018)
2. C.. (nr.806 prot., datë 16.03.2018)
3. C.G. (nr. 781 prot., datë 15.03.2018)
4. D. I. C. & A. G., I (nr. 805 prot., datë 16.03.2018)
5. F. & A. & S. (nr. 771 prot., datë 13.03.2018)
6. G. G&C. E. K. & S. G. &P.-c. Sh.p.k (nr.782 prot., datë 15.03.2018)
7. G.-I. G. & I. I.-G. f. I. P. m & H. A. SHPK (nr. 727 prot., datë 09.03.2018)
8. G. C. G. & V. G. Sh.p.k (nr.687 prot., datë 06.03.2018)
9. H. A. & Gj. & C. Ltd (nr.763 prot., datë 13.03.2018)
10. H. I.-G. m. & S. C. E. Srl (nr.618 prot., datë 01.03.2018)

11. I. C. Z. G. & N. O'D. Ltd (nr.794prot., datë 15.03.2018)
12. I. C. E. A. G. & h. G. (nr.784prot., datë15.03.2018)
13. I. G. & C. K & L. (nr.636 prot., date 02.03.2018)
14. K. C. G. & n E. & D. (nr.802 prot., datë 16.03.2018)
15. K. + K. E. E. G. & I. d. & H. p. & H. d.. & T. sh.p.k. (nr. 804 prot., datë 16.03.2018)
16. p. b. G. & I. E. & A. (nr.796 prot., datë 15.03.2018)
17. R. E. C. S. & P. S. LTD (nr. 778prot., datë 15.03.2018)
18. S. & C. K & D. B. I. (nr.783prot., datë 15.03.2018)
19. S. E. C. S. (nr.803 prot., date 16.03.2018)
20. S S. & P. I.- C. & 47 E 79 & I. P. (nr.779 prot., datë 15.03.2018)
21. T. S. & C. & S. G. I. A. (nr.772 prot., date 13.03.2018)
22. T. y P. S. & G. A (nr.797 prot., datë 15.03.2018)
23. 3. P. & N E. S.. (nr.770prot., date 13.03.2018)
24. "i. A." (nr.828 prot., datë 19.03.2018)

Nga auditimi konstatohet se:

- Për shkak të mungesës së informacionit mbi procesin e protokollimit të dokumentacionit parakualifikues të dorëzuar nga shoqëritë konsulente, grupi i auditimit të KLSH kërkoi informacion pranë protokollit të AKUK. Informacioni i siguruar është pasqyruar më sipër nga grupi i auditimit për secilin subjekt pjesëmarrës.
- Zyra e protokollit pranë AKUK nuk ka mbajtur procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit parakualifikues tek NJKP, duke mos respektuar kushtin që zarfat duhej të dorëzoheshin jo më herët se data 12.03.2021, ora 11:00, në përputhje me parashikimet e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), Seksioni II, Parashikime të Veçanta, pika 3.2.1.

Vlerësimi i Komisionit për Fazën Parakualifikuese

23 shoqëritë i kanë dorëzuar aplikimet përpara skadimit të afatit të dorëzimit tek AKUK, ndërsa 1 (një) shoqëri "i. A." ka dorëzuar aplikimin përtej afatit të vendosur në dokumentet e parakualifikimit dhe është s'kualifikuar.

Komisioni i ngritur për vlerësimin e procedurës së përzgjedhjes së konsulentit ka pranuar të 23 shoqëritë konsulente, të cilat kanë respektuar afatin kohor të dorëzimit të dokumentacionit paraprak pranë AKUK, për të vijuar me:

1. Vlerësimi i Pëputhshmërisë Administrative
2. Vlerësimi i Kriteve për Kualifikim sipas Sistemit të Pikëzimit
 - Eksperienca e aplikantëve
 - Eksperienca në projekte të ngjashme
 - Eksperienca në projekte në vende në zhvillim ose në fazë tranzicioni
 - Eksperienca në projekte në vendet e Evropës Juglindore
3. Kapacitetet e Aplikantëve
 - Vlerësimi cilësor i kapaciteteve njerëzore të aplikantëve
 - Vlerësimi sasior i kapaciteteve njerëzore të aplikantëve
 - Lidhshmëria e aplikimit me projektin

Sipas raportit përfundimtar të komisionit, kompanitë "C." dhe "S. E. " nuk kanë dorëzuar asnjë formular dhe pasqyrat financiare, si rrjedhim janë s'kualifikuar.

Në përfundim, janë kualifikuar për të vijuar me vlerësimin teknik dhe financiar 21 shoqëri konsulente:

1. S. E. G. & Co. KG
2. S. S. & P. I.- C. G.

3. C.
4. I. C. E. A. G.
5. p be. G.
6. G. C. G.
7. F. W. &T. G.
8. K. C. G.
9. G.-I. G.
10. K. + K. E. E. G.
11. D. I. C. A. G. I.
12. G. G.&C. E. K
13. IW. G . K.
14. T.S.
15. T. y P. S.
16. H. I. - G. G.
17. a. c. I. G.
18. H. A.
19. I. C. Z. G.
20. R. E. C. S.
21. 3. P.

Vlerësimi për Pikëzimin

Referuar dokumentit të parakualifikimit, Seksioni I - Parashikime të Përgjithshme, pika 3 (Dorëzimi i aplikimeve), nënpika 4.2.4, punëdhënësi do të refuzojë një aplikim nëse: Aplikanti është vlerësuar me më pak se 70 pikë.

Në bazë të këtij kushti janë vlerësuar me mbi 70 pikë aplikimet, si vijon:

1. S. E. G. & Co. KG	89.28 pikë
2. S. S. P. I. - C. G.	87.10 pikë
3. C.G.	80.90 pikë
4. I. C. E. A. G.	78.78 pikë
5. p be. G.	78.63 pikë
6. G. C. G.	78.60 pikë
7. F. W. &T. G.	78.37 pikë
8. K. C. G.	75.67 pikë
9. G.-I. G.	74.70 pikë

KfW ka aprovuar vlerësimin e parakualifikimit me shkresën datë 21.11.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit të Parakualifikimit”.

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit, agjenti i tenderit me email datë 28.11.2018 ka njoftuar të 5 aplikantët e mësipërm të suksesshëm mbi rezultatet e vlerësimit.

Hartimi i dokumentave të tenderit

Agjenti i Tenderit me email 28.11.2018 ka njoftuar aplikantët e pa-suksesshëm mbi rezultatet dhe në bashkëpunim me PCU dhe KfW kanë përgatitur dokumentet e tenderit, të cilat KfW i ka aprovuar me shkresën datë 27.11.2018 me objekt “Nuk ka kundërshtime lidhur me Dokumentet e Tenderit”.

Në vijim Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me PCU, me email datë 28.11.2018 i ka dërguar 5 aplikantëve të parakualifikuar “Ftesën për Ofertë”, së bashku me setin e dokumenteve të tenderit. Në këto dokumenta është përcaktuar edhe afati për dorëzimin e ofertave në datën 18.01.2019, i cili është në përputhje me afatin minimal 45 ditë kalendarike, sipas Udhëzuesve të Prokurimit të KfW pika 2.4.10-Afatet e dorëzimit, (2) dorëzimi i ofertave.

Gjatë periudhës nga dërgimi i ftesës për ofertë dhe deri në dorëzim të ofertave nga aplikuesit e parakualifikuar nuk ka patur kërkesa për sqarime dhe afati fillestar për dorëzimin e ofertave nuk është shtyrë.

Faza e dytë e vlerësimit

Pas njoftimit të tenderit, agjenti i tenderit ka ftuar 5 shoqëritë e parakualifikuara, të cilat ishin vlerësuar me më shumë se 70 pikë, për të dorëzuar ofertat e tyre teknike dhe financiare, të ndara nga njëra-tjetra.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, konstatohet se komisioni i vlerësimit nuk ka evidentuar numrin e protokollit hyrës të AKUK për secilën nga ofertat e dorëzuara. Grupi i auditimit ka marrë informacion nga zyra e protokollit të AKUK dhe ka vendosur numrin përkatës të protokollit dhe datën e dorëzimit të ofertave, të cilat paraqiten si më poshtë:

- “p. b.” (nr.167 prot., datë 18.01.2019)
- “S. E. ” (nr.138 prot., datë 17.01.2019)
- S. (nr.211 prot., datë 21.01.2019)

Nga auditimi konstatohet se:

-Nuk është mbajtur një procesverbal ndërmjet zyrës së protokollit të AKUK dhe NJKP-së për marrjen në dorëzim të zarfave me ofertat teknike dhe financiare të këtyre shoqërive.

Vlerësimi i ofertave teknike:

PCU dhe Agjenti i Tenderimit janë informuar zyrtarisht në datë 07.01.2019 nga CES dhe në datë 09.01.2019 nga ILF, se këta dy konsulentë për shkak të ngarkesës dhe mungesës së kapaciteteve nuk do të dorëzonin ofertë për këtë fazë.

Ofertat janë dorëzuar brenda afatit vetëm nga 2 (dy) aplikantët e parakualifikuar.

PCU ka marrë në dorëzim 2 oferta përpara afatit të parashikuar të dorëzimit, datë 18.01.2019, ora 13:00: ofertat e konsulenteve “p. b.” dhe të “S. E. ”. Konsulenti S. ka dorëzuar me vonese përtej afatit ofertën në datën 21.01.2019. Dorëzimi në afat ishte kriter thelbësor i parashikuar në dokumentet e tenderit, për këtë arsye konsulenti SRP, është skualifikuar.

Komisioni i përbërë nga J.GJ, A.M. dhe A.B. ka kryer hapjen e ofertave teknike, e më pas të atyre financiare, duke përgatitur raportin përfundimtar të vlerësimit teknik më 04.02.2019 dhe raportin e vlerësimit financiar më 12.02.2019.

Kriteret e Vlerësimit

Metoda e vlerësimit e aplikuar, bazuar në udhëzuesit e prokurimit të KfW -së, është “Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto” (QCBS).

Gjatë fazës së vlerësimit të propozimeve teknike, aplikantët duhej të merrnin të paktën 75 pikë për të vijuar më tej me hapjen e ofertave financiare.

Vlerësimi Teknik

Pas hapjes së zarfave nga Komisioni i Vlerësimit, rezultatet për secilën shoqëri pjesëmarrëse janë si më poshtë:

- S. E. G. & Co. KG

Koncepti dhe Metodologjia: 37.38 pikë nga maksimumi 40.00 pikë.

Kualifikimet e Stafit të propozuar: 58.24 pikë nga maksimumi 60.00 pikë.

- p be. G.

Koncepti dhe Metodologjia: 35.98 pikë nga maksimumi 45.00 pikë.

Kualifikimet e Stafit të propozuar: 48.87 pikë nga maksimumi 55.00 pikë.

Rezultatet e vlerësimit teknik

- S. E. G. & Co. KG &D. është vlerësuar me 95.62 pikë.
- p. b. G. & R. E. & A. 4 është vlerësuar me 84.85 pikë.

KfW ka aprovuar vlerësimin e ofertave teknike me shkresën e datës 06.02.2019 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit Teknik”.

Vlerësimi i Propozimeve Financiare

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit teknik, në datën 07.02.2019 ora 09.00 nga PCU janë hapur ofertat financiare të aplikantëve që u vlerësuan me më shumë se 75 pikë gjatë vlerësimit të propozimeve teknike, nga ku rezulton si vijon:

1. Oferta financiare e ofruar nga “S. E. G. & Co. KG &D.” është 4,111,850 euro.
2. Oferta financiare e ofruar nga “p. b. G. & R. E. & A. 4” është 4,098,805 euro.

Vlerësimi i kombinuar teknik dhe financiar

Referuar dokumenteve të tenderit ku pesha e vlerësimit teknik është 70% dhe pesha e vlerësimit financiar është 30% Vlerësimi i Kombinuar Teknik dhe Financiar

Formula për vlerësimin e kombinuar teknik dhe financiar, ku 80% i takon vlerësimit teknik dhe 20% vlerësimit financiar, është: $S = (T*0.7) + (F*0.3)$

Ku:

- S është rezultati përfundimtar i ofertuesit.
- T është rezultati i vlerësimit teknik (pikët e marra).
- F është rezultati i vlerësimit financiar (i konvertuar në pikë).

Vlerësimi financiar llogaritet sipas formulës:

$$F = \left(\frac{P_{min}}{P} \right) * 100$$

Ku:

- P_{min} është çmimi më i ulët i ofertuar.
- P është çmimi i ofertuesit që po vlerësohet.

Rezultatet e Vlerësimit të Kombinuar

Nga auditimi konstatohet se vlerësimi i kombinuar për operatorët ekonomikë është si më poshtë:

1. Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “S. E. G. & Co. KG &D.” - 99.90 pikë.
2. Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “p. b. G. & R. E. & A. 4” - 92.12 pikë.

Bazuar në këto rezultate është rekomanduar për fitues aplikanti i renditur i pari me pikë që është konsulentit “S. E. G. & Co. KG &D.” me ofertë 4,111,850 euro.

Hartimi i Kontratës së Konsulentit

Në vijim Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me PCU dhe KfW kanë përgatitur dokumentin e kontratës së shërbimeve të konsulencës, të cilën KfW e ka aprovuar me shkresën e datës 04.04.2019 me objekt “Nuk ka kundërshtime lidhur me Dokumentin e Kontratës”.

Agjenti i Tenderit me email datë 29.04.2019 ka njoftuar subjektin e pa-suksesshëm “p. b. G. & R. E. & A. 4” mbi rezultatet.

Pas aprovimit të raportit dhe Dokumentit të Kontratës, është lidhur kontrata e shërbimeve të konsulentit teknik me nr.1164 prot., datë 15.04.2019 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUK) dhe subjektit “S. E. G. & Co. KG &D.”.

-Mbi auditimin e procedurës së prokurimit “Shërbime Konsulentit Teknik për qytetin Elbasan”.

Njoftimi i parakualifikimit për prokurimin “Shërbim Konsulence - Programi Infrastruktura Bashkiake V” është botuar në website “gtai.de” në datën 02.02.2018, në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim KfW (pika 2.5.1 “Publikimi i njoftimit për tender”).

Afati për dorëzimin e aplikimeve:

Afati për dorëzimin e aplikimeve ka qenë data 05.03.2018.

Afati i vendosur është në përputhje me kërkesat e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane Për Zhvillim KfW, pika 2.4.10 Afatet e dorëzimit, (1) dorëzimi i aplikimeve, ku citohet se afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 30 dite kalendarike.

Hartimi i dokumentacionit parakualifikues:

KfW ka aprovuar dokumentet e parakualifikimit me shkresën e datës 19.01.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me dokumentet e parakualifikimit”.

Komisioni i vlerësimit të procedurës së prokurimit:

Titullari i Agjencisë Koordinuese të Programit PCU, Autoritetit Kontraktor për shërbimet e Konsulentit Institucional, Agjencia Kombetare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve AKUM, me urdhër nr.25, datë 02.03.2018 ka ngritur komisionin për vlerësimin e prokurimit me objekt: “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e tenderit për përzgjedhjen e konsulentit për përgatitjen e studimit të fizibilitetit në kuadër të programit Infrastruktura Bashkiake V – qyteti Elbasan”, me përbërje si më poshtë:

- J.GJ – Kryetar
- A.M. – Anëtar
- A.B. – Anëtar

Letra qarkulluese

Gjate periudhës nga publikimi i njoftimit për parakualifikim dhe deri në dorëzim të aplikimeve nga operatorët ekonomike të ndryshëm të interesuar nuk janë dorëzuar kërkesa për sqarime.

Faza e parë

Vlerësimi paraprak

Referuar dokumentacionit të administruar (hard copy) nga grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se dokumentacioni, si në formatin hard copy ashtu edhe në formatin soft copy, është administruar nga Agjencia Koordinuese e Programit PCU/AKUM. Aplikimet e dorëzuara janë hapur në datën 06.03.2018 nga tre anëtarë të komisionit të përcaktuar në urdhrin nr. 545, datë 02.03.2021, të titullarit të AKUK, konkretisht nga J.GJ, A.M. dhe A.B.. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit referues, nuk ka referencë për numrin e protokollit të dorëzimit pranë AKUK.

Referuar shkresës së mbajtur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të prokurimit për përzgjedhjen e konsulentit institucional (pa datë dhe pa nr. protokollit), kanë shprehur interes 19 shoqëri konsulente si më poshtë:

Shprehjen e interesit e kanë shfaqur 19 (nëntëmbëdhjetë) shoqëri konsulente si vijon:

1. C. C. E. S. G. (nr. 627 prot., datë 02.03.2018)
2. D. C. E. I. L. P. G. (nuk rezulton e regjistruar në protokollin e AKUK)
3. D. I. C. G. A. G. A. M. (nuk rezulton e regjistruar në protokollin e AKUK)

4. F. W. T. G. A. S. S. W. G. (nr. 686 prot., datë 06.03.2018)
5. G. G. E. K. & S. G. & P. S. (nr. 616 prot., datë 01.03.2018)
6. G. C. G. & I. I. G. F. I. P. G. & H. G. & H. A. S. (nr. 684 prot., datë 06.03.2018)
7. G. C. G. (nr. 688 prot., datë 06.03.2018)
8. H. G. & I. C. R. A. G. (nr. 672 prot., datë 05.03.2018)
9. H. I. m. (nr. 672 prot., datë 05.03.2018)
10. I. C. Z. G. H. C. E. S. (nr. 642 prot., datë 05.03.2018)
11. i. A. & Pr. B. d. & I. C. E sh.p.k (nr. 647 prot., datë 05.03.2018)
12. I. W. G. & C. K. & L. I. S.. (nr. 636 prot., datë 02.03.2018)
13. K. & E. W. G. & D. L. (nr. 646 prot., datë 05.03.2018)
14. P & P. G. (nr. 652 prot., datë 05.03.2018)
15. p & E. (nr. 648 prot., datë 05.03.2018)
16. T. S. (C. & S. di Guiseppe) (nr. 673 prot., datë 05.03.2018)
17. 3. & N S. & S. G. (nr. 645 prot., datë 05.03.2018)
18. C. (nr. 644 prot., datë 05.03.2018)
19. D. e. (nr. 671 prot., datë 05.03.2018)

Nga auditimi konstatohet se:

- Për shkak të mungesës së informacionit mbi procesin e protokollimit të dokumentacionit parakualifikues të dorëzuar nga shoqëritë konsulente, grupi i auditimit të KLSH kërkoi informacion pranë protokollit të AKUM. Informacioni i siguruar është pasqyruar më sipër nga grupi i auditimit për secilin subjekt pjesëmarrës.
- Zyra e protokollit pranë AKUM nuk ka mbajtur procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit parakualifikues tek NJKP, duke mos respektuar kushtin që zarfat duhej të dorëzoheshin jo më herët se 03.05.2018, ora 11:00, në përputhje me parashikimet e Udhëzuesve të Prokurimit të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), Seksioni II, Parashikime të Veçanta, pika 3.2.1.

Vlerësimi i Komisionit për Fazën Parakualifikuese

14 (katërbëdhjetë) shoqëritë i kanë dorëzuar aplikimet përpara skadimit të afatit të dorëzimit tek AKUM, ndërsa 5 (pesë) shoqëri ka dorëzuar aplikimet përtej afatit të vendosur në dokumentet e parakualifikimit dhe është s'kualifikuar. Afati për dorëzimin e aplikimeve, është përcaktuar se dorëzimi brenda afatit të përcaktuar të dorëzimit tek AKUM do të merret në konsideratë.

Në vijim vlerësimi i aplikimeve është kryer për të 14 (katërbëdhjetë) shoqëritë, si vijon:

25. Vlerësimi i përputhshmërisë administrative

Të gjithë aplikantët kanë plotësuar këtë kriter dhe kanë dorëzuar dokumentet e kërkuara në dokumentet e parakualifikimit si vijon:

- a) Deklaratën e Sipërmarrjes
- b) Deklaratën e kapacitetit financiar së bashku me bilancet financiare dhe deklaratën e të ardhurave për tre vitet e fundit, duke plotësuar kriterin minimal të kërkuar për xhiron mesatare të tre viteve të fundit me e pakta 2,000,000 euro
- c) Deklarata e konfliktit të interesit.
- d) Autorizim përfaqësimi.
- e) Marrëveshja e Bashkëpunimit të shoqërive.

Kompanite C. dhe H. G. nuk kanë dorëzuar asnjë formular si dhe nuk kanë dorëzuar pasqyra financiare, si rrjedhim janë s'kualifikuar.

Në përfundim, janë kualifikuar për të vijuar me vlerësimin teknik dhe financiar këto 21 shoqëri konsulente:

1. F. W. & T. G.
2. D. C. E.
3. G. C. G.
4. p be. G.
5. G. C. E. G.
6. K. C. G.
7. D. I. C.
8. G. G.&C. E. K
9. IW. G . K.
10. i. A.
11. I. C. Z. G.
12. 3. P.
13. C..
14. H. G.

Vlerësimi për Pikëzimin

Referuar dokumentit të parakualifikimit, Seksioni I - Parashikime të Përgjithshme, pika 3 Dorëzimi i aplikimeve, nënpika 4.2.4 Punëdhënësi do të refuzojë një aplikim nëse; (b) Aplikanti është vlerësuar me më pak se 70 pikë.

Referuar këtij kushti janë vlerësuar me mbi 70 pikë aplikimet si vijon:

- | | |
|------------------|------------|
| 1. F. W. & T. G. | 86.53 pikë |
| 2. D. C. E. | 84.87 pikë |
| 3. G. C. G. | 82.60 pikë |
| 4. p be. G. | 80.93 pikë |
| 5. G. C. E. G. | 79.18 pikë |
| 6. K. C. G. | 78.06 pikë |

Jane vlerësuar me më pak se 70 pike aplikimet si vijon:

- | | |
|------------------|------------|
| 1. D. I. C. | 66.71 pikë |
| 2. G. G.&C. E. K | 65.69 pikë |
| 3. IW. G . K. | 64.31 pikë |
| 4. i. A. | 55.68 pikë |
| 5. I. C. Z. G. | 48.26 pikë |
| 6. 3. P. | 41.08 pikë |

KfW ka aprovuar vlerësimin e parakualifikimit me shkresën datë 19.06.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit të Parakualifikimit”.

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit. Agjenti i Tenderit me email datë 01.11.2018 ka njoftuar të 5 (pesë) aplikantët e mesipërm të suksesshëm mbi rezultatet e vlerësimit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Agjenti i Tenderit me email date 08.11.2018 ka njoftuar aplikantet e pa- suksesshem mbi rezultatet e vlerësimit si dhe në bashkëpunim me PCU dhe KfW kanë përgatitur dokumentet e tenderit, të cilat KfW i ka aprovuar me shkresën datë 30.10.2018 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Dokumentet e Tenderit”.

Në vijim Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me PCU, me email datë 01.11.2018 i ka dërguar të 5 (pesë) aplikantëve të parakualifikuar Ftesën per Ofertë së bashku me setin e dokumenteve të tenderit, ku është përcaktuar edhe afati për dorëzimin e ofertave në datën 17.12.2018, duke

plotësuar kushtin për afat të dorëzimit prej minimalisht 45 ditë kalendarike, sipas udhëzuesve të prokurimit të KfW pika 2.4.10 Afatet e dorëzimit, (2) dorëzimi i ofertave, ku citohet se “afati minimal për përgatitjen e aplikimeve duhet të jetë 45 ditë kalendarike”.

Gjatë periudhës nga dërgimi i ftesës për ofertë dhe deri në dorëzim të ofertave nga aplikuesit e parakualifikuar është përgatitur kërkesa për sqarime dhe është dërguar tek të gjithë aplikantët Letra Qarkulluese nr.1, datë 04.12.2018 që përmban setin prej 7 (shtatë) pyetje dhe përgjigje. Referuar dokumenteve të tenderit, Seksioni II Të dhënat për ofertë, pika 13.1, afati përfundimtar për dorëzimin e pyetjeve ka qenë deri në 14 dite para afatit për dorëzimin e ofertave, ose data 04.12.2018. Letra Qarkulluese nr.1, datë 04.12.2018, është dërguar tek të gjithë të interesuarit para afatit për dorëzimin e ofertave. Gjatë periudhës së përgatitjes së ofertave nuk ka patur kërkesa të aplikanteve për shtyrje të afatit të dorëzimit të ofertave ndaj afati fillestar për dorëzimin e ofertave ka mbetur i njëjtë data 17.12.2018.

Faza e dytë e vlerësimit

Pas njoftimit të tenderit, agjenti i tenderit ka ftuar 5 shoqëritë e parakualifikuara, të cilat ishin vlerësuar me më shumë se 70 pikë, për të dorëzuar ofertat e tyre teknike dhe financiare, të ndara nga njëra-tjetra.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, konstatohet se komisioni i vlerësimit nuk ka evidentuar numrin e protokollit hyrës të AKUK për secilën nga ofertat e dorëzuara. Grupi i auditimit ka marrë informacion nga zyra e protokollit të AKUK dhe ka vendosur numrin përkatës të protokollit dhe datën e dorëzimit të ofertave, të cilat paraqiten si më poshtë:

1. F. W. & T. G. (nr. 3503 prot., datë 13.12.2018)
2. D. C. E. (nr. 3526 prot., datë 17.12.2018)
3. p. b. GmbH (nr. 3527 prot., datë 17.12.2018)
4. G. C. E. G. (nr. 3513 prot., datë 14.12.2018)

Nga auditimi konstatohet se:

Nuk është mbajtur një procesverbal ndërmjet zyrës së protokollit të AKUK dhe NJKP-së për marrjen në dorëzim të zarfave me ofertat teknike dhe financiare të këtyre shoqërive.

Vlerësim i ofertave teknike:

PCU dhe Agjenti i Tenderimit janë informuar zyrtarisht në 20.11.2018 nga G. se për shkak të ngarkesës dhe mungesës së kapaciteteve nuk do të dorëzonin ofertë për këtë fazë.

Ofertat janë dorëzuar brenda afatit vetëm nga 4 (kater) aplikantët e parakualifikuar.

PCU ka marrë vetëm 4 oferta në dorëzim përpara afatit të parashikuar të dorëzimit, datë 17.12.2018, ora 13:00: ofertat e konsulentëve Fichtner Water&Transportation GmbH, D. C. E., p. b. GmbH, G. C. E. G. .

Kriteret e Vlerësimit

Metoda e vlerësimit e aplikuar referuar udhëzuesve të prokurimit të KfW është “përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto (QCBS)”.

Gjatë fazës së vlerësimit të propozimeve teknike aplikantët duhet të vlerësohen me minimalisht 75 pikë për të vazhduar më tej me hapjen e ofertave financiare.

Vlerësimi Teknik

Vlerësimi bazohet në vlerësimin e secilit kriter sipas dokumenteve të tenderit. Detajet e vlerësimit për secilin aplikant jepen si vijon:

- C. C. E. S. G.

Koncepti dhe Metodologjia 33.50 pikë nga maksimumi 40.00 pikë.

Kualifikimet e Stafit të propozuar 48.92 pikë nga maksimumi 60.00 pikë.

- D. C. E.

Koncepti dhe Metodologjia 36.38 pike nga maksimumi 40.00 pikë.

Kualifikimet e Stafit të propozuar 54.44 pikë nga maksimumi 60.00 pikë.

- F. W. & T. G.

Koncepti dhe Metodologjia 30.98 pike nga maksimumi 40.00 pikë.

Kualifikimet e Stafit të propozuar 44.14 pike nga maksimumi 60.00 pikë.

- p. b. G.

Koncepti dhe Metodologjia 32.73 pike nga maksimumi 40.00 pike.

Kualifikimet e Stafit të propozuar 50.88 pike nga maksimumi 60.00 pikë.

Rezultatet e vlerësimit teknik

1. C. C. E. S. G. është vlerësuar me 82.42 pikë.
2. D. C. E. është vlerësuar me 90.81 pikë.
3. F. W. & T. G. është vlerësuar me 75.11 pikë.
4. p. b. G. është vlerësuar me 83.6 pikë.

KfW ka aprovuar vlerësimin e ofertave teknike me shkresën datë 18.02.2019 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Raportin e Vlerësimit Teknik”.

Vlerësimi i Propozimeve Financiare

Pas aprovimit të raportit të vlerësimit teknik, në datën 20.02.2019 nga PCU janë hapur ofertat financiare të aplikantëve që u vlerësuan me më shumë se 75 pikë gjatë vlerësimit të propozimeve teknike, nga ku rezulton si vijon:

- Oferta totale financiare e ofruar nga C. C. E. S. G. është 2,316,385.00 euro.
- Oferta totale financiare e ofruar nga D. C. E. është 1,859,686.52 euro.
- Oferta totale financiare e ofruar nga F. W. & T. G. është 2,599,416.00 euro.
- Oferta totale financiare e ofruar nga p. b. GmbH është 2,388,300.00 euro.

Vlerësimi i kombinuar teknik dhe financiar:

Formula për vlerësimin e kombinuar teknik dhe financiar, ku 80% i takon vlerësimit teknik dhe 20% vlerësimit financiar, është: $S=(T*0.7) + (F*0.3)$

Ku:

- S është rezultati përfundimtar i ofertuesit.
- T është rezultati i vlerësimit teknik (pikët e marra).
- F është rezultati i vlerësimit financiar (i konvertuar në pikë).

Vlerësimi financiar llogaritet sipas formulës:

$$F = \left(\frac{P_{min}}{P} \right) * 100$$

Ku:

- P_{min} është çmimi më i ulët i ofertuar.
- P është çmimi i ofertuesit që po vlerësohet.

Rezultatet e Vlerësimit të Kombinuar

Nga auditimi konstatohet se vlerësimi i kombinuar për operatorët ekonomikë është si më poshtë:

- Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “C. C. E. S. G.” është 87.62 pikë.

- Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “D. C. E.” është 100.00 pikë.
 - Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “F. W. & T. G.” është 79.36 pikë.
 - Vlerësimi i kombinuar për aplikantin “p. b. G.” është 87,80 pikë.
- Bazuar në këto rezultate është rekomanduar për fitues aplikanti i renditur i pari me pikë që është aplikanti “D. C. E.” me ofertë 1,859,686.52 euro.

Hartimi i Kontratës së Konsulentit

Në vijim Agjenti i Tenderit në bashkëpunim me PCU dhe KfW kanë përgatitur dokumentin e kontratës së shërbimeve të konsulencës, të cilën KfW e ka aprovuar me shkresën datë 04.04.2019 me objekt: “Nuk ka kundërshtime lidhur me Dokumentin e Kontratës”.

Pas aprovimit të raportit të Dokumentit të Kontratës, është lidhur kontrata e shërbimeve të konsulentit teknik me nr.1150 prot., datë 15.04.2019 ndërmjet Autoritetit Kontraktor Agjencia Kombëtare e Ujësajllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve AKUM dhe subjektit “D. C. E.”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 687/2 prot., datë 28.04.2025 (protokolluar në KLSH me nr.95/4 prot., datë 02.05.2025) ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

2.5 Mbi zbatimin e kontratave për punime civile, mallra dhe konsulencë.

Zbatimi i Kontratës - Konsulenti Institucional “S. G.”, “S. E. G.” & “M. E. & W. G.”

Për realizimin e këtij shërbimi është lidhur Kontrata e Konsulencës më 21.12.2022 (protokolluar në AKUK me nr. 99, datë 19.01.2023) midis Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “S. G.”, “S. E. G.” & “M. E. & W. G.” dhe K. J., Drejtor i Përgjithshëm i AKUK, me një vlerë totale prej 4,755,985 euro dhe një kohëzgjatje prej 60 muajsh.

Struktura e vlerës së kontratës

- 4,291,985 euro për shërbimet me bazë kohe.
- 464,000 euro për shpenzime të tjera të rimbursueshme.

Kushtet e pagesës

- Parapagim: 642,287 euro (rreth 15% e shumës së kontratës, pa përfshirë shpenzimet e rimbursueshme).
- Shërbimi: 3,220,500 euro (rreth 75% e shumës së kontratës, pa përfshirë shpenzimet e rimbursueshme).
- Pagesa finale: 429,198 euro (rreth 10% e shumës së kontratës).

Burimi i financimit

Sipas Marrëveshjes së Veçantë, datë 18.12.2020, lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtorëve të Ujësajllësave Berat-Kuçovë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Kamëz, Lezhë dhe Fier, burimi i financimit të kontratës është si më poshtë:

1.3,000,000 euro nga Granti i KfW, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 30, datë 20.01.2021.

○ Ky grant është miratuar për Programin e Infrastrukturës Bashkiake V.

○ Afati i përdorimit të grantit: 30.06.2026.

2.500,000 euro nga Granti i Bashkimit Evropian (EU), i miratuar me VKM nr. 29, datë 20.01.2021.

- Ky grant është dhënë për mbështetje në trajtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza.
 - Afati i përdorimit të grantit: 30.06.2025.
- 3.1,500,000 euro nga Granti i SECO, i miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2021.
- Ky grant është pjesë e Programit të Infrastrukturës Bashkiake V.
 - Afati i përdorimit të grantit: 30.11.2027.

Afati i kontratës

Bazuar në Nenin 1 të Kushteve të Veçanta të Kontratës, datë 21.12.2022 (protokolluar në AKUK me nr. 99, datë 19.01.2023), kohëzgjatja e kontratës është 60 muaj nga data e fillimit.

- Data e fillimit: 19.01.2023 (4 javë pas 21.12.2022).
- Data e përfundimit: 19.01.2028 (60 muaj pas datës së fillimit).

Problematika dhe rreziqet e kontratës

Nga analiza e mësipërme, rezulton se kontrata është e ekspozuar ndaj rrezikut të mos përmbushjes financiare, pasi të gjitha burimet e financimit të saj skadojnë më 30.11.2027, ndërkohë që kontrata zgjat deri më 19.01.2028.

Gjithashtu, kontrata është lidhur në kundërshtim me afatet e përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, datë 18.12.2020, Aneksi 2 “Grafik Kohor”, sipas të cilit i gjithë projekti duhej të përfundonte më 31.12.2027.

Pagesat e kryera për kontratën

Parapagimi

- Kërkesa për disbursim nr. 1, me nr. 1115 prot., datë 19.06.2023, me vlerë 642,287 euro, bazuar në faturën nr. 01/4000-2379C/01, datë 07.06.2023.
- Bashkëlidhur: Garancia e parapagimit.

Pagesat pjesore për shërbimin

1. Kërkesa nr. 2 – 169,500 euro, nr. 1480 prot., datë 11.08.2023.
 - Fatura nr. 02/4000-2379C/02, datë 19.07.2023.
2. Kërkesa nr. 3 – 169,500 euro, nr. 2080 prot., datë 10.11.2023.
 - Fatura nr. 36/4000-2379C/03, datë 07.11.2023.
3. Kërkesa nr. 4 – 169,500 euro, nr. 2268 prot., datë 31.07.2024.
 - Fatura nr. 01/2024, datë 26.07.2024.
4. Kërkesa nr. 5 – 169,500 euro, nr. 2269 prot., datë 31.07.2024.
 - Fatura nr. 02/2024, datë 26.07.2024.
5. Kërkesa nr. 6 – 169,500 euro, nr. 2270 prot., datë 31.07.2024.
 - Fatura nr. 03/2024, datë 26.07.2024.
6. Kërkesa nr. 7 – 216,163.49 euro, nr. 3117 prot., datë 21.10.2024.
 - Fatura nr. 04/2024, datë 30.09.2024.
 - Përfshirë 169,500 euro për shërbimin dhe 46,663.49 euro shpenzime të rimbursueshme.
7. Kërkesa nr. 8 – 260,018 euro, nr. 3691 prot., datë 13.12.2024.
 - Fatura nr. 05/2024, datë 13.12.2024.
 - Përfshirë 169,500 euro për shërbimin dhe 90,518 euro shpenzime të rimbursueshme.
 - Bashkëlidhur: Lista me shpenzimet e rimbursueshme.

Ndyshimet e kontrates se konsulentit institucional

Në kuadër të zbatimit të Termave të Referencës, PCU ka kërkuar dhe ka marrë miratimin nga donatori (KfW) për alokimin e fondeve shtesë në shumën 500 mijë euro për Kontratën e

Konsulentit Institucional. Si rezultat, është aprovuar Amendimi i kontratës nr. 1858 Prot., datë 28.06.2024, e cila në mënyrë të përmbledhur konsiston në:

- *Punësimin e stafit mbështetës për ofrimin e Shërbimeve të Konsulencës Institucionale për PCU*

- *Marrjen me qira të ambienteve të zyrave dhe mbulimin e kostove operative përkatëse*

- *Marrjen me qira të automjeteve të transportit dhe mbulimin e kostove operative përkatëse*

Shërbimet shtesë të këtij Amendamenti ndahen në dy faza (Faza A dhe Faza B), ku Faza B do të nisë vetëm pasi të jetë siguruar personeli i përshtatshëm dhe hapësirat e nevojshme të zyrave gjatë Fazës A. Periudha e përfundimit të shërbimeve shtesë (Faza A + Faza B) është përcaktuar në 45 muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të Amendamentit Nr. 1.

Faza A përfshin:

- Kërkimin, përzgjedhjen dhe identifikimin e stafit mbështetës për ofrimin e Shërbimeve të Konsulencës Institucionale për PCU,

- Marrjen me qira të ambienteve të zyrave,

- Marrjen me qira të automjeteve të transportit.

Referuar Amendamentit nr.1., shërbimet do të fillojnë me Fazën A, e cila përfshin vetëm kërkimin, përzgjedhjen dhe identifikimin e stafit, zyrave dhe automjeteve të përshtatshme, të cilat do të realizohen brenda periudhës prej 3 muajsh.

Faza B përfshin:

- Referuar Aneksit A, konsulenti nuk do të mbaje përgjegjësi për vonesat në fillimin e Fazës B të shërbimeve për shkak të pamundësisë për të identifikuar personelin e përshtatshëm, refuzimit të tyre për të pranuar normat e përcaktuara, ose pamundësisë për të siguruar ambiente zyrash me brenda kufijve të buxhetit të parashikuar. Në amendament realizimi i fazës B parashikohet një periudhë prej 42 muajsh.

- Gjatë Fazës B, shërbimet do të përfshijnë mbështetje institucionale për PCU-në përmes shtimit të ekspertëve lokalë, konkretisht:

- *Një Asistent Projekti, i cili do të mbështesë PCU-në në rishikimin e raporteve, komunikimin me palët e interesuara, përgatitjen e takimeve dhe menaxhimin e zyrës.*

- *Një Inxhinier – me përvojë në zbatimin e projekteve, i cili do të mbështesë PCU-në me shërbime të Menaxhimit të Projektit dhe Këshillimit Teknik.*

- *Një Ekspert për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, i cili do të mbështesë PCU-në me shërbime të menaxhimit të të dhënave, GIS dhe SCADA.*

Aneksi A: Përshkrimi dhe Përditësimi i Shërbimeve të Konsulencës Institucionale.

Sipas nenit 5.1 “Format e Shpërblimit”, parashikohet që shërbimet në Fazën A të ofrohen si shërbime të bazuara në kohë. Për këtë fazë, është përcaktuar një buxhet deri në një muaj pune për angazhimin e udhëheqësit të ekipit, me një shumë prej **16,100.00 euro**.

Ndërkohë, shërbimet në Fazën B do të ofrohen gjithashtu si shërbime të bazuara në kohë, duke iu referuar rregullave kryesore kontraktuale mbi tarifën mujore, siç përcaktohet në Tabelën e Përlllogaritjes së Kostove dhe Faturimit (Aneksi 8) të kontratës së datës 19 janar 2023, të cilat paraqiten në tabelën nr.1., Aneksi 4, të këtij Projekt Raport Auditimi:

Faturimi dhe Rimbursimi i Shpenzimeve

- Faturat tremujore duhet të shoqërohen me fletët e regjistrimit të orëve të punës.

- Kostot e tjera për artikujt e rimbursueshëm do të rimbursohen pas paraqitjes së listës së shpenzimeve, e cila duhet të përmbajë datën, përshkrimin, çmimin dhe kursin e këmbimit të

shpenzimit, dhe të firmoset nga Konsulenti, duke deklaruar se informacioni i dhënë është i saktë dhe i vërtetë.

- Lista e shpenzimeve, së bashku me dokumentacionin mbështetës për justifikimin e tyre, duhet të dorëzohet së bashku me faturat për pagesën tremujore. Dokumentacioni origjinal do t'i dërgohet AKUK.
- Shpenzimet mujore për funksionimin e zyrës dhe kostot e udhëtimit do të rimbursohen në baza tremujore, bazuar në paraqitjen e faturës përkatëse.
- Shërbimet e bazuara në kohë dhe kostot e tjera për artikujt e rimbursueshëm do të faturohen pavarësisht nga dorëzimi i raporteve mujore ose tremujore.

Pagesa për Shërbimet Shtesë (Amendamenti 01)

Për shërbimet shtesë që do të kryhen sipas kësaj Kontrate, AKUK do të paguajë shumën totale (pa TVSH) të pasqyruar në tabelën nr.2.

Tabela nr.2 Vlera totale e kontratës së konsulentit Institucional

Përshkrimi	Shuma në EURO
Vlera totale e Amendamentit 01	500,000.00
Pjesa e Vlerës Fillestare të Kontratës për Shërbimet e Bazuara në Kohë	4,291,985.00
Pjesa e Vlerës Fillestare të Kontratës për Kostot të tjera	464,000.00
Vlera Totale e Kontratës Fillestare	4,755,985.00
Pjesa e Vlerës së Kontratës për Shërbimet e Bazuara në Kohë (pas Amendamentit 01)	4,291,985.00
Pjesa e Vlerës së Kontratës për Kostot e tjera dhe Amendamentit 1	964,000.00
Vlera Totale e Kontratës (pas Amendamentit 01)	5,255,985.00

Burimi: Amendamenti nr.1, përpunimi nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi konstatohet se:

a. Sipas raportit të vlerësimit teknik, rezulton se në ekipin e ekspertëve shtesë janë propozuar 4 nga 6 ekspertë teknikë, përfshirë edhe ekspertin e IT-së, i cili ka përvojë në programim dhe SCADA.

b. Sipas ofertës financiare të shoqërisë konsulente fituese **BOE S.-S.-M.**, në tabelën e detajuar të kostos, në pikën 2 “Local Staff Cost”, është përfshirë edhe pozicioni “**National GIS Expert**” për një periudhë 3-mujore, me një pagë mujore prej **4,935 euro**, duke arritur vlerën totale prej **14,805 euro** (pa TVSH).

c. Në pikën 5.1 të ofertës financiare është parashikuar një automjet tip “D.D.” ose ekuivalent për nevoja transporti, me një kosto mujore prej **3,000 euro** për një periudhë **60 muaj**, duke arritur një vlerë totale prej **180,000 euro** (pa TVSH).

d. Në seksionin 6, pika 6.1 dhe 6.2, janë përcaktuar shpenzimet për qiranë e zyrës për një periudhë 60-mujore, me një kosto mujore prej 2,200 euro, duke arritur një total prej 132,000 euro (pa TVSH). Po ashtu, për stafin mbështetës të zyrës është parashikuar një pagesë mujore prej 3,600 euro për 60 muaj, me një shumë totale prej 216,000 euro (pa TVSH).

Siç paraqitet në faksimilen nr. 1, Aneksi nr. 4, këto të dhëna detajojnë kostot e përfshira, duke përfshirë shpenzimet për ekspertët lokalë, mjetet e transportit dhe qiranë e zyrës.

e. Vlera e planifikuar në amendamentin nr. 1 për zërat e përfshirë në tabelën nr. 3, Aneksi nr. 1, në shumën **392,988 euro** (pa TVSH), nga totali i planifikuar prej **500,000 euro** (pa TVSH) në amendamentin nr. 1 të kontratës së konsulentit institucional, përbën përsëritje të zërave të përcaktuar në kontratën bazë nr. 99 Prot., datë 19.01.2023.

Me veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi z. K. J., në cilësinë e titullarit të AKUK dhe nënshkruesit të Amendimit të Kontratës së Konsulentit Institucional, z. J.GJ, z. A.B. dhe z. A.M., në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit..

Për sa më lart është trajtuar, në mënyrë të përmbledhur konstatohet se:

a. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të procedurës së përzgjedhjes së konsulentit institucional nuk kanë dokumentuar marrjen e zarfave të ofertave me anë të një procesverbali nga zyra e protokollit të AKUK, veprim që ka krijuar mungesë transparence në administrimin e dokumenteve të ofertuesve.

b. Aplikimet e dorëzuara për fazën e parakualifikimit janë hapur më 16.03.2021, ora 10:00, nga dy anëtarë dhe jo nga tre anëtarë, siç është përcaktuar në urdhrin nr. 545, datë 02.03.2021, të titullarit të AKUM.

c. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të procedurës për përzgjedhjen e konsulentit institucional kanë kryer vlerësimin teknik të ofertave 8 (tetë) muaj pas dorëzimit të tyre, periudhë kjo e tejzgjatur në vend të një periudhe të arsyeshme dy mujore. Kjo vonesë ka ndikuar në shtyrjen e përzgjedhjes së konsulentit përtej afateve të përcaktuara në marrëveshjen fillestare dhe, si pasojë, në shtyrjen e afateve kohore të zbatimit të projektit.

d. Në kontratën shtesë të konsulentit institucional janë përfshirë kosto shtesë të pajustificuara për realizimin e projektit. Në mënyrë të veçantë, vlera e planifikuar prej 392,988 euro (pa TVSH) nga totali i amendamentit të kontratës prej 500,000 euro (pa TVSH), në të cilën janë përfshirë zëra që janë ofertuar dhe pranuar nga komisioni i vlerësimit në ofertën financiare të konsulentit të shpallur fitues mbi bazën e kërkesave të Termave të References dhe të materializuar në kontratën bazë nr. 99 Prot., datë 19.01.2023.

Me veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi z. K. J., në cilësinë e titullarit të AKUK dhe nënshkruesit të amendamentit të kontratës së Konsulentit Institucional, z. J.GJ, Drejtues i PIU.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 687/2 prot., datë 28.04.2025 (protokolluar në KLSH me nr.95/4 prot., datë 02.05.2025) ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i Subjektit.

Në Marrëveshjen e Veçantë datë 18.12.2020, aneksi 3 Kostot dhe financimi, është parashikuar si zë i veçantë kosto zëri “Support AKUK/Mbështetje AKUK”, në vlerën prej 500,000 euro. Ky zë është parashikuar i veçantë nga zëri “Institutional Consultant/Konsulentit Institucional” dhe nuk ka qënë i përfshirë në tenderin e konsulentit institucional dhe rrjedhimisht nuk është pjesë e shërbimeve të kontratës bazë nr.99 prot, datë 19.01.2023 të Konsulentit Institucional. Në ndryshimin e dytë të Marrëveshjes së Veçantë date 01.11.2023 tek pika 1.1 “Detajet e projektit”, është përfshirë teksti si vijon:

Mbështetje për AKUK

Me qëllim për të mbështetur AKUK si NJKP në program, një buxhet ekstra është i gatshëm për të forcuar kapacitetet e AKUK në menaxhimin dhe monitorimin e projekteve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Ky buxhet është planifikuar të jetë pjesë e buxhetit të shpenzimeve të rimbursueshme të Konsulentit Institucional dhe financohet nga fondet e SECO. Pranimi i zërave do të jetë subjekt i aprovimit të AKUK dhe KFW.

Referuar sa me sipër, shërbimet e parashikuara për mbështetje për AKUK të kontraktuara nepermjet Amendimit nr.1 të kontratës së konsulentit institucional, nuk përbejnë në asnjë rast perseritje të zërave të përcaktuar në kontratën bazë nr.99 prot, datë 19.01.2023.

Lidhur me gjetjet në pikën a) më sipër, sqarojmë se referuar aneksit 7 “Personnel schedule” të kontratës bazë për pozicionin “Ekspert IT” janë parashikuar inpute për vetëm 10 muaj punë në 60 muaj kohë totale të kontratës, të shpërndara nga 2 muaj çdo vit për 5 vite punë në total të

kontratës (60 muaj). Këto inpute janë të dedikuara për shërbime për shoqëritë UK të përfshirë në program dhe nuk përfshijnë mbështetje për AKUK, pasi AKUK nuk menaxhon asnjë sistem scada pasi scada është sistem nëpërmjet të cilit menaxhohet operimi në distancë i rrjeteve të ujësjellës kanalizimeve në shoqëritë UK. Gjithashtu eksperti IT nuk ka formim inxhinierik për te kryer te njejen pune qe kryhen Eksperti per Sistemin e Menaxhimit te Informacionit i kontraktuar per 19.5 muaj pune me Amendimin 1 te kontrates se konsulentit institucional. Eksperti për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit është Inxhinier dhe jo IT , sepse puna që bën për përditësimin e GIS Kombëtar të sektorit ujësjellës kanalizime të jetë e kërkon të jetë Inxhinier dhe këtë fakt mund ta vërtetoni nëpërmjet kontratës së punës që ju kemi vënë në dispozicion. Bashkangjitur observacioneve të akt-konstatimeve ju kemi dërguar Aneksin 7 Personnel schedule të kontratës bazë për te verifikuar sqarimin me siper.

Lidhur me konstatimin në pikën (b) më sipër, sqarojmë se referuar aneksit 7 “Personnel schedule” të kontratës baze për këtë pozicion janë parashikuar inpute për vetëm 3 muaj punë sipas kërkesës në 60 muaj kohë totale të kontratës. Këto inpute janë të dedikuara për shoqëritë UK të përfshirë në program dhe nuk përfshijnë mbështetje për AKUK. Kjo është arsyeja që mbështetja për AKUK për GIS është përfshirë tek komponenti i veçantë i dedikuar për AKUK në kuadër të komponentit Support AKUK/Mbështetje AKUK sipas Marrëveshjes së Veçantë datë 18.12.2020, aneksi 3 Kostot dhe financimi, zëri Support AKUK/Mbështetje AKUK, i kontraktuar nepermjet Amendimit 1 te kontrates se konsulentit institucional. Bashkangjitur observacioneve të akt-konstatimeve ju kemi dërguar Aneksin 7 Personnel schedule të kontratës bazë për te verifikuar sqarimin me siper.

Lidhur me konstatimin në pikën (c) më sipër se në kontratën bazë të konsulentit institucional është përfshirë *“transport me automjet tip D.D. ose ekuivalent, me pagesë mujore 3,000 euro dhe pagesë totale 180,000 euro”*, sqarojmë se referuar ky zë është ofertuar në tender nga subjekti si pjesë e ofertës financiare, e cila në total ka qënë më e ulëta nga të tre ofertuesit dhe me diferencë prej 484,774.5 euro nga oferta e renditur e dyta. Në aneksin 8 të kontratës bazë FIN 2 – Financial proposal, në zërin 5 Local travel and transport costs, nën zërin 5.1 përshkruhet *“Lease or rent of vehicles (D.D. or equiv.)”*. Pra në këtë zë parashikohet marrja me qera e disa makinave dhe jo e vetëm nje makine, ndaj nëse në gjetjet nënkuptoni se cmimi prej 3000 euro/muaj është për një makinë atëherë ky është keqkuptim pasi ky cmim në muaj është për disa makina. Gjithashtu ju sqarojmë se gjatë zbatimit të shërbimeve konsulenti ka marrë me qera tre makina të tipeve, dy prej tyre K. dhe njëra C..

Lidhur me konstatimin në pikën (d) më sipër, sqarojmë se ky zë është ofertuar në tender nga subjekti si pjesë e ofertës financiare, e cila në total ka qënë më e ulëta nga të tre ofertuesit dhe me diferencë prej 484,774.5 euro nga oferta e renditur e dyta. Përcaktimi i këtij cmimi nga konsulenti lidhet me hapësirën që ka përcaktuar kur ka përgatitur ofertën si dhe me stafin mbështetës që do angazhojë përtej ekspertëve.

Lidhur me konstatimin në pikën (e) më sipër, sqarojmë se ashtu si dhe kemi cituar më sipër, komponenti “Support AKUK/Mbështetje AKUK” është parashikuar si zë i veçantë kosto në Marrëveshjen e Veçantë datë 18.12.2020, aneksi 3 Kostot dhe financimi, në vlerën prej 500,000 euro. Ky zë është parashikuar i veçantë nga zëri “Institutional Consultant/Konsulenti Institucional” dhe shërbimet e parashikuara për mbështetje për AKUK nuk kanë në asnjë rast perseritje të zërave të përcaktuar në shërbimet e konsulentit institucional në kuadër të kontratës bazë nr.99 prot, datë 19.01.2023.

Shërbimet e parashikuara në Amendimin 1, rezultojnë shumë efektive pasi mbështetet Njësia e Kordinimit të Projektit nëpërmjet periudhës 42 mujore, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve në terren nëpërmjet angazhimit të Inxhinierit me përvojë në zbatim, mbështet AKUK nëpërmjet Ekspertit për sistemin e menaxhimit të informacionit gjatë gjithë periudhës 19.5 mujore, për përditësimin e sistemit kombëtar GIS të sektorit ujësjellës kanalizimeve ku në layer/shtresa të veçantë informacioni integrohet çdo investim që kryhet në sistemet e ujësjellës

kanalizimeve. Kjo është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në republikën e Shqipërisë”, ku në nenin 3, pika 7 përkufizohet “GIS Kombëtar” dhe në nenin 11 Temat e të dhënave gjeohapësinore, pika nj) përfshihet infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare.

Shpenzimet për marrjen me qira të automjetit i shërbejnë vetëm transportit të Inxhinierit gjatë lëvizjeve në gjashtë kantieret e punimeve të qyteteve të përfshirë në program.

Shpenzimet për marrjen me qera të zyrës i shërbejnë akomodimit të stafit mbështetës prej tre personash në kuadër të punës që kryejnë në kuadër të programit.

Shpenzimet për zyrën dhe infrastrukturën IT i shërbejnë operimit të zyrës dhe punës kompjuterike të stafit mbështetës.

Këto shërbime në kuadër të Amendimit 1 janë totalisht të pavarura dhe të diferencuara nga inputet e përfshira në kuadër të kontratës bazë të konsulentit institucional dhe janë të dedikuara vetëm për mbështetje për Njësinë e Koordinimit të Programit/AKUK.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Observacioni është kryesisht deklarativ dhe nuk është mbështetur me dokumente shtesë të panjohura më parë nga grupi i auditimit të KLSH-së. Prandaj, observacioni për këtë pikë nuk pranohet.

Në lidhje me përsëritjen e zërave të përcaktuar në kontratën bazë nr. 99 prot., datë 19.01.2023, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument shtesë të panjohur më parë nga grupi i auditimit të KLSH-së. Prandaj, observacioni për këtë pikë nuk merret në konsideratë.

Zbatimi i kontratës së Supervizimit “S. E. G. & Co. KG & D.”

Faza 1 - Fizibiliteti

- Konsulenti teknik – qytetet Vlorë, Fier, Sarandë

Për realizimin e këtij shërbimi është lidhur Kontrata e Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1164, datë 15.04.2019) midis “S. E. G.” dhe A.B, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK, me vlerë 1,189,950 euro për fazën A/B.

Parapagimi:

Kërkesa për disbursim nr. 1 me nr. 1363 prot., datë 07.05.2019 me vlerë 150,000 euro, bazuar në faturën nr.01/4000-2128C/01 datë 02.05.2019 me vlerë 150,000 euro.

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 2960 prot., datë 03.10.2019 me vlerë 389,600 euro, bazuar në faturën nr.02/4000-2128C/02 datë 01.10.2019 me vlerë 389,600 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 701 prot., datë 03.03.2020 me vlerë 377,720 euro, bazuar në faturën nr.03/4000-2128C/03 datë 02.03.2020 me vlerë 377,720 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 2183 prot., datë 24.08.2020 me vlerë 161,880 euro dhe 29,003 euro shpenzime të rimbursueshme, bazuar në faturën nr.05/4000-2128C/05 me vlerë 161,880 euro dhe fatura nr. 04/4000-2128/04 me vlerë 29,003 euro. Bashkëlidhur situacioni i shpenzimeve të rimbursueshme.

Adendum nr.1, nr.2311, datë 11.09.2020 me qëllim studime shtesë për Fizibilitetin e qytetit Fier me vlerë 94,352 euro

- Kërkesa për disbursim nr.5, me nr. 2521 prot., datë 05.10.2020 me vlerë 18,818.75 euro, bazuar në faturën nr.06/4000-2128C/06 datë 01.10.2020 me vlerë 18,818.75 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.6, me nr. 1262 prot., datë 11.06.2021 me vlerë 37,637.5 euro, bazuar në faturën nr.07/4000-2128C/07 datë 06.04.2021 me vlerë 37,637.50 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.7, me nr. 2618 prot., datë 17.12.2021 me vlerë 18,818.75 euro dhe 12,596.44 euro shpenzime të rimbursueshme, bazuar në faturën nr.09/4000-2128C/09 me vlerë 18,818.75 euro dhe fatura nr. 08/4000-2128/08 me vlerë 12,596.44 euro. Bashkëlidhur situacioni i shpenzimeve të rimbursueshme.

Shuma e disbursuar për Fazën 1, me vlerë 1,046,074.44 euro

Konsulenti teknik – qytetet Berat - Kuçovë

Bazuar në një kontratë ekzistente të Projektit “Infrastruktura Bashkiake nr. 3” Konsulenti “p. b.” është bërë **Adendum nr.3, nr. 2954 prot., datë 17.10.2018**, midis z. A. S. Drejtor i Përgjithshëm i AKUK dhe Mr. Hubertus Soppert Drejtues i “p. b.”, në vlerë 249,997.5 euro

Parapagimi:

Kërkesa për disbursim nr. 1 me nr. 2041 prot., datë 25.10.2018 me vlerë 35,324.6 euro, bazuar në faturën nr.MIP III Adv. Pay. Adendum 4 datë 18.10.2018 me vlerë 35,324.6 euro.

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 2401 prot., datë 20.08.2019 me vlerë 35,324.8 euro, bazuar në faturën nr. 451144.6112-IPC1 datë 14.08.2019 me vlerë 35,324.6 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 2400 prot., datë 20.08.2019 me vlerë 47,009.5 euro, bazuar në faturën nr.45144.6112-IPC2 datë 14.08.2019 me vlerë 47,099.5 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 2594 prot., datë 09.09.2019 me vlerë 82,424.2 euro bazuar në faturën nr.45144.6112-IPC3 me vlerë 82,424.2

- Kërkesa për disbursim nr.5, me nr. 3329 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 35,324.6 euro dhe 12,103.79 euro shpenzime të rimbursueshme, bazuar në faturën nr.45144.6112 me vlerë 35,324.6 euro dhe 12,103.79 euro. Bashkëlidhur situacioni i shpenzimeve të rimbursueshme. Adendum nr.4, nr. 1731 prot., datë 10.07.2020, midis z. A.B, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK dhe Mr. H. S. Drejtues i p. b., në vlerë 28,242.5 euro

- Kërkesa për disbursim nr.6, me nr. 3328 prot., datë 24.12.2020 me vlerë 22,242.5 euro dhe 8,000 euro shpenzime të rimbursueshme, bazuar në faturën nr.45144.6112 me vlerë 22,242.5 euro dhe 8,000 euro. Bashkëlidhur situacioni i shpenzimeve të rimbursueshme.

Shuma e disbursuar për Fazën 1, me vlerë 277,843.99 euro.

Koment i dhënë nga CPU

“Konsulenti p. b. ishte konsulent teknik në Berat në kuadër të Infrastruktura Bashkiake III & IV për Fazat A,B,C,D,E referuar kontratës 06.06.2016. Infrastruktura Bashkiake III & IV ka mbaruar në Berat në vitin 2022.

Në kuadër të Infrastruktura Bashkiake V është bërë addendum 4 datë 17.10.2018 për fazën A,B pra fizibilitetin. Këto shërbime u kontraktuan me këtë konsulent pasi punonte në berat dhe ishte i njohur me situatën. Faza C,D,E nuk ju kontraktua këtij subjekti.

Gjithashtu çmimet e stafit janë të lira pasi kontrata bazë e p. b. ka kaluar në proces tenderi ndërkombëtar dhe është me çmime të favorshme që prej 06.06.2016.

Gjatë kryerjes së shërbimeve konsulenti ka shfaqur probleme me performancën ku janë dërguar dhe komentuar nga KfW dhe PCU disa versione të studimit të fizibilitetit dhe përfundimisht versioni final u dërgua nga konsulenti në tetor 2020 dhe u miratua në nëntor 2020.

S. u kontraktua për fazat C,D,E për Infrastruktura Bashkiake V për Berat nëpërmjet Adendum 2 datë 04.03.2021 të kontratës 20.03.2019.

Arsyet kryesore ishin:

- *S. është i familjarizuar me beratin pasi ka qenë konsulent për fazat A,B,C,D,E në kuadër të Infrastruktura Bashkiake II*
- *Eksperienca shumë e mirë me këtë konsulent gjatë të gjitha fazave të projektit të mëparshëm*

- *Vlera totale e shërbimeve për fazat C,D,E është vetëm 811,675 euro, shumë e lirë për shërbime të krahasueshme për këto faza*
- *Gjithashtu çmimet e stafit janë të lira pasi kontrata bazë e S. ka kaluar në proces tenderi ndërkombëtar dhe është me çmime të favorshme që prej 20.03.2019.*
- *Shërbimet në kuadër të Adendum 2 janë organizuar të tilla ku stafi për të gjitha qytetet Fier, Vlorë, Berat, Lezhë, Shkodër udhëhiqet vetëm nga 1 Team Leader për të gjitha fazat C,D,E, të mbështetur me staff ekspert ndërkombëtar me input të reduktuar për çdo qytet (Annex A, pika 3.1) dhe input total 24 man months (kohë e plotë gjatë 24 muaj zbatim punimesh). Në supervizion faza D për çdo qytet ka nga 2 Inxhinierë Lokalë me kohë të plotë. Ky kompozim i stafit në rast kur ka më shumë se 1 qytet krijon sinergji duke ulur kostot financiare.*
- *Nëse qytetet Berat, Lezhë, Shkodër do të ishin kontraktuar veçmas me konsulentë të ndryshëm kostot do të ishin deri në tre-fish me të larta pasi minimalisht për fazën D supervizion do të ishin 3 Team Leader me kohë të plotë pra $24 \times 3 = 62$ man month, pra trefish kosto financiare”*

-Nga auditimi rezulton se për realizimin e Fazës 1 - Fizibiliteti i Berat Kuçovë është kontraktuar kompania “p. b.”, nëpërmjet një adendumi (shtese për kontratën ekzistuese). Shtesa e kontratës e lidhur me “p. b.” është jo sipas Planit të Prokurimit në pikën 2.3 të Marrëveshjes së Veçantë, Aneksi 6, i Marrëveshjes së Veçantë, jo në përputhje me Parimet bazë të Guidelines for Procurement of Consulting Service, Works, Plant, Goods and Non - Consulting Service in Financial Cooperation with Partner Countries.

Edhe pse nga CPU pretendohet se Konsulenti “p. b.” nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale si në cilësi edhe në kohë, nga auditimi konstatohet se nuk ka asnjë masë të marrë nga CPU në lidhje me aplikimin e penaliteteve sipas pikës 4.2 “Penalite të vonesa” të Kontratës së Konsulencës datë 06.06.2016. Nuk ka kërkuar mbajtjen e Garancisë konform nenit 7 “Garancia”, të kushteve të veçanta.

-Pas përfundimit të kësaj fazë AKUK ka vendosur mos të vijojë në Fazën e 2 me “p. b.” dhe nëpërmjet një adendumi (shtesë kontrate). Shtesa e kontratës e lidhur me S. është jo sipas Planit të Prokurimit në pikën 2.3 të Marrëveshjes së Veçantë, Aneksi 6 i Marrëveshjes së Veçantë, jo në përputhje me Parimet bazë të Guidelines for Procurement of Consulting Service, Works, Plant, Goods and Non - Consulting Service in Financial Cooperation with Partner Countries.

- **Konsulenti teknik – qytetet Shkodër/Lezhë**

Faza 1

Për realizimin e këtij shërbimi është lidhur Kontrata e Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1117, datë 09.04.2019) midis S. S. P. dhe A.B, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK, me vlerë 645,612.5 euro për fazën A/B.

Parapagimi:

Kërkesa për disbursim nr. 1 me nr. 1303 prot., datë 02.05.2019 me vlerë 92,276.86 euro, bazuar në faturën nr.A2019-11 datë 18.04.2019 me vlerë 92,276.88 euro.

Kërkesa për disbursim nr. 2 me nr. 1551 prot., datë 24.05.2019 me vlerë 2,000 euro, bazuar në faturën nr.A2019-11 datë 15.05.2019 me vlerë 2,000 euro.

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 3821 prot., datë 20.12.2019 me vlerë 219,979.38 euro, bazuar në faturën nr.A2019-19 datë 16.09.2019 me vlerë 219,979.38 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 634 prot., datë 25.02.2020 me vlerë 219,979.38 euro, bazuar në faturën nr.001SN64474810 datë 24.02.2020 me vlerë 219,979.38 euro.
- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 542 prot., datë 02.03.2020 me vlerë 94,276.88 euro dhe 7,975.26 euro shpenzime të rimbursueshme, bazuar në faturën nr.A2021_001 me vlerë 94,276.88 euro dhe fatura nr. A2021_002 me vlerë 7,975.26 euro. Bashkëlidhur situacioni i shpenzimeve të rimbursueshme.

Shuma e disbursuar për Fazën 1, me vlerë 636,487.76 euro

Koment i dhënë nga CPU

“Faza e projekt idesë - conceptual design

Lezhë Komponenti A 1 - Kanalizimet e ujërave të ndotura: Lidhur Projekt Idenë (Conceptual design) dhe Studimin e Fizibilitetit, nga punëdhësi dhe KfW janë dërguar listat me komente të cilat konsulenti ka patur shumë vështirësi për ti sqaruar dhe reflektuar.

Me qëllim sqarimin e çdo paqartësie është zhvilluar edhe një takim me konsulentin në zyrat e KfW Frankfurt por përsëri ka patur problematika në sqarimin e çdo aspekti.

Ndodhur në këtë situatë Projekt Idea është aprovuar nga KfW me kushtëzime.

Lezhë Komponenti A 2 - Kanalizimet e ujërave të shiut: Koncepti i propozuar nga konsulenti ka qenë me problematika thelbësore pasi nuk trajton çdo pjesë të qytetit Lezhë sipas zonave të kullimit të ujërave refruar topografisë, pra zonat e larta, zona e ulët, etj. Për më tepër propozimi për të mbledhur të gjithë ujërat e shiut të zonës së lartë të qytetit, zonës së sheshtë në veri, zonës së qendrës, dhe për ti grambuluar me tuba dhe sjellë në zonën e qendrës buzë lumit Drin tek një stacion qendror pompimi është me problme pasi do të mbidimensiononte çdo tubacion, do të mbidimensiononte stacionin e pompimit, do të rriste kostot e ndërtimit. Stacioni i pompimit i propozuar do të pomonte 5 - 7 m³/sekondë ose 5000 - 7000 litra ujë në sekondë, pra një prurje sa një lumë i vërtetë! Pra koncepti që konsulenti propozonte ku e gjithë sasia e ujit do të pompohet me stacion pompimi nuk ishte fizibël. Bashkangjitur lista e komenteve që tregon problematikat.

Ndodhur në këtë situatë Projekt Idea është aprovuar nga KfW me kushtëzime si në dokumentet bashkangjitur duke shprehur qartë se problemet duhen zgjidhur në fazën e projektimit të detajuar teknik.

Në vijim gjatë fazës së projektimit me konsulentin tjetër S., koncepti ndryshoi dhe stacioni i pompimit është lehtësuar me prurje maksimale 2000 m³/sekondë dhe pjesa veriore e qytetit si dhe zona e kalasë shkarkojnë ujrën me gravitet pa pompim direkt në lumin drin.

Të gjitha problematikat dhe vonesat nga konsulenti, bënë që Projekt Idea të miratohet vetëm në 12.2019 pra me vonesë të konsiderueshme prej rreth 2 muaj nga çfarë kërkohej në kontratë. Kontrata filloi në 09.04.2019 dhe Projekt idea draft duhej të dorëzohej pas 4.5 muaj pra në 08.2019 dhe versioni final duhej pas 6 muaj pra në 10.2019.

Shkodër Komponenti A 1 - Kanalizimet e ujërave të ndotura: Lidhur Projekt Idenë (Conceptual design) dhe Studimin e Fizibilitetit, nga punëdhënësi dhe kfw janë dërguar listë me komente të cilat konsulenti ka patur shumë vështirësi për ti sqaruar dhe reflektuar.

Bashkangjitur po ju dërgoj listën e komenteve, ku shfaqen problematika thelbësore. Referuar kesaj suate me email 23.12.2019 i eshte komunikuar konsulentit Sh. qe nuk mund te kete aprovim per Projekt Idene.

Faza e studimit te fizibilitetit

Lezhë Komponenti A 1 - Kanalizimet e ujerave te ndotura: Lidhur me Studimin e Fizibilitetit, nga punëdhënësi dhe kfw janë dërguar lista me komente të cilat konsulenti ka patur shumë vështirësi për ti sqaruar dhe reflektuar. Kjo jo vetëm ka shkaktuar shumë kohë në diskutime dhe angazhim përtej parashikimeve në kontratë nga punëdhënësi dhe KfW por ka harxhuar edhe shumë kohë dhe vonesë për përmbyllje nga konsulenti.

Bashkangjitur po ju dërgoj email dhe listat e komenteve të njëpasnjëshme dërguar konsulentit ku kuptohen problematikat e hasura.

Lezhë Komponenti A 2 - Kanalizimet e ujërave të shiut: Pavarësisht përpjekjeve të punëdhënësit dhe kfw në fazën e projekt idesë dhe aprovimit me kusht që problemet të merrnin zgjidhje në fazën e fizibilitetit, konsulenti përsëri ka shfaqur probleme në përgatitjen e fizibilitetit. Nisur nga këto probleme fizibiliteti është dërguar 3 herë, versioni rishikuar 07.2020, version rishikuar 10.2020, version final 11.2020.

Bashkangjitur po ju dërgoj email dhe listat e komenteve të njëpasnjëshme dërguar konsulentit ku kuptohen problematikat e hasura.

Shkodër Komponenti A 1 - Kanalizimet e ujërave te ndotura: Pavarësisht përpjekjeve të punëdhënësit dhe kfw në fazën e projekt idesë dhe aprovimit me kusht që problemet të merrnin zgjidhje në fazën e fizibilitetit, konsulenti përsëri ka shfaqur probleme në përgatitjen e fizibilitetit.

Bashkangjitur po ju dërgoj email dhe listat e komenteve të njëpasnjëshme dërguar konsulentit ku kuptohen problematikat e hasura.

Bashkangjitur po ju dërgoj edhe email datë 09.10.2020 ku KfW citon:

Megjithatë dilema mbetet nëse ky konsulent (S.) është i duhuri për të vazhduar me fazën e zbatimit duke konsideruar ndërtimin e ITUN, veçanërisht duke e krahasuar me shërbimet e konsulencës dhe zgjidhjet e elaboruara për ITUN në qytetet e tjera të programit të dhëna nga konsulentët e tjerë.

Referuar gjithë problematikave të hasura punëdhënësi dhe KfW kanë vendosur që mos vazhdojnë shërbimet opsionale për fazat C,D,E me konsulentin “S. ”për arsye të performancës se dobët.”

-Pas përfundimit të kësaj fazë AKUK ka vendosur mos të vijojë në Fazën e 2 me kompaninë “S. S. P.” dhe nëpërmjet një adendumi (shtesë kontrate). Shtesa e kontratës e lidhur me S. është jo sipas Planit të Prokurimit në pikën 2.3 të Marrëveshjes së Veçantë, Aneksi 6 i Marrëveshjes së Veçantë, jo në përputhje me Parimet bazë të Guidelines for Procurement of Consulting Service, Works, Plant, Goods and Non - Consulting Service in Financial Cooperation with Partner Countries.

Edhe pse nga CPU pretendohet se Konsulenti “S. S. P.” nuk ka përmbushur detyrimet e kontratës si në cilësi edhe në kohë, nga auditimi konstatohet se nuk ka asnjë masë të marrë nga CPU në lidhje me aplikimin e penaliteteve sipas pikës 4.2 “Penalite për vonesa” të Kontratës së Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1117, datë 09.04.2019) midis S. S. P. dhe A.B, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK. Nuk ka kërkuar mbajtjen e Garancisw konform nenit 7 “Garancia”, të kushteve të veçanta.

Faza 2 – Design, Tender, supervizion

Adendum nr. 2 (nr. 267 prot., datë 04.03.2021) i kontratës me “S. E. ” firmosur nga Z. A.B, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK dhe L. Sh., Përfaqësues i “S.” i shton shërbimin e konsulences për Beratin, Lezhë dhe Shkodër.

Totali i Adendumit 3,708.250 euro, shpenzime të rimbursueshme 83,125 euro.

Komponenti C - Projektim dhe tenderim

Komponenti D - Supervizim

Fieri

Komponenti C

Shërbimi - 282,750 euro

Kosto e rimbursueshme - 16,300 euro

Komponenti D

Shërbimi - 417,400 euro

Kosto e rimbursueshme - 2,000 euro

Totali Fier shërbimi 700,150 euro dhe 18,300 euro shërbime të rimbursueshme

Vlora

Komponenti C

Shërbimi - 335,500 euro

Kosto e rimbursueshme - 15,175 euro

Komponenti D

Shërbimi - 477,150 euro

Kosto e rimbursueshme - 2,000 euro

Totali Vlora shërbimi 812,650 euro dhe 17,175 euro shërbime të rimbursueshme

Berat - Kuçovë

Komponenti C

Shërbimi - 307,500 euro

Kosto e rimbursueshme - 16,425 euro

Komponenti D

Shërbimi - 458,475 euro

Kosto e rimbursueshme - 2,000 euro

Totali Berat - Kuçovë shërbimi 765,975 euro dhe 18,425 euro shërbime të rimbursueshme

Lezha

Komponenti C

Shërbimi - 377.375 euro

Kosto e rimbursueshme - 10.050 euro

Komponenti D

Shërbimi - 449,625 euro

Kosto e rimbursueshme - 2,000 euro

Totali Lezha shërbimi 827,000 euro dhe 12,050 euro shërbime të rimbursueshme

Shkodër

Komponenti C

Shërbimi - 227,875 euro

Kosto e rimbursueshme - 15,175 euro

Komponenti D

Shërbimi - 374,600 euro

Kosto e rimbursueshme - 2,000 euro

Totali Shkodër shërbimi 602,475 euro dhe 17,175 euro shërbime të rimbursueshme

Adendum nr. 3 (nr. 970 prot., datë 24.05.2023) i kontratës me “S. E. ” firmosur nga Z. K. J., Drejtor i Përgjithshëm i AKUK dhe Z. W. T., Përfaqësues i S..

-Ky Adendum ka rritur vlerën e kontratës në shumën 833,960 euro. Nga 3,708.250 euro në 4,400,360 euro (+ 692,110 euro) dhe shpenzime të rimbursueshme 83,125 euro në 224,975 euro (+141,850 euro).

Faza C

Parapagimi Fier, Vlora, Berat - Kuçva:

Kërkesa për disbursim nr. 2 me nr. 1894 prot., datë 04.10.2021 me vlerë 89.025 euro, bazuar në faturën nr.01/4000-2259C-01 datë 18.04.2019 me vlerë 89.025 euro.

Përkatësisht: Fier 28,275 euro, Vlora 30,000 euro, Berat - Kuçovë 30,750 euro.

Parapagimi Lezha, Shkodër:

Kërkesa për disbursim nr. 1 me nr. 2614 prot., datë 17.12.2021 me vlerë 37,737.5 euro, bazuar në faturën nr. 02/4000-2259C-02 datë 24.11.2021 me vlerë 37,737.5 euro (Lezhë).

Kërkesa për disbursim nr. 3 me nr. 2615 prot., datë 17.12.2021 me vlerë 22,787.5 euro, bazuar në faturën nr. 02/4000-2259C-02 datë 24.11.2021 me vlerë 22,787.5 euro (Shkodër).

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 460 prot., datë 10.03.2022 me vlerë 56,550 euro, bazuar në faturën nr.03/4000-2259C/03-FI datë 18.01.2022 me vlerë 56,550 euro. (Fier)

- Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 638 prot., datë 12.04.2022 me vlerë 75,475.5 euro, bazuar në faturën nr.04/4000-2259C/04-LE datë 06.04.2022 me vlerë 75,475 euro. (Lezhë)

- Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 641 prot., datë 12.04.2022 me vlerë 45,575.5 euro, bazuar në faturën nr.04/4000-2259C/04-SH datë 06.04.2022 me vlerë 45,575.5 euro. (Shkodra)

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 3064 prot., datë 15.10.2024 me vlerë 176,088 euro, bazuar në faturën nr.25/4000-2259C/25-BK datë 06.04.2022 me vlerë 176,088 euro. (Berat - Kuçovë)

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 459 prot., datë 10.03.2022 me vlerë 70,650 euro, bazuar në faturën nr.03/4000-2259C/03-VL datë 06.04.2022 me vlerë 70,650 euro. (Vlorë).

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 967 prot., datë 24.05.2023 me vlerë 132,081.25 euro, bazuar në faturën nr.08/4000-2259C/08-LE datë 10.05.2023 me vlerë 132,081.25 euro. (Lezhë)

- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 458 prot., datë 10.03.2022 me vlerë 61,500 euro, bazuar në faturën nr.03/4000-2259C/03-BK datë 18.01.2022 me vlerë 61,500 euro. (Berat - Kuçovë)

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 285 prot., datë 02.02.2024 me vlerë 308,768.75 euro, bazuar në faturën nr.15/4000-2259C/15-LE datë 10.01.2024 me vlerë 308,768.75 euro. (Lezhë)

- Kërkesa për disbursim nr.5, me nr. 3264 prot., datë 01.11.2024 me vlerë 61,562 euro, bazuar në faturën nr.28/4000-2259C/28-LE datë 29.10.2024 me vlerë 61,562.5 euro. (Lezhë)

- Kërkesa për disbursim nr.5, me nr. 2597 prot., datë 16.12.2022 me vlerë 117,425 euro, bazuar në faturën nr.05/4000-2259C/05-VL datë 16.11.2022 me vlerë 117,425 euro. (Vlorë)

- Kërkesa për disbursim nr.6 me nr. 2617 prot., datë 19.12.2022 me vlerë 98,962.5 euro, bazuar në faturën nr.06/4000-2259C/06-FI datë 07.12.2022 me vlerë 98,962.5 euro. (Fier)

- Kërkesa për disbursim nr.7 me nr. 660 prot., datë 30.03.2023 me vlerë 70,687.5 euro, bazuar në faturën nr.07/4000-2259C/07-FI datë 09.03.2023 me vlerë 70,687.5 euro. (Fier)

- Kërkesa për disbursim nr.8 me nr. 661 prot., datë 30.03.2023 me vlerë 83,875 euro, bazuar në faturën nr.07/4000-2259C/07-VL datë 09.03.2023 me vlerë 83,875 euro. (Vlorë)

- Kërkesa për disbursim nr.9 me nr. 1061 prot., datë 09.06.2023 me vlerë 13,500 euro, bazuar në faturën nr.09/4000-2259C/09-VL datë 25.05.2023 me vlerë 13,500 euro. (Vlorë)

- Kërkesa për disbursim nr.10 me nr. 1062 prot., datë 09.06.2023 me vlerë 71,100 euro, bazuar në faturën nr.09/4000-2259C/09-FI datë 25.05.2023 me vlerë 71,100 euro. (Fier)

- Kërkesa për disbursim nr.11 me nr. 1595 prot., datë 06.09.2023 me vlerë 58,683 euro, bazuar në faturën nr.10/4000-2259C/10-BK datë 19.07.2023 me vlerë 58,683 euro. (Berat - Kuçovë)

- Kërkesa për disbursim nr.11 me nr. 2033 prot., datë 03.11.2023 me vlerë 36,175 euro, bazuar në faturën nr.11/4000-2259C/11-FI datë 19.10.2023 me vlerë 36,175 euro. (Fier)

- Kërkesa për disbursim nr.12 me nr. 2032 prot., datë 03.11.2023 me vlerë 35,050 euro, bazuar në faturën nr.11/4000-2259C/11-VL datë 19.10.2023 me vlerë 35,050 euro. (Vlorë)

- Kërkesa për disbursim nr.12 me nr. 1650 prot., datë 14.09.2023 me vlerë 79,756.25 euro, bazuar në faturën nr.08/4000-2259C/08-SH datë 10.05.2023 me vlerë 79,756.25 euro. (Shkodër)
- Kërkesa për disbursim nr.13 me nr. 1200 prot., datë 19.04.2024 me vlerë 204,793.75 euro, bazuar në faturën nr.18/4000-2259C/18-SH datë 29.05.2024 me vlerë 204,793.75 euro. (Shkodër)
- Kërkesa për disbursim nr.14 me nr. 3261 prot., datë 01.11.2024 me vlerë 39,212.5 euro, bazuar në faturën nr.28/4000-2259C/28-BK datë 29.10.2024 me vlerë 39,212.5 euro. (Shkodër)
- Kërkesa për disbursim nr.14 me nr. 1207 prot., datë 19.04.2024 me vlerë 182,957.93 euro, bazuar në faturën nr.19/4000-2259C/19-FI datë 28.03.2024 me vlerë 54,717.06 euro, faturën nr.19/4000-2259C/19-BK datë 28.03.2024 me vlerë 21,663.75 euro, faturën nr. 19/4000-2259/19-VL datë 28.03.2024 me vlerë 31,324.45, faturën nr. 19/4000/2259C/19-SH datë 28.03.2024 me vlerë 24,836.17 euro dhe faturën nr. 19/4000-2259C/19-LE datë 28.03.2024 me vlerë 50,416.5 euro.

Faza D

Parapagimi Lezha:

Kërkesa për disbursim nr. 6 me nr. 3749 prot., datë 19.12.2024 me vlerë 67,443.75 euro, bazuar në faturën nr.31/4000-2259C/31-LE datë 07.11.2024 me vlerë 67,443.75 euro.

Parapagimi Vlora:

Kërkesa për disbursim nr. 13 me nr. 2347 prot., datë 18.12.2023 me vlerë 71,572.5 euro, bazuar në faturën nr.12/4000-2259C/12-VL datë 04.12.2023 me vlerë 71,572.5 euro.

Parapagimi Fier:

Kërkesa për disbursim nr. 14 me nr. 2348 prot., datë 18.12.2023 me vlerë 62,610 euro, bazuar në faturën nr.12/4000-2259C-12/FI datë 04.12.2023 me vlerë 62,610 euro.

Parapagimi Shkodër:

Kërkesa për disbursim nr. 15 me nr. 3746 prot., datë 19.12.2024 me vlerë 56,190 euro, bazuar në faturën nr. 32/4000-2259C-32/SB datë 07.11.2024 me vlerë 56,190 euro.

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.7, me nr. 3751 prot., datë 19.12.2024 me vlerë 48,167,86 euro, bazuar në faturën nr.34/4000-2259C/34-LE datë 11.12.2024 me vlerë 48,167.86 euro. (Lezhë)
- Kërkesa për disbursim nr.15, me nr. 275 prot., datë 02.02.2024 me vlerë 41,740 euro, bazuar në faturën nr.16/4000-2259C/16-FI datë 31.01.2024 me vlerë 41,740 euro. (Fier)
- Kërkesa për disbursim nr.16, me nr. 1206 prot., datë 19.04.2024 me vlerë 47,715 euro, bazuar në faturën nr.17/4000-2259C/17-VL datë 18.03.2024 me vlerë 47,715 euro. (Vlorë)
- Kërkesa për disbursim nr.17, me nr. 2681 prot., datë 16.09.2024 me vlerë 41,740 euro, bazuar në faturën nr.20/4000-2259C/20-FI datë 28.05.2024 me vlerë 41,740 euro. (Fier)
- Kërkesa për disbursim nr.18, me nr. 3262 prot., datë 01.11.2024 me vlerë 41,740 euro, bazuar në faturën nr.27/4000-2259C/27-FI datë 29.10.2024 me vlerë 41,740 euro. (Fier)
- Kërkesa për disbursim nr.19, me nr. 3263 prot., datë 01.11.2024 me vlerë 47,715 euro, bazuar në faturën nr.26/4000-2259C/26-VL datë 31.12.2024 me vlerë 47,715 euro. (Vlorë)
- Kërkesa për disbursim nr.20, me nr. 3747 prot., datë 19.12.2024 me vlerë 47,715 euro, bazuar në faturën nr.30/4000-2259C/30-VL datë 07.11.2024 me vlerë 47,715 euro. (Vlorë)
- Kërkesa për disbursim nr.21, me nr. 3748 prot., datë 19.12.2024 me vlerë 41,740 euro, bazuar në faturën nr.19/4000-2259C/29-FI datë 07.11.2024 me vlerë 41,740 euro. (Fier)
- Kërkesa për disbursim nr.22, me nr. 3750 prot., datë 19.12.2024 me vlerë 52,179.58 euro, bazuar në faturën nr.33/4000-2259C/33-VL datë 11.12.2024 me vlerë 52,179.58 euro. (Fier)

Zbatimi i kontratës BOE “D. B. I. G. &C. W K.”, “I. L. m.”

Faza 1 - Fizibiliteti

- Konsulenti teknik – Elbasan

Për realizimin e këtij shërbimi është lidhur Kontrata e Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1150, datë 15.04.2019) midis BOE “D. B. I. G. &C. W K.”, “I. L. m.” dhe A.B, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK, me vlerë 475,753.14 euro me kohëzgjatje deri 31.08.2019 për fazën A/B.

Parapagimi:

Kërkesa për disbursim nr. 1 me nr. 1361 prot., datë 07.05.2019 me vlerë 69,211.52 euro, bazuar në faturën nr.A/B – 0/042019/14681 datë 26.04.2019 me vlerë 69,211.52 euro.

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 2689 prot., datë 16.09.2019 me vlerë 161,493.55 euro, bazuar në faturën nr.A/B-1/092019/14681 datë 09.09.2019 me vlerë 161,493.55 euro.
- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 841 prot., datë 26.03.2020 me vlerë 161,493.55 euro, bazuar në faturën nr.A/B-2/032020/14681 datë 02.03.2020 me vlerë 161,493.55 euro.
- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 2811 prot., datë 03.11.2020 me vlerë 69,211.52 euro dhe 8,376.67 euro shpenzime të rimbursueshme, bazuar në faturën nr.A/B-3/092020/14681 datë 30.09.2020 me vlerë 77,588.19 euro. Bashkëlidhur situacioni i shpenzimeve të rimbursueshme.

Shuma e disbursuar për Fazën 1, me vlerën 469,786.81 euro

- Konsulenti teknik – qytetet Shkodër/Lezhë

Faza 1

Për realizimin e këtij shërbimi është lidhur Kontrata e Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1117, datë 09.04.2019) midis “S. S. P.” dhe A.B, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK, me vlerë 645,612.5 euro për fazën A/B.

Parapagimi:

Kërkesa për disbursim nr. 1 me nr. 1303 prot., datë 02.05.2019 me vlerë 92,276.86 euro, bazuar në faturën nr.A2019-11 datë 18.04.2019 me vlerë 92,276.88 euro.

Kërkesa për disbursim nr. 2 me nr. 1551 prot., datë 24.05.2019 me vlerë 2,000 euro, bazuar në faturën nr.A2019-11 datë 15.05.2019 me vlerë 2,000 euro.

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 3821 prot., datë 20.12.2019 me vlerë 219,979.38 euro, bazuar në faturën nr.A2019-19 datë 16.09.2019 me vlerë 219,979.38 euro.
- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 634 prot., datë 25.02.2020 me vlerë 219,979.38 euro, bazuar në faturën nr.001SN64474810 datë 24.02.2020 me vlerë 219,979.38 euro.
- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 542 prot., datë 02.03.2020 me vlerë 94,276.88 euro dhe 7,975.26 euro shpenzime të rimbursueshme, bazuar në faturën nr.A2021_001 me vlerë 94,276.88 euro dhe fatura nr. A2021_002 me vlerë 7,975.26 euro. Bashkëlidhur situacioni i shpenzimeve të rimbursueshme.

Shuma e disbursuar për Fazën 1, me vlerë 636,487.76 euro

Koment i dhënë nga CPU

“Faza e projekt idesë - conceptual design

Lezhë Komponenti A 1 - Kanalizimet e ujërave të ndotura: Lidhur Projekt Idenë (Conceptual design) dhe Studimin e Fizibilitetit, nga punëdhësi dhe KfW janë dërguar listat me komente të cilat konsulenti ka patur shumë vështirësi për ti sqaruar dhe reflektuar.

Me qëllim sqarimin e çdo paqartësie është zhvilluar edhe një takim me konsulentin në zyrat e KfW Frankfurt por përsëri ka patur problematika në sqarimin e çdo aspekti. Ndodhur në këtë situatë Projekt Idea është aprovuar nga KfW me kushtëzime.

Lezhë Komponenti A 2 - Kanalizimet e ujërave të shiut: Koncepti i propozuar nga konsulenti ka qenë me problematika thelbësore pasi nuk trajton çdo pjesë të qytetit Lezhë sipas zonave të kullimit të ujërave refruar topografisë, pra zonat e larta, zona e ulët, etj. Për më tepër propozimi për të mbledhur të gjithë ujërat e shiut të zonës së lartë të qytetit, zonës së sheshtë në veri, zonës së qendrës, dhe për ti grambuluar me tuba dhe sjellë në zonën e qendrës buzë lumit Drin tek një stacion qendror pompimi është me probleme pasi do të mbidimensiononte çdo tubacion, do të mbidimensiononte stacionin e pompimit, do të rriste kostot e ndërtimit. Stacioni i pompimit i propozuar do të pomonte 5 - 7 m³/sekondë ose 5000 - 7000 litra ujë në sekondë, pra një prurje sa një lumë i vërtetë! Pra koncepti që konsulenti propozonte ku e gjithë sasia e ujit do të pompohet me stacion pompimi nuk ishte fizibël. Bashkangjitur lista e komenteve që tregon problematikat.

Ndodhur në këtë situatë Projekt Idea është aprovuar nga KfW me kushtëzime si në dokumentet bashkangjitur duke shprehur qartë se problemet duhen zgjidhur në fazën e projektimit të detajuar teknik.

Në vijim gjatë fazës së projektimit me konsulentin tjetër S., koncepti ndryshoi dhe stacioni i pompimit është lehtësuar me prurje maksimale 2000 m³/sekondë dhe pjesa veriore e qytetit si dhe zona e kalasë shkarkojnë ujrën me gravitet pa pompim direkt në lumin drin.

Të gjitha problematikat dhe vonesat nga konsulenti, bënë që Projekt Idea të miratohet vetëm në 12.2019 pra me vonesë të konsiderueshme prej rreth 2 muaj nga çfarë kërkohej në kontratë. Kontrata filloi në 09.04.2019 dhe Projekt idea draft duhej të dorëzohej pas 4.5 muaj pra në 08.2019 dhe versioni final duhej pas 6 muaj pra në 10.2019.

Shkodër Komponenti A 1 - Kanalizimet e ujërave të ndotura: Lidhur Projekt Idenë (Conceptual design) dhe Studimin e Fizibilitetit, nga punëdhënësi dhe kfw janë dërguar listë me komente të cilat konsulenti ka patur shumë vështirësi për ti sqaruar dhe reflektuar.

Bashkangjitur po ju dërgoj listën e komenteve, ku shfaqen problematika thelbësore. Referuar kesaj shtate me email 23.12.2019 i ishte komunikuar konsulentit Sh që nuk mund te kete aprovim per Projekt Idene.

Faza e studimit te fizibilitetit

Lezhë Komponenti A 1 - Kanalizimet e ujërave te ndotura: Lidhur me Studimin e Fizibilitetit, nga punëdhënësi dhe kfw janë dërguar lista me komente të cilat konsulenti ka patur shumë vështirësi për ti sqaruar dhe reflektuar. Kjo jo vetëm ka shkaktuar shumë kohë në diskutime dhe angazhim përtej parashikimeve në kontratë nga punëdhënësi dhe KfW por ka harxhuar edhe shumë kohë dhe vonesë për përmbyllje nga konsulenti.

Bashkangjitur po ju dërgoj email dhe listat e komenteve të njëpasnjëshme dërguar konsulentit ku kuptohen problematikat e hasura.

Lezhë Komponenti A 2 - Kanalizimet e ujërave të shiut: Pavarësisht përpjekjeve të punëdhënësit dhe kfw në fazën e projekt idesë dhe aprovimit me kusht që problemet të merrnin zgjidhje në fazën e fizibilitetit, konsulenti përsëri ka shfaqur probleme në përgatitjen e fizibilitetit. Nisur nga këto probleme fizibiliteti është dërguar 3 herë, versioni rishikuar 07.2020, version rishikuar 10.2020, version final 11.2020.

Bashkangjitur po ju dërgoj email dhe listat e komenteve të njëpasnjëshme dërguar konsulentit ku kuptohen problematikat e hasura.

Shkodër Komponenti A 1 - Kanalizimet e ujërave te ndotura: Pavarësisht përpjekjeve të punëdhënësit dhe kfw në fazën e projekt idesë dhe aprovimit me kusht që problemet të merrnin

zgjdhje në fazën e fizibilitetit, konsulenti përsëri ka shfaqur probleme në përgatitjen e fizibilitetit.

Bashkangjitur po ju dërgoj email dhe listat e komenteve të njëpasnjëshme dërguar konsulentit ku kuptohen problematikat e hasura.

Bashkangjitur po ju dërgoj edhe email datë 09.10.2020 ku KfW citon:

Megjithatë dilema mbetet nëse ky konsulent (S.) është i duhuri për të vazhduar me fazën e zbatimit duke konsideruar ndërtimin e ITUN, veçanërisht duke e krahasuar me shërbimet e konsulencës dhe zgjidhjet e elaboruara për ITUN në qytetet e tjera të programit të dhëna nga konsulentët e tjerë.

Referuar gjithë problematikave të hasura punëdhënësi dhe KfW kanë vendosur që mos vazhdojnë shërbimet opsionale për fazat C,D,E me konsulentin “S. ”për arsye të performancës se dobët.”

-Pas përfundimit të kësaj fazë AKUK ka vendosur mos të vijojë në Fazën e 2 me kompaninë “S. S. P.” dhe nëpërmjet një adendumi (shtesë kontrate). Shtesa e kontratës e lidhur me “S.” është jo sipas Planit të Prokurimit në pikën 2.3 të Marrëveshjes së Veçantë, Aneksi 6 i Marrëveshjes së Veçantë, jo në përputhje me Parimet bazë të Guidelines for Procurement of Consulting Service, Works, Plant, Goods and Non - Consulting Service in Financial Cooperation with Partner Countries.

Edhe pse nga CPU pretendohet se Konsulenti “S. S. P.” nuk ka përmbushur detyrimet e kontratës si në cilësi edhe në kohë, nga auditimi konstatohet se nuk ka asnjë masë të marrë nga CPU në lidhje me aplikimin e penaliteteve sipas pikës 4.2 “Penalitetet për vonesa” të Kontratës së Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1117, datë 09.04.2019) midis S. S. P. dhe A.B, Drejtor i Përgjithshëm i AKUK. Nuk ka kërkuar mbajtjen e Garancisë conform nenit 7 “Garancia”, të kushteve të veçanta.

Faza 2 – Design, Tender, supervizion

Pas përfundimit të Fazës 1 dhe sigurimit të financimit për Fazën 2, ka vijuar puna me këtë fazë. Sipas kontratës:

Faza 2

Komponenti C - 610,772.64 euro

Komponenti D - 697,391.84 euro

Komponenti E (opsional) - 75,789.91 euro

Adendum nr.1, nr. 568 prot., datë 04.03.2021

Komponenti C - nga 610,772.64 euro shkon 694,711.82 euro

Komponenti D - nga 697,391.84 euro shkon 1,077,965.91 euro

Komponenti E (opsional) - nga 75,789.91 euro shkon 77,389.09 euro

Adendum nr.2, nr. 2213 prot., datë 30.11.2023

Komponenti A/B për Elbasanin shtohet me 124,489.5 euro

Komponenti A për Kamzën shtohet me 75,980.24 euro

Komponenti C Elbasan shtohet me 132,375.77 euro

Komponenti C Shkodër shtohet me 298,050.3 euro

Nga auditimi rezulton se nëpërmjet këtij Adendumi është miratuar shtesë në vlerën e kontratës për Komponenti A/B për Elbasanin me 124,489.5 euro dhe Komponenti A për Kamzën me 75,980.24 euro, fazë e cila është mbyllur që në vitin 2020 dhe mbulimi i kostove për Fazën 1 (Komponentët A/B) të projektit është kryer nga 2 Grante të KfW të vitit 2018. Gjithashtu

investimi për Kamzën është anuluar dhe nuk justifikohen pagesat e kryera për Komponentin A në vitin 2023, kur kjo fazë është finalizuar në vitin 2020. Ky adendum kontrate është në kundërshtim me pikën 4.3 të Kontratës së Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1150, datë 15.04.2019) midis BOE D. B. I. G. &C. W K., “I. L. m.”, pasi ka miratuar shpenzime të ndodhura shumë më përpara kësaj datë, ndërkohë që adendumi duhet të dakordësojë palët për shpenzime të dala dhe të pa parashikuara, të cilat do të kryhen pas miratimit të Adendumit. Gjithashtu kryerja e këtyre dy pagesave është jashtë strukturës financuese të Fazës 2 të projektit pika 2.2 ku thuhet se do të mbulohen shpenzimet e konsulencës për *(dizënjim i detajuar, supervizion i tenderit dhe DNP)*.

Siç konstatohet edhe nga faturat e ardhura nga konsulenti ato mbajnë datën përpara miratimit të adendumit midis palëve.

Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 2617 prot., datë 17.12.2021 me vlerë 75,116.82 euro, bazuar në faturën nr.C-1/112021/14681 datë 25.11.2021 me vlerën 75,116.82 euro.

Kërkesa për disbursim nr.7, me nr. 2238 prot., datë 05.12.2023 me vlerë 124,489.5 euro, bazuar në faturën nr.A/B-Add2/112023/14661.1 Elbasan datë 24.11.2023 me vlerën 132,375.77 euro.

Adendum nr. 3, nr. 1775 prot., datë 21.06.2024

Është riparë vlera e Komponentit D dhe E

Komponenti D për Elbasanin – 601,331.82 euro

Komponenti D për Shkodrën – 640,795.46 euro

Komponenti E për Elbasanin – 53,640.91 euro

Komponenti E për Shkodrën – 37,609.09 euro

Pagesat e kryera

Elbasan

Parapagimi:

Kërkesa për disbursim nr. 1 me nr. 1983 prot., datë 09.10.2021 me vlerë 37,558.41 euro, bazuar në faturën nr.C-0/082021/14681 datë 31.08.2021 me vlerën 37,558.41 euro.

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 2617 prot., datë 17.12.2021 me vlerë 75,116.82 euro, bazuar në faturën nr.C-1/112021/14681 datë 25.11.2021 me vlerën 75,116.82 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 1942 prot., datë 13.09.2022 me vlerë 131,454.43 euro, bazuar në faturën nr.C-2/042022/14681 datë 04.04.2022 me vlerën 131,454.43 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 296 prot., datë 27.02.2023 me vlerë 93,896.02 euro, bazuar në faturën nr.C-3/122022/14681.1 datë 06.12.2022 me vlerën 93,896.02 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.5, me nr. 1598 prot., datë 06.09.2023 me vlerë 37,558.41 euro, bazuar në faturën nr.C-4/082023/14681.1 datë 29.08.2023 me vlerën 37,558.41 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.6, me nr. 2240 prot., datë 05.12.2023 me vlerë 132,375.77 euro, bazuar në faturën nr.C-2.1/Add2/112023/14681.1 Elbasan datë 24.11.2023 me vlerën 132,375.77 euro.

- Kërkesa për disbursim nr.7, me nr. 2238 prot., datë 05.12.2023 me vlerë 124,489.5 euro, bazuar në faturën nr.A/B-Add2/112023/14661.1 Elbasan datë 24.11.2023 me vlerën 132,375.77 euro.

Shkodër:

Parapagimi:

Kërkesa për disbursim nr. 1 me nr. 2616 prot., datë 17.12.2021 me vlerë 29,834.77 euro, bazuar në faturën nr.C-0/112021/14681 datë 25.11.2021 me vlerën 29,834.77 euro.

Pagesat pjesore për shërbimin:

- Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 1381 prot., datë 07.07.2022 me vlerë 59,669.55 euro, bazuar në faturën nr.C-1/062022/14681 datë 28.06.2022 me vlerën 59,669.55 euro.
- Kërkesa për disbursim nr.3, me nr. 2241 prot., datë 05.12.2023 me vlerë 298,050.3 euro, bazuar në faturën nr.C-2.2/Add2/112023/14681.2 Shkodra datë 24.11.2023 me vlerën 298,050.3 euro.
- Kërkesa për disbursim nr.4, me nr. 1748 prot., datë 19.06.2024 me vlerë 104,421.71 euro, bazuar në faturën nr.C-2/042024/14681 datë 19.04.2024 me vlerën 104,421.71 euro.

Pretendimi i Subjektit

Sqarojmë se në Planin e Prokurimit në pikën 2.3 të Marrëveshjes së Veçantë, Aneksi 6 i Marrëveshjes së Veçantë, për shërbimet e Konsulentit Teknik, zëri 13, është përcaktuar vetëm një zë i vetëm i përgjithshëm për shërbimet e Konsulentit Teknik “Implementation Consultant IC, in addition to already contracted IC services / Konsulenti Teknik/Zbatimit IC, shtesë për shërbimet e IC tashmë të kontraktuara”. Ky zë është i padetajuar, pra i pa-ndarë në kontrata të veçanta të shërbimeve të konsulentit teknik për secilin qytet, ndaj kontraktimi i shërbimeve me addendum nuk është në kundërshtim me këtë plan prokurimi. Gjithashtu sqarojmë se përfshirja në një zë të vetëm të përgjithshëm të shërbimeve të Konsulentit Teknik lidhet me kompleksitetin e programit dhe pamundësisë për të ndarë që në fillim të programit shërbimet e konsulentit teknik për secilin qytet.

Referuar sa me sipër sqarojme se shtesat e kontratave nuk janë lidhur në kundërshtim me planin e prokurimit.

Lidhur me Udhëzimet për Prokurimin e shërbimeve konsulente, puneve, instalimeve, mallrave dhe shërbimeve jo-konsulente në bashkëpunimin financiar me shtetet partnere të KfW, gjithashtu mbështetur në komunikimin e KfW (email datë 28.02.2025, bashkangjitur) sqarohen arsyet e kontraktimit të shërbimeve shtesë të konsulentit teknik nepermjet shtesave të kontratës.

Shtesat e kontratave janë në përputhje me udhëzimet e prokurimit të KfW që zbatohen për projektin, pika 2.1.5 Kontraktim i drejtpërdrejtë

Kontraktim i drejtpërdrejtë mund të zgjidhet veçanërisht në rastet e mëposhtme:

(1) Ndryshimi i kontratave ekzistuese (Addendum).

Gjithashtu kontraktimi shtesë me addendum mbështetet në kontratat bazë të konsulenteve, pika 4.3 Amended Services (Shërbimet e ndryshuara), ku parashikohet si vijon:

4.3.1 Në varësi të pëlqimit paraprak të KfW-së, Punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë një ndryshim të Kontratës (shërbime të ndryshuara ose shtesë ose afate/periudha të ndryshuara për ekzekutim – “shërbime të ndryshuara”).

Sqarojmë me përgjegjësi të plotë se NJKP/AKUK ka zbatuar me korrektësi procedurën e parashikuar në udhëzuesin e prokurimeve të KfW për përzgjedhjen e shërbimeve të konsulencës 2019/2021.

Referuar shpjegimeve si më sipër, KfW sqaron se Shtesat/Addendum janë sipas udhëzimeve të prokurimit të KfW dhe janë dhënë “no-objection” “asnjë- kundërshtim/perputhshmëri” nga departamenti i prokurimit të KfW.

Gjithashtu KfW sqaron bazën referuese që mbështetin procesin e Shtesës/Addendum në kuadër të udhëzimeve të prokurimit të KfW, 2.1.5 Kontraktim i drejtpërdrejtë (email KfW datë 06.03.2025 bashkangjitur).

Referuar sa me sipër sqarojme se shtesat e kontratave janë lidhur në përputhje të plote me procedurën e prokurimit - Kontraktim i drejtpërdrejtë, bazuar në udhëzimet e prokurimit të KfW pika 2.1.5 Kontraktim i drejtpërdrejtë.

Kontrata e shërbimeve të konsulencës është tip i formatit të KfW. Neni 7 i kushteve të veçanta të kontratës parashikon që konsulenti me kostot e veta të mbulojë Sigurim profesional, personal të stafit, paisjeve dhe makinave që do përdorë. Në kushtet e përgjithshme por edhe të

veçanta të kontrates nuk parashikohen penalitete/zbritje financiare për ditë vonese në dorëzimin e produktit të konsulentit, të cilat mund të aplikoheshin. Konsulentet kane patur afat kontraktual prej 6-7.5 muaj për të kryer shërbimet, dhe referuar cilësisë jo të mirë të produktit, nga AKUK dhe KfW, konsulenti jane mbajtur edhe 9-18 muaj të tjerë në kushte pune me inpute shtesë të tejzgjatura dhe rrjedhimisht me kosto direkte te shtuara per konsulentet, për të njëjtën kontratë, derisa të përmbyllnin shërbimet e kërkuara dhe derisa të dorëzonin produktin e duhur cilësor. Aplikimi i penaliteteve nuk është i përshtatshëm në rast se produkti është jo cilësor dhe i pa plotë.

Addendum 2 përfshin shërbime shtesë të kryera nga konsulenti përtej termave të referencës së kontratës bazë në Elbasan dhe Kamëz, për të cilat konsulenti ka kërkuar të paguhet (referencë Annex A të addendum 2). Këto shërbime shtesë janë bërë nga konsulenti për përgatitjen e studimit të fizibilitetit gjatë fazës A,B, dhe formalizimi me Addendum 2, përmbyll nga ana financiare pretendimet e konsulentit dhe detyrimet e punëdhënësit për të paguar punën e kryer të konsulentit për të përgatitur studimin e fizibilitetit.

Pika 4.3; 4.3.1 e kontratës së konsulencës parashikon:

4.3.1 Në varësi të pëlqimit paraprak të KfW-së, Punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë një ndryshim të Kontratës (shërbime të ndryshuara ose shtesë ose afate/periudha të ndryshuara për ekzekutim – “shërbime të ndryshuara”).

Ekzaktësisht shërbimet e kryera nga konsulenti dhe të formalizuara me Addendum 2 për fazat A, B në Elbasan dhe Kamëz janë shërbime shtesë dhe duhet të paguhen duke formalizuar ndryshim/ addendum sipas kësaj pike 4.3.1 të kontratës.

Pika 4.3; 4.3.3 e kontratës së konsulencës parashikon:

4.3.3 Konsulenti do të ekzekutojë shërbimet e ndryshuara nëse Punëdhënësi bie dakord, me shkrim, me propozimin e shpërblimit. Nëse palët nuk bien dakord për propozimin e shpërblimit brenda tre muajve nga fillimi i ofrimit të Shërbimeve nga Konsulenti, e drejta për shpërblim do të trajtohet si një mosmarrëveshje sipas Nenit 8 (Mosmarrëveshjet dhe Procedura e Arbitrazhit).

Referuar kësaj pike të kontratës mos-rënia dakord për ndryshim/ addendum do të çonte marrëdhënien kontraktuale në arbitrazh ndërkombëtar siç parashikohet në kontratë, International Chamber of Commerce in Paris. Proçesi i arbitrazhit do te rezultonte me kosto shtese per punedhenesin AKUK.

Lidhur me gjetjen se “*adendumi duhet të dakortësojë palët për shpenzime të dala dhe të paparashikuara, të cilat do të kryhen pas miratimit të Adendumit*”, nuk e gjejmë të bazuar pasi në pikën 4.3.1 të kontratës citohet se ndryshimi bëhet për shërbime shtesë me pëlqimin paraprak të KfW, gjë që është konfirmuar edhe me no-objection nga KfW. Shpenzimet për shërbimet e kryera shtesë janë të konfirmuara gjatë kryerjes së shërbimeve nëpërmjet miratimit të produktit pra studimit të fizibilitetit. Këto shërbime shtesë janë të sqaruara me detaje edhe në Anex A të Addendum 2 se kur kanë ndodhur dhe miratimi i këtyre shërbimeve shtesë gjatë fazës A,B është konfirmuar me miratimin e studimit të fizibilitetit. Formalizimi i shërbimeve të kryera nga konsulenti me Addendum 2, përmbyll nga ana financiare pretendimet e konsulentit dhe detyrimet e punëdhënësit për të paguar punën e kryer të konsulentit gjatë fazës A,B për të përgatitur studimin e fizibilitetit. Theksojmë se për projektin është parësore dorëzimi i produktit me cilësi. Siç ju kemi referuar më sipër mos-rënia dakord për ndryshim/ addendum do të çonte marrëdhënien kontraktuale në arbitrazh ndërkombëtar siç parashikohet në kontratë, International Chamber of Commerce in Paris.

Lidhur me gjetjen se “*kryerja e këtyre dy pagesave është jashtë strukturës financuese të Fazës 2 të projektit pika 2.2 ku thuhet se do të mbulohe shpenzimet e konsulencës për (dizënjim i detajuar, supervizion i tenderit dhe DNP)*”, sqarojmë së këto shpenzime përfshijnë shërbime teknike më të detajuara se shërbimet e hartimit të studimit të fizibilitetit të cilat për nga natyra i paraprijnë përgatitjes së projektit të detajuar teknik (faza C), dhe KfW ka gjykuar që të mos

paguhen nga financimet grant të fazës A,B Fizibiliteti. Sqarojme se burimi i financimit të pagesave është ekskluziviteti i KfW, pasi në përputhje me marrëveshjet e kredise dhe granteve është KfW që menaxhon disbursimet dhe për këtë proces punë rimburohet nga fondet e programit nepermjet “management fee”.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Në lidhje me pretendimin tuaj se Faza 1 nuk ka qenë e përfshirë e marrëveshjes së veçantë ju sqarojmë se Ligjet përkatëse të marrëveshjeve parashikojnë nenet përkatëse se si do të prokurohen fondet e granteve për fazën e parë. Edhe Marrëveshja e veçantë parashikon që fondet e konsulentëve do të prokurohen për Fazën 2.

Për sa i përket kontratës së ajo është kontratë tip për pjesën e penalteteve dhe garancisë ju sqarojmë se kontrata është detyrim për zbatim midis palëve dhe se ka pjesët e veçanta për të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në qoftë se nuk duhet të jenë pjesë e kontratës ato nuk duhet të përfshiheshin në të.

Për sa i përket “p. b.” observacioni që kjo kompani ska pasur detyrim të hyjë në fazën 2 observacioni merren parasysh por gjithësesi për konsulentin e Beratit nuk është prokuruar.

Kryerja e pagesave jashtë planit të financimit është në kundërshtim me marrëveshjen.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përcaktimin dhe shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit në krahasim me ato të përcaktuara në marrëveshje me huadhënësit, konstatohet se në këtë fazë të zhvillimit të projektit, nuk është e mundur të vlerësohet shkalla e realizimit të objektivit për rritjen e ndërgjegjësimit, pasi nuk ka një sistem të përcaktuar matjeje në dokumentet zyrtare. Kjo përbën një mangësi që duhet adresuar për të siguruar një monitorim efektiv dhe për të mundur vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve të realizuara deri më tani, pasi në Planin e Fizibilitetit dhe Komunikimit nuk ka tregues të qartë të performancës, vlera fillestare dhe objektivat për vitin 2027, në mënyrë që të mundësohet matja e progresit dhe raportimi i saktë mbi realizimin e objektivit të ndërgjegjësimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 14-17 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve me Njësinë e Koordinimit të Projektit, në bashkëpunim me konsulentin institucional për zbatimin e programit “Infrastruktura Bashkiake V”, të përditësojë Planin e Fizibilitetit dhe Komunikimit duke përcaktuar tregues specifikë të performancës, dhe objektivat e pritshme të matëshme pasi këto përmirësime do të sigurojnë një monitorim më efektiv të progresit dhe një vlerësim më të saktë të ndikimit të aktiviteteve të ndërgjegjësimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në marrëveshjet me huadhënësit për realizimin e procedurës së prokurimit “Shërbime Konsulenti Institucional”, u konstatua se:

Hapja e aplikimeve më 16.03.2021 është kryer nga dy anëtarë të komisionit të vlerësimit, duke mos respektuar përbërjen e përcaktuar prej 3 anëtarësh në Urdhrin nr. 545, datë 02.03.2021 i Drejtorit të AKUK.

Zyra e protokollit të AKUM nuk ka mbajtur procesverbal për dorëzimin e dokumentacionit parakualifikues me anëtarët e komisionit të vlerësimit të procedurës.

Mungesa e evidentimit në administrimin e dokumentacionit parakualifikues, të dorëzuar nga shoqëritë konsulente, për shkak të mungesës së informacionit mbi procesin e protokollimit sipas kërkesave të KfW, ku zarfat duhej të dorëzoheshin jo më herët se 12.03.2021, ora 11:00,

e vështirëson vlerësimin mbi përmbushjen e afatit të dorëzimit nga të gjitha subjektet pjesëmarrëse.

Në raportin përkatës të vlerësimit të fazës së dytë, anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk kanë evidentuar numrin e protokollit hyrës të AKUK për secilën nga ofertat e dorëzuara.

Vlerësimi teknik nga anëtarët e komisionit të vlerësimit është kryer me një vonesë kohore të konsiderueshme nga data e dorëzimit të ofertave deri në përfundimin e vlerësimit financiar kanë kaluar 8 muaj, një periudhë e gjatë kohore, e cila mund të ishte përfunduar brenda 2 muajsh. Megjithatë dokumentacioni i KfW-së nuk parashikon një afat specifik për këtë proces, kjo vonesë është e pajustificueshme, e cila ka ndikuar në shtyrjen e përzgjedhjes së konsulentit përtej afateve të parashikuara në shtojcën e marrëveshjes fillestare për këtë projekt.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 24-43 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve, nëpërmjet njësisë së koordinimit të projektit “Infrastruktura bashkiake V”, të monitorojë respektimin e urdhrave dhe aktet përkatëse të miratuara prej saj me qëllim që të forcohet kontrolli mbi zbatimin e tyre dhe të komisionit të vlerësimit në veçanti, duke përmirësuar procesin e vlerësimit teknik dhe financiar të ofertave si dhe duke përcaktuar afate të qarta për finalizimin e tij, për të siguruar që procesi të përmbyllet brenda një periudhe të arsyeshme, në mënyrë që të shmangen vonesat e pajustificuara që ndikojnë në ecurinë e projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Rekomandimi: Zyra e Protokollit të Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve, të dokumentojë procesin e dorëzimit dhe administrimit të dokumentacionit si në fazën e parë dhe të dytë, duke mbajtur një procesverbal të detajuar të dorëzimit të dokumentacionit nga shoqëritë pjesëmarrëse. Kjo do të sigurojë transparencë dhe gjurmueshmëri të plotë të dokumentacionit dhe do të mundësojë verifikimin e saktë të afateve të dorëzimit, në përputhje me kërkesat e KfW.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës së konsulentit institucional konstatohet se:

Për realizimin e këtij shërbimi, më 21.12.2022 është nënshkruar kontrata e konsulencës (protokoluar në AKUK me nr. 99, datë 19.01.2023) midis Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “S. G.”, “S. E. G.” & “M. E. & W. G.” dhe Drejtorit të Përgjithshëm të AKUK.

Sipas Marrëveshjes së Veçantë, datë 18.12.2020, lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtorëve të Ujësjetësave të qyteteve përfituese, financimi i kontratës mbështetet nga tre burime Grant i KfW, Grant i BE dhe Grant i SECO

Afati i kontratës bazuar në Nenin 1 të Kushteve të Veçanta të Kontratës, kontrata ka një kohëzgjatje prej 60 muajsh nga data e fillimit (19.01.2023), pra data e përfundimit të kontratës është 19.01.2028.

Nga analiza e të dhënave, rezulton se kontrata shfaq dy problematika kryesore:

- Mospërputhja e afateve financiare me kohëzgjatjen e kontratës pasi burimet e financimit të kontratës (huaja) përfundojnë në 30.11.2027, ndërkohë që kontrata zgjat deri më 19.01.2028, fakt ky që ka ekspozuar kontratën ndaj mbulimit me fonde financimi për 1,5 muajt e fundit.

- Shkelja e afateve të përcaktuara në Aneksin 2 “Grafik Kohor” të Marrëveshjes së Veçantë, datë 18.12.2020 ku përcaktohet se i gjithë projekti duhet të përfundojë më 31.12.2027, ndërsa kontrata e lidhur shkon përtej këtij afati.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 43-63 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve të sigurojë përputhjen e afateve të financimit me kohëzgjatjen e kontratës, duke ndërmarrë hapat e nevojshëm për të garantuar vijueshmërinë financiare deri në përfundimin e saj. Gjithashtu, të rishikojë dhe harmonizojë afatin e zbatimit të kontratës me afatet e përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, për të shmangur tejkalimin e afateve të miratuara për përfundimin e projektit si dhe mbulimin me financim të kontratës.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të konsulencës teknike u konstatuan se:

- Për realizimin e Fazës 1 - Fizibiliteti i **Berat Kuçovë** është kontraktuar kompania “P. B.”, nëpërmjet një Shtese Kontrate (shtese për kontratën ekzistuese jo e projektit “Infrastruktura Bashkiake V”). Pas përfundimit të Fazës 1 Konsulenti “P. B.” nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale si në cilësi edhe në kohë, nga auditimi konstatohet se nuk ka asnjë masë të marrë nga CPU në lidhje me aplikimin e penaliteteve sipas pikës 4.2 “Penalite për vonesa” të Kontratës së Konsulencës datë 06.06.2016, si dhe nuk ka kërkuar mbajtjen e Garancisë konform nenit 7 “Garancia”, të kushteve të veçanta.

Pas përfundimit të kësaj fazë AKUK ka vendosur mos të vijojë në Fazën e 2 me “p. b.” dhe nëpërmjet një shtese kontrate i ka kaluar shërbimin kompanisë S..

- Pas përfundimit të kësaj Fazë 1 për konsulencën teknike për qytetet **Shkodër/Lezhë**, AKUK ka vendosur mos të vijojë në Fazën e 2 me kompaninë “S. S. P.” dhe nëpërmjet një shtese kontrate i ka kaluar kompanisë S..

Edhe pse nga CPU pretendohet se Konsulenti “S. S. P.” nuk ka përmbushur detyrimet e kontratës si në cilësi edhe në kohë, nga auditimi konstatohet se nuk ka asnjë masë të marrë nga CPU në lidhje me aplikimin e penaliteteve sipas pikës 4.2 “Penalite për vonesa” të Kontratës së Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1117, datë 09.04.2019) si dhe nuk ka kërkuar mbajtjen e Garancisë konform nenit 7 “Garancia”, të kushteve të veçanta.

- Pas përfundimit të kësaj Fazë 1 për konsulencën teknike për qytetet **Shkodër/Lezhë**, AKUK ka vendosur mos të vijojë në Fazën e 2 me kompaninë “S. S. P.” dhe nëpërmjet një shtese kontrate i ka kaluar kompanisë D. (Shkodra Impiant i ujërave).

Edhe pse nga CPU pretendohet se Konsulenti “S. S. P.” nuk ka përmbushur detyrimet e kontratës si në cilësi edhe në kohë, nga auditimi konstatohet se nuk ka asnjë masë të marrë nga CPU në lidhje me aplikimin e penaliteteve sipas pikës 4.2 “Penalite për vonesa” të Kontratës së Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1117, datë 09.04.2019) si dhe nuk është kërkuar mbajtjen e Garancisë konform nenit 7 “Garancia”, të kushteve të veçanta.

Shtesat e kontratave janë lidhur jo sipas Planit e Prokurimit në pikën 2.3 të Marrëveshjes së Veçantë, Aneksi 6 i Marrëveshjes së Veçantë, jo në përputhje me Parimet bazë të Guidelines for Procurement of Consulting Service, Works, Plant, Goods and Non - Consulting Service in Financial Cooperation with Partner Countries.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 43-63 të Raportit të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve të marrë masa duke zhvilluar procedurat e prokurimit rast pas rasti dhe mos përdorimin e shtesave të kontratave për shërbime shtesë të cilat nuk kanë qenë përfshirë në procedurën e tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve të marrë masa në aplikimin e penaliteteve dhe mbajtjen e sigurimit të kontratës në të gjitha rastet që konstatohet mos përmbushja e detyrimeve kontraktore, si dhe të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nëpërmjet Shtesës së Kontratës (Adendumit) është miratuar shtesë në vlerën e kontratës për Komponentin A/B për Elbasanin me 124,489.5 euro dhe Komponentin A për Kamzën me 75,980.24 euro, fazë e cila është mbyllur që në vitin 2020 dhe mbulimi i kostove për Fazën 1 (Komponentët A/B) të projektit është kryer nga 2 Grante të KfW të vitit 2018. Gjithashtu, investimi për Kamzën është anuluar dhe nuk justifikohen pagesat e kryera për Komponentin A në vitin 2023, kur kjo fazë është finalizuar në vitin 2020. Kjo shtesë kontrate është në kundërshtim me pikën 4.3 të Kontratës së Konsulencës (protokolluar në AKUK me nr. 1150, datë 15.04.2019) midis BOE D. B. I. G. &C. W K., “I. L. m.”, pasi ka miratuar shpenzime të ndodhura shumë më përpara kësaj date, ndërkohë që shtesa e kontratës duhet të dakordësojë palët për shpenzime të dala dhe të pa parashikuara, të cilat do të kryhen pas miratimit të Shtesës së Kontratës. Gjithashtu kryerja e këtyre dy pagesave është jashtë strukturës financuese të Fazës 2 të projektit pika 2.2 ku cilësohet se do të mbulohen shpenzimet e konsulencës për dizejnim i detajuar, supervizion i tenderit dhe DNP.

Kjo situatë konstatohet edhe nga faturat e ardhura nga konsulenti të cilat mbajnë datën përpara miratimit të shtesës së kontratës midis palëve:

Kërkesa për disbursim nr.2, me nr. 2617 prot., datë 17.12.2021 me vlerë 75,116.82 euro, bazuar në faturën nr.C-1/112021/14681 datë 25.11.2021 me vlerën 75,116.82 euro.

Kërkesa për disbursim nr.7, me nr. 2238 prot., datë 05.12.2023 me vlerë 124,489.5 euro, bazuar në faturën nr.A/B-Add2/112023/14661.1 Elbasan datë 24.11.2023 me vlerën 132,375.77 euro. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr.43-63 të Raportit të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve të marri masa për analizimin e plotë të shtesave të kontratave dhe zërave që kërkohen të financohen duke iu përmbajtur strukturës financuese të projektit dhe mos përfshirjen e zërave apo komponentëve të tjerë, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi ofertave teknike dhe financiare të OE të kualifikuar pas fazës së parë dhe të dytë dhe vlerësimin të OE fitues mbi bazën e vlerësimin të kombinuar të pikëzimit konstatohet se:*

a. Sipas raportit të vlerësimin teknik, në ekipin e ekspertëve shtesë janë propozuar 4 nga 6 ekspertë teknikë, përfshirë edhe ekspertin e IT-së, i cili ka përvojë në programim dhe SCADA.

b. Sipas ofertës financiare të shoqërisë konsulente fituese BOE S.-S.-M., në tabelën e detajuar të kostos, në pikën 2 “Local Staff Cost”, është përfshirë edhe pozicioni “National GIS Expert” për një periudhë 3-mujore, me një pagë mujore prej 4,935 euro, duke e rritur vlerën totale prej 14,805 euro (pa TVSH).

c. Në pikën 5.1 të ofertës financiare është parashikuar një automjet tip “D.D.” ose ekuivalent për nevoja transporti, me një kosto mujore prej 3,000 euro për një periudhë 60 muaj, duke arritur një vlerë totale prej 180,000 euro (pa TVSH).

d. Në seksionin 6, pika 6.1 dhe 6.2, janë përcaktuar shpenzimet për qiranë e zyrës për një periudhë 60-mujore, me një kosto mujore prej 2,200 euro, duke arritur një total prej 132,000 euro (pa TVSH). Po ashtu, për stafin mbështetës të zyrës është parashikuar një pagesë mujore prej 3,600 euro për 60 muaj, me një shumë totale prej 216,000 euro (pa TVSH).

Sipas Aneksit nr. 4, këto të dhëna detajojnë kostot e përfshira, duke përfshirë shpenzimet për ekspertët lokalë, mjetet e transportit dhe qiranë e zyrës.

e. Vlera e planifikuar në Shtesës së Kontratës nr. 1 për zërat e përfshirë në tabelën nr. 3, Aneksi nr. 1, në shumën **392,988 euro** (pa TVSH), nga totali i planifikuar prej **500,000 euro** (pa TVSH) në Shtesën e Kontratës nr. 1, përbën përsëritje të zërave të përcaktuar në kontratën bazë nr. 99 prot., datë 19.01.2023.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 43-63 të Raportit të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve, përmes Njesisë së Koordinimit të Projektit (NJKP)të marrë masa për kryerjen e një analize të detajuar të planifikimit financiar dhe të vendosë mekanizma efektivë mbikëqyrjeje për të garantuar përdorimin e burimeve financiare sipas qëllimit të paravendosur.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se deri më 31.12.2024 është paguar 453,824 euro si tarifë angazhimi e cila është kosto e shtuar për buxhetin e shtetit për shkak të ecuresë shumë të ngadaltë të projektit dhe mos disbursimit në kohë sipas grafikut.

Tarifa e angazhimit do të ngarkohet nëse është e zbatueshme, me efekt prapaveprues, për periudhën që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe që zgjat deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit definitiv të disbursimeve nga Huaja.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 17-24 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve të marrë masa në përshpejtimin e ecuresë së projektit dhe disbursimit të fondeve duke shmangur rritjen e mëtejshme të tarifës së angazhimit, vlerë e cila përbën një shpenzim jo efektiv për buxhetin e shtetit.

Menjëherë